

DIREKTIVË

DIREKTIVA 2009/72/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT

e datës 13 korrik 2009

lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike, që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC

(Tekst relevant për EEA)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke marrë parasysh Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian, dhe në veçanti nenin 47 (2) dhe nenet 55 dhe 95 të tij,

Duke marrë parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke marrë parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian¹,

Duke marrë parasysh opinionin e Komiteteve të Regjioneve²,

Duke vepruar në pajtueshmëri me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit³,

Nën premisat se:

(1) Tregu i brendshëm i energjisë elektrike, i cili është implementuar në tërë Komunitetin në mënyrë progresive, mëton t'i ofrojë të gjithë konsumatorëve të Bashkimit Evropian, qofshin qytetarë apo biznese, mundësi zgjedhjeje, mundësi të reja afarizmi dhe tregtim ndërkufitar me qëllim të shtimit të efikasitetit, arritjes tek çmimet konkurruese dhe standardet më të larta të shërbimeve dhe kontribuimit në shtimin e sigurisë së furnizimit dhe qëndrueshmërisë së furnizimit.

(2) Direktiva 2003/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2003 lidhur me rregullat e përbashkëta të tregjeve të brendshme të energjisë elektrike⁴ ka paraqitur një kontribut të rëndësishëm drejt kimit të një tregu të brendshëm të energjisë elektrike.

(3) Liritë që Traktati ua garanton qytetarëve të Bashkimit, përfshirë, mes tjerash, qarkullimin e lirshëm të mallrave dhe lirinë e asocimit dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve, mund të arrihen vetëm nëse ekziston një treg tërësisht i hapur, i cili u mundëson konsumatorëve të përzgjedhin lirshëm furnitorët e tyre dhe u mundëson të gjithë furnitorëve që të ofrojnë lirshëm shërbimeve e tyre për konsumatorë.

(4) Megjithatë, aktualisht ekzistojnë pengesa sa i përket shitjes së energjisë elektrike në kushte të barabarta dhe pa diskriminim dhe disavantazhe për Komunitetin. Posaçërisht vërehet mosekzistenca e qasjes pa diskriminim në rrjete dhe e nivelit të barabartë të mbikëqyrjes rregullative mes shteteve anëtare.

¹ OJ C 211, 19.8.2008, p. 23.

² OJ C 172, 5.7.2008, p. 55

³ Opinioni i Parlamentit Evropian i datës 18 qershor 2008 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit i datës 9 janar 2009 ([OJ C 70 E, 24.3.2009, p. 1](#)) dhe Qëndrimi i Parlamentit Evropian i datës 22 prill 2009 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Këshillit i datës 25 qershor 2009.

⁴ OJ L 176, 15.7.2003, p. 37.

(5) Furnizimi i sigurt i energjisë elektrike është e një rëndësie vital për zhvillimin e shoqërisë evropiane, implementimin e një politike të qëndrueshme sa i përket ndryshimeve klimatike dhe sigurimin e konkurrueshmërisë në tregun e brendshëm. Në këtë drejtim, interkoneksionet ndërkufitare do duhej të zhvillohen më tej për të siguruar furnizim të energjisë nga të gjitha burimet, me çmimet më konkurruese për të gjithë konsumatorët dhe industrinë brenda Komunitetit.

(6) Një treg funksional i brendshëm i energjisë do duhet tu ofronte prodhuesve masa adekuate stimuluese për të investuar në kapacitete të reja të gjenerimit, përfshirë gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke pasur kujdes veçanërisht ndaj shteteve dhe regjioneve më të izoluara të tregut të energjisë të Komunitetit. Një treg funksional do duhej tu ofronte konsumatorëve masa adekuate për promovimin e shfrytëzimit më eficient të energjisë, për çka parakusht është furnizimi i sigurt i energjisë.

(7) Komunikata e Komisionit e datës 10 janar 2007, e titulluar 'Një politikë energjetike për Evropën' theksonte rëndësinë e finalizimit të një tregu të energjisë elektrike dhe krijimin e kushteve të barabarta për funksionimin e të gjitha ndërmarrjeve elektroenergjetike në Komunitet. Komunikatat e Komisionit të titulluara 'Prospektet e tregut të brendshëm të gazit dhe energjisë elektrike' dhe 'Vlerësim i sektorëve të gazit dhe energjisë elektrike në Evropë, në pajtim me nenin 17 të Rregullores (EC) Nr. 1/2003' dëshmuuan se rregullat dhe masat aktuale nuk përbëjnë një kornizë të domosdoshme për të arritur objektivin e krijimit të një tregu funksional të brendshëm.

(8) Për të siguruar konkurrencë dhe furnizim të energjisë elektrike me çmimet më konkurruese të mundshme, Shtetet Anëtare dhe autoritetet rregullative kombëtare do duhej të lehtësojnë qasjen tejkuftare për furnitorë të rinj të energjisë elektrike nga burime të ndryshme të energjisë si dhe për gjeneratorë të rinj saj.

(9) Pa ndarje efektive të rrjeteve nga aktivitetet e gjenerimit dhe furnizimit (pa shturje efektive), ekziston rreziku i diskriminimit jo vetëm sa i përket funksionimit të rrjetit, por edhe sa i përket stimulimit për ndërmarrjet vertikalisht të integruara për të investuar në rrjetet e tyre.

(10) Rregullat për shturjen ligjore dhe funksionale që janë të përcaktuara në Direktivën 2003/54/EC nuk kanë siguruar shturjen efektive të operatorëve të sistemeve të transmisionit. Për këtë arsye, në takimin e datës 8 dhe 9 mars 2009, Këshilli Evropian ka ftuar Komisionin që të përpilojë propozimet e veta legjislative për 'ndarje efektive të funksioneve të furnizimit dhe gjenerimit nga operacionet e rrjetit.'

(11) Vetëm me largimin e masave stimuluese për ndërmarrjet e integruara vertikalisht për të diskriminuar konkurrencën sa i përket qasjes në rrjet dhe investimeve mund të sigurohet shturja efektive. Shturja pronësore, që nënkupton caktimin e operatorëve të sistemit si pronar të rrjetit dhe sigurimin e pavarësisë së tij nga interesat e furnizimit dhe gjenerimit, qartë paraqet një mënyrë efektive dhe stabile për të zgjidhur çështjet e konfliktit të interesit dhe për të shtuar sigurinë e furnizimit. Për këtë arsye, Parlamenti Evropian i është referuar në Rezolutën e vet të datës 10 korrik 2007 mbi

prospektet e tregut të brendshëm të gazit dhe energjisë elektrike⁵ shturjes së pronësisë në nivel të transmisionit si veglës më efektive me të cilën promovohen investimet në infrastrukturë në mënyrë jodiskriminuese, qasjen e barabartë në rrjet për hyrjet e reja dhe transparencën në rrjet. Me shturjen e pronësisë, nga Shtetet Anëtare do të kërkohet që të sigurojnë se personave të njëjtë nuk do tu mundësohet ushtrimi i kontrollit mbi gjenerimin dhe furnizimin dhe në të njëjtën kohë kontrolli mbi sistemin e transmisionit apo mbi operatorin e sistemit të transmisionit. Në anën tjetër, kontrolli mbi sistemin e transmisionit apo operatorin e sistemit të transmisionit do duhej të nënkuptojë pamundësinë për të kontrolluar ushtrimin e çfarëdo të drejte mbi ndërmarrjet e gjenerimit. Brenda kufizimeve të mësipërme, ndërmarrjet e gjenerimit apo furnizimit mund të mbajnë aksione në operatorin e sistemit të transmisionit apo në sistemin e transmisionit por jo të mbajnë shumicën e tyre.

(12) Sistemet për shturje do duhej të jenë efektiv në zgjidhjen e konflikteve të interesit mes prodhuesve, furnizuesve dhe operatorëve të sistemit të transmisionit, në mënyrë që të krijojnë masa stimuluese për investimet e domosdoshme dhe të garantojnë qasjen e ndërmarrjeve të reja në treg në mënyrë transparente dhe të rregulluar dhe nuk do duhej të krijojnë regjime rregullative të rënda për autoritetet rregullative shtetërore.

(13) Përkufizimi i fjalës 'kontroll' është marrë nga Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004, mbi kontrollin e përqendrimit të ndërmarrjeve (Rregullorja e KE për Bashkimin e Ndërmarrjeve).⁶

(14) Pasi që shturja e pronësisë nënkupton (në disa raste) nënkuptimin e ndërmarrjeve, Shtetet Anëtare që vendosin të kryejnë shturjen e pronësisë do duhej të gëzojnë më shumë kohë për t'i zbatuar dispozitat relevante. Sa u përket lidhjeve vertikale mes sektorëve të energjisë elektrike dhe të gazit, dispozitat e shturjes do duhej të zbatohen për të dy sektorët.

(15) Në shturjen e pronësisë i njëjti person nuk mund të jetë anëtar i bordeve menaxhuese edhe në operatorin e sistemit të transmisionit apo në sistemin e transmisionit edhe në ndërmarrje që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit, në mënyrë që të sigurohet pavarësi e plotë e rrjetit nga furnizimi dhe gjenerimi dhe për të parandaluar nxjerrjen e informatave konfidenciale. Për të njëjtën arsye, i njëjti person nuk do duhej të autorizohet për të emëruar anëtarët e bordit menaxhues të sistemit të transmisionit dhe operatorit të sistemit të transmisionit dhe të ushtrojë kontroll mbi të drejtat e ndërmarrjeve të gjenerimit apo furnizimit.

(16) Krijimi i operatorëve të sistemit apo operatorëve të transmisionit të pavarur nga interesat në furnizim dhe gjenerim do duhej tu mundësojë ndërmarrjeve të integruara vertikalisht që të mbajnë pronësinë mbi asetet e rrjetit duke siguruar ndarje efektive të interesave, me kusht që operatori i pavarur i sistemit apo operatori i pavarur i transmisionit të mund të kryejnë të gjitha funksionet e operatorit të sistemit dhe të sigurohet krijimi i mekanizmave të detajuar të kontrollit rregullativ.

⁵ OJ C 175 E, 10.7.2008, p. 206.

⁶ OJ L 24, 29.1.2004, p. 1.

(17) Në rastet kur më 3 shtator 2009, një ndërmarrje që ka në pronë sistemin e transmisionit është pjesë e një ndërmarrjeje vertikalisht të integruara, Shtetet Anëtare do duhej të kenë mundësi të zgjidhjes mes llojeve të ndryshme të shthurjes së pronësisë dhe të krijojnë operatorë të sistemit apo operatorë të transmisionit që janë të pavarur nga interesat e furnizimit dhe gjenerimit.

(18) Për të ruajtur tërësisht interesat e aksionarëve të ndërmarrjeve të integruara vertikalisht, Shtetet Anëtare do duhej të kenë mundësi të zgjedhin mes heqjes së të drejtave të pronësisë apo ndarjes së aksioneve të ndërmarrjes së integruar në aksione të ndërmarrjes së rrjetit dhe aksione që i mbesin ndërmarrjes së furnizimit dhe gjenerimit, me kusht që tu përmbahet kushteve të shthurjes së pronësisë.

(19) Efektiviteti i plotë i operatorit të pavarur të sistemit apo operatorit të pavarur të sistemit të transmisionit do duhej të sigurohet përmes përcaktimit të rregullave specifike. Rregullat për operatorin e pavarur të sistemit të transmisionit duhet të përbëjnë kornizë adekuate rregullative për të garantuar konkurrencë të barabartë, investime të mjaftueshme, qasje në treg për ndërmarrjeve të reja dhe integrimin e tregjeve të energjisë elektrike. Sthurja efektive përmes dispozitave për operatorin e pavarur të sistemit të transmisionit do duhej të bazohet në një sërë masash organizative dhe masash që kanë të bëjnë me qeverisjen korporatave të operatorëve të sistemit të transmisionit dhe masash që kanë të bëjnë me investimet, kyçjen e kapaciteteve të reja gjeneruese në rrjet dhe integrimin e tregut përmes bashkëpunimit rajonal. Pavarësia e operatorit të sistemit, mes tjerash, duhet të sigurohet përmes lejimit të periudhave të 'ftohjes' gjatë të cilave nuk lejohet asnjë veprimtari menaxhuese apo tjetër që mundëson qasje në informatat e njëjta sikur po të ishte ndërmarrja ende e integruar vertikalisht. Modeli i operatorit të pavarur të sistemit të transmisionit pas shthurjes efektive është në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara nga Këshilli Evropian gjatë takimit të tij të datës 8 dhe 9 mars 2007.

(20) Për të zhvilluar konkurrencën në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, konsumatorët e mëdhenj joamvisërorë duhet të kenë mundësi të zgjedhin furnizuesit e tyre dhe të lidhin kontrata me disa furnizues të ndryshëm për të mbuluar kërkesat e tyre për energji elektrike. Konsumatorët e tillë duhet të jenë të mbrojtur nga klauzolat e ekskluzivitetit të cilat kanë për qëllim përjashtimin e ofertave konkurruese apo komplementare.

(21) Shtetet anëtare kanë të drejtë të kërkojnë shthurje të plotë të pronësisë në territoret e tyre. Në rastet kur një shtet anëtar e ka ushtruar këtë të drejtë, një ndërmarrje nuk ka të drejtë të krijojë një operator të pavarur të sistemit dhe një operator të pavarur të transmisionit. Për më tepër, ndërmarrja që kryen funksione të gjenerimit dhe furnizimit nuk mund të ushtrojë kurrfarë kontrolli apo të drejte mbi operatorin e sistemit të transmisionit nga Shteti Anëtar që ka zgjedhur shthurje të plotë të pronësisë.

(22) Sipas kësaj Direktive, lloje të ndryshme të organizimit të tregut do të ekzistojnë në tregjet e brendshme të energjisë elektrike. Masat që Shtetet Anëtare mund t'i ndërmarrin për të siguruar kushte të barabarta të funksionimit do duhej të bazohen në kushte të ndërthurura me interes të përgjithshëm.

Komisioni do duhej të konsultohet mbi pajtueshmërinë e masave me traktatin dhe të drejtën e komunitetit.

(23) Implementimi i shthurjes efektive do duhej t'i përmbahej parimit të mosdiskriminimit mes sektorëve publikë dhe privatë. Në këtë drejtim, i njëjti person nuk do duhej të jetë në gjendje të ushtrojë kontroll apo të drejta që shkelin rregullat e shthurjes së pronësisë apo krijimit të operatorit të pavarur të sistemit, sa i përket përbërjes, votimit apo vendimeve mbi organizmat e operatorit të sistemit apo operatorit të transmisionit dhe ndërmarrjet e gjenerimit apo furnizimit. Sa i përket shthurjes së pronësisë dhe krijimit të operatorit të pavarur të sistemit, me kusht që Shteti Anëtar në fjalë të jetë në gjendje të demonstrojë pajtueshmëri me këtë kusht, dy trupa të pavarur publikë mund të kontrollojnë aktivitetet gjeneruese dhe furnizuese në njërën anë dhe aktivitetet e transmisionit në anën tjetër.

(24) Ndarja tërësisht efektive e aktiviteteve të rrjetit nga aktivitetet e furnizimit dhe gjenerimit do duhej të aplikohen në tërë Komunitetin edhe për ndërmarrjet e Komunitetit edhe për ato që nuk janë të tij. Për të siguruar se aktivitetet e rrjetit dhe furnizimit dhe gjenerimit në tërë Komunitetin do të mbeten të pavarura nga njëri-tjetri, autoritetet rregullative duhet të kenë mundësi të refuzojnë certifikimin e operatorëve të sistemit të transmisionit të cilët nuk u përmbahen rregullave të shthurjes. Për të siguruar aplikim konsistent të këtyre rregullave në tërë Komunitetin, autoritetet rregullative do duhej të marrin opinionin e Komisionit gjatë marrjes së vendimeve për certifikim. Më tej, për të siguruar respektim të obligimeve ndërkombëtare të Komunitetit, solidaritet dhe siguri të furnizimit të energjisë brenda Komunitetit, Komisioni duhet të ketë të drejtë të japë mendime mbi certifikimin në lidhje me një pronar të caktuar të sistemit të transmisionit apo me një operator të caktuar të sistemit të transmisionit që kontrollohet nga një person apo persona nga shtetet e treta.

(25) Siguria e furnizimit të energjisë është element thelbësor i sigurisë publike dhe rrjedhimisht ndërlidhet me funksionimin efikas të tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe integrimin e tregjeve të izoluar të energjisë elektrike të shteteve anëtare. Energjia elektrike mund të arrijë tek qytetarët e Bashkimit vetëm përmes rrjeteve. Funksionimi i tregjeve të energjisë elektrike, e në veçanti i rrjeteve dhe aseteve të tjera që ndërlidhen me furnizimin e energjisë elektrike, është esencial për sigurinë publike, konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe mirëqenien e qytetarëve të Bashkimit. Personat nga shtetet e treta do duhej të lejojnë të kontrollojnë sistemin e transmisionit apo operatorin e sistemit të transmisionit vetëm nëse u përmbahen kushteve të ndarjes efektive që aplikohen brenda Komunitetit. Pa cenuar obligimet ndërkombëtare të Komunitetit, Komuniteti konsideron se sektori i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike është tejet i rëndësishëm për Komunitetin dhe rrjedhimisht janë të nevojshme edhe masa tjera mbrojtëse për ruajtjen e sigurisë së furnizimit të energjisë për Komunitetin, për t'iu shmangur kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë publike brenda Komunitetit dhe për të siguruar mirëqenie për qytetarët e Bashkimit. Siguria e furnizimit të energjisë në Komunitet kërkon vlerësimin e pavarësisë së operimit të tregut, nivelit të varësisë së Komunitetit dhe shteteve anëtare nga furnizimi nga shtetet e treta dhe trajtimin e tregtimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe investimet në energji brenda një vendi të caktuar të tretë. Për këtë arsye, siguria e furnizimit do duhej të vlerësohej në frymën e rrethanave faktike të secilit rast ndaras si dhe të të drejtave dhe obligimeve që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, posaçërisht në kuptim të marrëveshjeve ndërkombëtare mes Komunitetit dhe shtetit të tretë në fjalë. Në rastet kur kjo është e nevojshme,

Komisioni inkurajohet që të dorëzojë rekomandime për të negociuar marrëveshjet relevante me shtetet e treta, për të adresuar sigurinë e furnizimit të energjisë në Komunitet apo për të përfshirë çështjet e domosdoshme në negociata me shtetet tjera të treta.

(26) Qasja jodiskriminuese në rrjetet e distribucionit përcakton qasjen tek konsumatorët në nivel të shitjes me pakicë. Megjithatë, diskriminimi sa i përket qasjes së palëve të treta dhe investimeve është më pak e rëndësishëm në nivel të distribucionit se sa në atë të transmisionit, ku kongjestioni dhe ndikimi i gjenerimit apo furnizimit është më i theksuar se sa në nivel të distribucionit. Për më tepër, shturja ligjore dhe funksionale e operatorëve të sistemit të transmisionit kërkohej, sipas Direktivës 2003/54/EC, nga 1 korriku i vitit 2007 dhe ndikimi i saj në tregjet e brendshme të energjisë elektrike ende nuk mund të vlerësohet si duhet. Rregullat e shturjes ligjore dhe funksionale që aktualisht janë të zbatueshme mund të shprijnë tek shturja efektive në rast se definohej më qartë, implementohen më mirë dhe monitorohen më për së afërmi. Për të krijuar kushte të barabarta të lojës në nivel të shitjes me pakicë, aktiviteti i operatorëve të sistemit të distribucionit do duhej të monitorohet për të parandaluar krijimin e çfarëdo avantazhi të integritit vertikal sa i përket pozitës së tyre konkurruese në treg, veçanërisht sa u përket konsumatorëve familjarë dhe jofamiljarë.

(27) Shtetet anëtare do duhej të inkurajojnë modernizimin e rrjeteve të distribucionit, përmes vënies në funksion të rrjeteve të mençura, të cilat do duhej të ndërtohen në mënyrë që inkurajon gjenerimin e decentralizuar dhe eficiencën e energjisë.

(28) Në rast të sistemeve më të vogla, mund të jetë i domosdoshëm sigurimi i shërbimeve ndihmëse përmes interkoneksioneve të operatorëve të sistemit të transmisionit me sisteme të vogla.

(29) Për t'i ikur barrëve joproportionale financiare dhe administrative për operatorët e vegjël të distribucionit, Shtetet Anëtare do duhej të jenë të afta, kurdo që kjo të jetë e domosdoshme, që të përjashtojnë ndërmarrjet në fjalë nga kushtet e shturjes ligjore të distribucionit.

(30) Në rastet kur për të siguruar efikasitet optimal të furnizimit të energjisë nën standarde të caktuara shfrytëzohet një sistem i mbyllur i distribucionit apo nëse një i tillë mbahet parimisht për shfrytëzim të pronarit të sistemit, do duhej të jetë e mundshme që përjashtohet operatori i sistemit të distribucionit nga obligimet të cilat do të përbënin barrë jo të domosdoshme administrative për shkak të natyrës së marrëdhënies mes operatorit të sistemit të distribucionit dhe shfrytëzuesve të tjerë të sistemit. Shërbimet industriale, komerciale apo të përbashkëta, siç janë ndërtesat e stacioneve të trenit, aeroportet, spitalet, lokacionet e fushimit me stabilimente të integruara apo stabilimente të industrisë kimike, mund të shfrytëzojnë sisteme të mbyllura të distribucionit për shkak të natyrës së specializuar të funksioneve që i ofrojnë.

(31) Procedurat e autorizimit nuk do duhej të përbëjnë barra joadekuate administrative për madhësinë dhe ndikimin potencial të prodhuesve të energjisë elektrike. Zgjatja joadekuate e procedurave të autorizimit mund të përbëjë barrierë për qasjen e ndërmarrjeve të reja në treg.

(32) Do duhej të ndërmerren masa të tjera për të siguruar tarifa transparente dhe jodiskriminuese për qasje në rrjet. Këto tarifa duhet të jenë të zbatueshme për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit në baza jodiskriminuese.

(33) Direktiva 2003/54/EC përfshinte një kërkesë për Shtetet Anëtare që të themelojnë rregullatorë me kompetenca specifike. Megjithatë, përvoja na tregon se efektiviteti i rregullimit shpesh pengohet nga mungesa e pavarësisë së rregullatorëve nga qeveria dhe nga kompetencat dhe diskrecioni i pamjaftueshëm që ata gëzojnë. Për këtë arsye, në takimin e mbajtur më 8 dhe 9 mars 2007, Këshilli Evropian ka ftuar Komisionin që të zhvillojë propozime legjislative për të siguruar harmonizim të mëtejshëm të autorizimeve dhe fuqizim të pavarësisë së rregullatorëve kombëtarë të energjisë. Do duhej të jetë e mundur që këto autoritete rregullative të mbulojnë sektorët e gazit dhe energjisë elektrike.

(34) Rregullatorët e energjisë duhet të jenë të aftë të marrin vendime në lidhje me të gjitha çështjet relevante rregullative, nëse tregu i brendshëm i energjisë elektrike funksion në mënyrë të duhur, dhe të jenë tërësisht të pavarur nga interesat tjerë publikë apo privatë. Kjo nuk pengon rishikimin gjyqësor apo parlamentar të pajtueshmërisë me kushtetutën dhe ligjet e shteteve anëtare. Përveç kësaj, miratimi i buxhetit të rregullatorit nga ligjvënësit shtetëror nuk përbën ndonjë pengesë për autonominë buxhetore. Dispozitat që kanë të bëjnë me autonominë në implementimin e buxheteve të alokuara të autoritet rregullative do duhej të implementohen brenda kornizës së përcaktuar nga ligjet dhe rregullat buxhetore të vendit. Megjithëse kontribuojnë në pavarësinë e autoriteteve rregullative kombëtare nga çfarëdo ndikimi politik apo ekonomik, përmes një skeme të caktuar të rotacioni, do duhej të jetë e mundur për Shtetet Anëtare që të kenë konsideratë sa i përket disponueshmërisë së burimeve njerëzore dhe madhësinë e bordit.

(35) Për të siguruar qasje efektive në treg për të gjithë akterët në treg, përfshirë ndërmarrjet e reja, është i domosdoshëm krijimi i mekanizmave diskriminues dhe të balancimit. Menjëherë pas sigurimit të likuiditetit të mjaftueshëm të tregut të energjisë elektrike, kjo do duhej siguruar përmes krijimit të mekanizmave transparent për furnizim dhe blerje të energjisë elektrike, që janë të nevojshëm në kuadrin e balancimit të kërkesave. Në mungesë të një tregu të tillë likuid, autoritetet kombëtare rregullative do duhej të luanë një rol aktiv në sigurimin se tarifat balancuese janë jodiskriminuese jo pasqyrojnë kostot. Njëkohësisht, do duhej ofruar masa përkatëse stimuluese për të balancuar blerjen dhe prodhimin e energjisë elektrike për të mos rrezikuar sistemin. Operatorët e sistemit të transmissioinit do duhej të lehtësojnë pjesëmarrjen e konsumatorëve përfundimtarë në tregjet balancuese dhe në rezervë.

(36) Autoritetet rregullative kombëtare duhet të jenë të afta për të rregulluar apo miratuar tarifat, apo metodologjitë që shfrytëzohen për kalkulimin e tarifave, në bazë të propozimeve të dhëna nga operatori i sistemit të transmissioinit apo operatori i sistemit të distribucionit, apo në bazë të pajtimit të arritur mes operatorëve dhe shfrytëzuesve të rrjetit. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave, autoritetet rregullative kombëtare duhet të sigurohen se tarifat e transmissioinit dhe distribucionit janë jodiskriminuese dhe pasqyrojnë kostot, dhe do duhej të marrin parasysh kostot afatgjata, marginale dhe të shmangura nga gjenerimi i distribuuar dhe masat për menaxhimin e kërkesës.

(37) Rregullatorët e energjisë do duhej të kenë autoritet për të nxjerrë vendime obligative për ndërmarrjet elektroenergjetike dhe të imponojnë ndëshkime efektive, proporcionale dhe bindëse për ndërmarrjet elektroenergjetike të cilat nuk u përmbahen obligimeve të veta, apo të propozojnë që një gjykatë kompetente t'i ndëshkojë të njëjtat. Rregullatorët e energjisë gjithashtu duhet të kenë autorizime për të vendosur, pa marrë parasysh aplikimin e rregullave konkurruese, masa përkatëse për të siguruar përfitime adekuate të konsumatorëve përmes promovimit të konkurrencës efektive të nevojshme për funksionim adekuat të tregut të brendshëm të energjisë elektrike. Krijimi i elektrocentraleve virtuale – programeve për çlirimin e energjisë elektrike sipas së cilave ndërmarrjet elektroenergjetike obligohen që të shesin apo të vënë në dispozicion një vëllim të caktuar të energjisë elektrike apo të sigurojnë qasje tek kapacitetet e tyre gjeneruese për furnizuesit e interesuar brenda një periudhe të caktuar kohore – paraqet një nga masat e mundshme të cilat mund të shfrytëzohen për të promovuar konkurrencë efektive dhe për të siguruar funksionim të mirëfilltë të tregut. Rregullatorët e energjisë do duhej poashtu të kenë autorizime për t'i kontribuar sigurimit të standardeve të larta të shërbimeve universale dhe publike, në pajtueshmëri me parimet e hapjes së tregut, mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm dhe efektivitetit të plotë të masave për mbrojtje të konsumatorëve. Këto dispozita nuk do të cenojnë autorizimet e Komisionit lidhur me aplikimin e rregullave të konkurrencës, përfshirë ekzaminimin e bashkimeve afariste të ndërmarrjeve me dimension të Komunitetit.

(38) Çfarëdo harmonizimi i autorizimeve të autoriteteve kombëtare rregullative do duhej të përfshijë kompetencat për të ofruar masa stimuluese për ndërmarrjet elektroenergjetike, dhe për të shqiptuar ndëshkime proporcionale dhe bindëse për ndërmarrjet elektroenergjetike apo për t'i propozuar gjykatës kompetente shqiptimin e ndëshkimeve të tilla. Për më tepër, autoritetet rregullative do duhej të kenë mundësi të kërkojnë informata relevante nga ndërmarrjet elektroenergjetike, të kryejnë hetime përkatëse dhe të mjaftueshme dhe të zgjidhin konteste.

(39) Tregu i brendshëm i energjisë elektrike vuan për shkak të mungesës së likuiditetit dhe transparencës, gjë që pengon alokimin efikas të resurseve dhe hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg. Ekziston nevoja për të shtuar konkurrencën dhe sigurinë e furnizimit, përmes mundësisë të integritit të termocentraleve të reja në rrjetin elektroenergjetik të të gjitha shteteve anëtare, duke inkurajuar në veçanti hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg. Besimi në treg, likuiditetin e tij dhe numrin e pjesëmarrësve të tregut duhet të shtohet dhe rrjedhimisht, mbikëqyrja rregullative e ndërmarrjeve që janë aktive në furnizimin e energjisë elektrike duhet të shtohet. Këto kushte duhet përcaktuar pa paragjykuar dhe në pajtueshmëri me të drejtën aktuale të Komunitetit që rregullon tregjet financiare. Rregullatorët e energjisë dhe rregullatorët e tregjeve financiare duhet të bashkëpunojnë për t'i ofruar njëri-tjetrit informata mbi tregjet përkatëse.

(40) Para miratimit të Udhëzimeve nga Komisioni, me të cilat do të përkufizohen kushtet e mbajtjes së regjistrave, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, e themeluar me Rregulloren (EC) No. 713/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009, me të cilën themelohet Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm Agjencia) dhe Komiteti i Rregullatorëve të Letrave me Vlerë në Evropë (CESR)⁷, i themeluar me vendim të Komisionit nr.

⁷ Shih faqen 1 të kësaj Gazete Zyrtare.

2009/77/EC,⁸ do duhej ta këshillojnë komisionin mbi përmbajtjen e udhëzimeve. Agjencia dhe CESR gjithashtu do duhej të bashkëpunojnë për të hetuar më tej dhe për të dhënë këshillat e veta lidhur me transaksionet dhe kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe me derivate që shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike, të cilat duhet t'i përmbahen kushteve të transparencës.

(41) Shtetet anëtare apo autoriteti rregullativ (në rastet kur Shtetet Anëtare e kanë përcaktuar asisoj) do të inkurajojnë zhvillimin e kontratave për furnizim.

(42) Tërë industria dhe afarizmi i Komunitetit, përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe të gjithë qytetarët e Bashkimit do të gëzojnë përfitime ekonomike nga tregu i brendshëm dhe rregullat e tregut të brendshëm që sigurojnë qarkullimin e lirë të kapitalit. Organi i pavarur në të cilin pala e prekur nga një vendim i rregullatorit shtetëror ka të drejtë të ankohet duhet të jetë në gjendje të ofrojë nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, në veçanti të konsumatorëve familjarë, dhe në rastet ku Shtetet Anëtare e konsiderojnë si të rrugës edhe ndërmarrjet e vogla duhet të gëzojnë garanci të shërbimit publik, posaçërisht sa i përket sigurisë së furnizimit dhe tarifave të arsyeshme, në kuptim të drejtësisë, konkurrencës dhe krimit të punësimit (në mënyrë të tërthortë). Këta konsumatorë gjithashtu duhet të kenë qasje në mekanizma që sigurojnë mundësi zgjedhjeje, drejtësi, përfaqësim, konkurrencë dhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve.

(43) Pothuajse të gjitha Shtetet Anëtare kanë vendosur që të sigurojnë konkurrencë në tregun e gjenerimit të energjisë elektrike përmes procedurave transparente të autorizimit. Megjithatë, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë mundësi për të kontribuar në sigurinë e furnizimit përmes lansimit të procedurave të tenderimit apo procedurave të ngjashme në raste kur përmes procedurave të autorizimit nuk ndërtohen kapacitete të mjaftueshme gjeneruese. Shtetet anëtare duhet të kenë mundësi të tenderimit të kapaciteteve të reja në bazë të kriterëve të publikuara, në interes të mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të teknologjive të reja inovative. Kapacitet e tilla të reja përfshijnë, mes tjerash, energjinë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe prodhimin e kombinuar ngrohje dhe energji elektrike.

(44) Në interes të sigurisë së furnizimit, duhet të monitorohet balanca mes furnizimit dhe kërkesës për Shtetet Anëtare, dhe ky lloj monitorimi duhet të përcillet nga raportet mbi gjendjen në nivel të Komunitetit, duke marrë parasysh ndërlidhjen e kapaciteteve mes regjioneve. Ky lloj monitorimi duhet të kryhet mjaft herët për të mundësuar ndërmarrjen e masave adekuate në rast se komprometohet furnizimi i energjisë elektrike. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së domosdoshme të rrjetit, përfshirë kapacitetet e interkoneksionit, duhet t'i kontribuojë sigurimit të furnizimit. Mirëmbajtja dhe ndërtimi i infrastrukturës së domosdoshme të rrjetit, përfshirë kapacitetet e interkoneksionit dhe gjenerimin e decentralizuar të energjisë elektrike, përbëjnë elemente të rëndësishme për të siguruar furnizim stabil të energjisë elektrike.

(45) Shtetet anëtare duhet të sigurohen se konsumatorët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla (kurdo që Shtetet Anëtare e vlerësojnë si të rrugës) gëzojnë të drejtën e të furnizuarit me energji elektrike të një

⁸ OJ L 25, 29.1.2009, p. 18.

cilësie të specifikuar dhe me çmime qartë të krahasueshme, transparente dhe të arsyeshme. Për të siguruar mbajtjen e standardeve të larta të shërbimeve publike në Komunitet, të gjitha masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare për të arritur këtë objektivë duhet t'i paraqiten Komisionit. Komisioni do duhej të publikojë rregullisht një raport që analizon masat e ndërmarra në nivel shtetëror drejt arritjes së standardit, për të krahasuar efektivitetin e tyre, me qëllim të dhënies së rekomandimeve sa i përket masave që duhet marrë në nivel shtetëror për të arritur standarde të larta të shërbimit publik. Shtetet anëtare do duhej të ndërmarrin masat e domosdoshme për të mbrojtur konsumatorët e cenueshëm në kontekst të tregut të brendshëm të energjisë elektrike. Këto masa mund të dallojnë sipas rrethanave të veçanta të shteteve anëtare dhe mund të përfshijnë masa që kanë të bëjnë me pagimin e faturave të energjisë elektrike apo masa tjera më të përgjithshme të ndërmarra në sistemin e sigurimit shoqëror. Në rastet kur shërbimet universale ofrohen nga ndërmarrjet e vogla, masat për të siguruar ofrimin e shërbimit të tillë mund të dallojnë sipas asaj nëse janë të parapara për konsumatorë familjarë apo për ndërmarrje të vogla.

(46) Respektimi për kushtin e shërbimit publik paraqet një kërkesë fundamentale të kësaj Direktive dhe është me rëndësi që standardet e përbashkëta minimale të respektuara nga të gjitha Shtetet Anëtare të specifikohen në këtë Direktivë dhe të marrin parasysh objektivat e mbrojtjes së konsumatorëve, sigurisë së furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe nivelin përkatës të konkurrencës tek të gjitha Shtetet Anëtare. Është me rëndësi që kërkesat e shërbimit publik të mund të interpretohen në çdo shtet, duke marrë parasysh rrethanat në të gjitha shtetet dhe duke iu përmbajtur të drejtës së Komunitetit.

(47) Duhet të jetë e mundshme për Shtetet Anëtare që të emërojnë një furnizues përfundimtar. Ky furnizues mund të jetë divizioni i shitjes i një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht, i cili kryen edhe funksione të distribucionit, me kusht që i njëjti t'i përmbahet kushteve që kjo Direktivë i parashtron sa i përket shthurjes.

(48) Duhet të jetë e mundshme që masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare të arrijnë objektivat e kohezionit social dhe ekonomik, për të përfshirë, në veçanti, sigurimin e masave adekuate stimuluese ekonomike, duke shfrytëzuar të gjitha veglat ekzistuese kombëtare dhe të Komunitetit. Vegla të tilla mund të jenë mekanizmat për kërkimin e përgjegjësive me të cilat garantohen investimet e domosdoshme.

(49) Në rast se masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare drejt përmbushjes së obligimeve publike përbëjnë ndihmë shtetërore sipas nenit 87 (1) të Traktatit, ato duhet t'i njoftohen Komisionit sipas nenit 88 (3) të Traktatit.

(50) Kushtet e shërbimit publik, përfshirë edhe konsideratën lidhur me shërbimet universale, përbëjnë standardet e përbashkëta minimale të cilat duhet të përforcohen edhe më tej për të siguruar se të gjithë konsumatorët, në veçanti konsumatorët e cenueshëm, do të jenë në gjendje të përfitojnë nga konkurrenca dhe çmimet e drejta. Kushtet e shërbimit publik duhet të definohen në nivel kombëtar, duke marrë parasysh rrethanat kombëtare; megjithatë, e drejta e Komunitetit duhet të respektohet nga Shtetet Anëtare. Qytetarët e Bashkimit dhe ndërmarrjet e vogla (në rastet kur kjo konsiderohet e rrugës nga Shtetet Anëtare) duhet të jenë në gjendje të gëzojnë obligime të tilla të shërbimit publik,

posaçërisht sa i përket sigurisë së furnizimit dhe çmimeve të arsyeshme. Një aspekt kyç i furnizimit të konsumatorëve është qasja në të dhëna objektive dhe transparente mbi konsumin. Rrjedhimisht, konsumatorët duhet të gëzojnë qasje tek të dhënat mbi konsumin e tyre dhe të dhënat që ndërlidhen me çmimet përkatëse, në mënyrë që të mund të ftojnë konkurrencën që të ofertojë në bazë të të dhënave në dispozicion. Konsumatorët gjithashtu duhet të kenë të drejtë që të informohen mbi konsumin e tyre. Parapagimet duhet të pasqyrojnë konsumin e mundshëm të energjisë elektrike dhe sistemet e ndryshme të pagesës që duhet të jenë jodiskriminuese. Informatat mbi kostot e energjisë që u ofrohen konsumatorëve do të përbëjnë masa stimuluese për kursim të energjisë sepse do t'u ofrojnë konsumatorëve informata të drejtpërdrejta mbi efektet e investimit në efikasitet të energjisë dhe të ndryshimit të mënyrave të sjelljes. Në këtë drejtim gjatë implementimit të plotë të Direktivës 2006/32/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 5 prill 2006 mbi efikasitetin e energjisë dhe shërbimeve energjetike vetëm për konsumatorë me një sasi të caktuar të konsumit, Shtetet Anëtare duhet të kenë këto dispozita në konsideratë si bazë për instalimin e sistemeve të mençura të njehsimit.

(51) Interesat e konsumatorëve duhet të jenë në qendër të kësaj direktive dhe cilësia e shërbimeve duhet të jetë përgjegjësia kryesore e ndërmarrjeve elektroenergjetike. Të drejtat ekzistuese të konsumatorëve duhet të fuqizohen dhe garantohen, dhe duhet të përfshijnë më shumë transparencë. Mbrojtja e konsumatorëve duhet të sigurojë se të gjithë konsumatorët e Komunitetit të mund të përfitojnë nga tregu konkurrues. Të drejtat e konsumatorëve duhet të sigurohen nga Shtetet Anëtare apo nga autoritetet rregullative të tyre (kurdo që Shtetet Anëtare të kenë vendosur asisoj).

(52) Informata të qarta dhe të kuptueshme mbi të drejtat e konsumatorëve në sektorin e energjisë duhet tu ofrohen këtyre të fundit. Komisioni mund të krijojë pas konsultimit me akterë relevantë, përfshirë edhe Shtetet Anëtare, autoritetet rregullative shtetërore, organizatat e konsumatorëve dhe ndërmarrjeve elektroenergjetike, një listë kontrolluese që u ofron konsumatorëve informata praktike mbi të drejtat e tyre. Kjo listë kontrolluese do duhej tu ofrohet të gjithë konsumatorëve dhe të vuhet në dispozicion të publikut.

(53) Varfëria energjetike paraqet një problem gjithnjë në rritje brenda Komunitetit. Shtetet anëtare që përballen me të do duhej të sajojnë plane kombëtare të veprimit apo kuadër përkatës për adresimin e varfërisë energjetike, duke synuar zvogëlimin e numrit të personave që vuajnë nga rrethana të tilla. Në çdo rast, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë furnizim të energjisë për konsumatorët e cenueshëm. Duke siguruar këtë, mund të shfrytëzohet një qasje e integruar, siç mund të jetë krijimi i një kornize të politikave sociale.

(54) Një nivel më i lartë i mbrojtjes së konsumatorëve garantohet duke vënë në dispozicion mjete efektive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për të gjithë konsumatorët. Shtetet anëtare duhet të krijojnë procedura të shpejta dhe efektive për zgjidhje të konflikteve.

(55) Duhet të bëhet e mundshme që të krijimi i sistemit inteligjent të matjes të bazohet në vlerësime ekonomike. Nëse gjatë këtij vlerësimi vërtetohet se funksionalizimi i një sistemi të tillët e matjes do të jetë ekonomikisht i arsyeshëm dhe do t'i pasqyrojë kostot në mënyrë adekuate dhe do tu ndihmojë konsumatorëve në zvogëlimin e kostove të energjisë.

(56) Çmimet e tregut do duhej të ofrojnë masa stimuluese përkatëse për zhvillimin e rrjetit dhe për investime në gjenerimin e energjisë elektrike.

(57) Promovimi i konkurrencës së drejtë dhe qasjes së lehtë për furnizues të ndryshëm dhe mundësimi i kycjes së kapaciteteve të reja të gjenerimit në rrjet do duhej të jetë e një rëndësie të veçantë për Shtetet Anëtare, në mënyrë që tu mundësohet konsumatorëve të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që i ofron tregu i liberalizuar i brendshëm i energjisë elektrike.

(58) Sa i përket krijimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike, Shtetet Anëtare do duhej të mundësojnë integrimin e tregjeve të tyre të brendshme dhe bashkëpunimin e operatorëve të sistemit në nivel regjional dhe të Komunitetit, duke inkorporuar edhe sistemet e izoluar që përbëjnë ishuj elektroenergetik që ende gjenden në Komunitet.

(59) Zhvillimi i një tregu të vërtetë të brendshëm të energjisë elektrike përmes një rrjeti të thurur të tërë Komunitetit, do duhej të jetë një nga caqet kryesore të kësaj Direktive, kësisoj, çështja e interkoneksioneve ndërkufitare dhe tregjeve rajonale do duhej të jetë një nga detyrat kryesore të autoriteteve rregullative, në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë, kurdo që kjo është relevante.

(60) Sigurimi i rregullave të përbashkëta për tregun e brendshëm dhe furnizimi më i gjerë i energjisë elektrike të qasshme për të gjithë, do duhej një tjetër cak i kësaj Direktive. Në këtë drejtim, çmimet e palëkundura të tregut do mund të paraqesin një masë stimuluese për interkoneksionet ndërkufitare dhe për investimet në kapacitete të reja gjeneruese, kur ato shpien drejt konvergencës së çmimeve (në aspekt afatgjatë).

(61) Autoritetet rregullative do duhej të ofrojnë informata mbi tregun, në mënyrë që t'i lejohej Komisionit ushtrimi i rolit të vet si vëzhgues dhe monitorues i tregut të brendshëm të energjisë elektrike në dhe evoluimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të tij, përfshirë aspekte të ndryshme si kapaciteti gjenerues, burimet e ndryshme të gjenerimit të energjisë elektrike, infrastruktura e transmisionit dhe distribucionit, cilësia e shërbimeve, tregtimit tejkuftar, menaxhimi i kongjestionit, investimet, çmimet me shumicë dhe për konsumatorë, likuiditeti i tregut dhe përmirësimet me qëllim të shtimit të pajtueshmërisë mjedisore dhe efiçencës. Autoritetet kombëtare rregullative do duhej t'i raportojnë para autoriteteve kompetente dhe para Komisionit ato shtete anëtare në të cilat çmimet dëmtojnë konkurrencën dhe funksionimin e mirëfilltë të tregut.

(62) Pasi që objektiva e kësaj Direktive, krijimi i një tregu të brendshëm të energjisë elektrike, nuk mund të arrihet si duhet nga Shtetet Anëtare por në nivel të Komunitetit, Komuniteti mund të miratojë masa të caktuara, në pajtim me parimin e subsidiaritetit të përcaktuar me nenin 5 të Traktatit. Në pajtim me parimin e proporcionalitetit, të përcaktuar në të njëjtin nen, kjo Direktivë nuk tejkalon masën e nevojshme për të arritur objektivin në fjalë.

(63) Sipas Rregullores (EC) No. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009, mbi kushtet e qasjes në rrjet të këmbimeve tejkuftare të energjisë elektrike⁹, Komisioni mund të

⁹ Shih faqen 15 të kësaj Gazete Zyrtare.

miratojë Udhëzime për të arritur nivelin e domosdoshme të harmonizimit. Këto udhëzime, të cilat përbëjnë masa obligative të implementimit, gjithashtu paraqesin një vegël të dobishme e cila mund të adaptohet me shpejtësi për të zbatuar dispozitat e kësaj Direktive.

(64) Masat e domosdoshme për implementimin e kësaj Direktive do duhej të adaptohen në pajtim me vendimin e Këshillit 1999/468/EC të datës 28 qershor 1999, me të cilin përcaktohet procedura për ushtrimin e autorizimeve të implementimit të cilat i janë bartur Komisionit.¹⁰

(65) Në veçanti, Komisioni do duhej të ketë autorizime për të nxjerrë udhëzimet e domosdoshme për të siguruar një nivel minimal të harmonizimit që nevojitet për të arritur synimet e kësaj Direktive. Pasi që këto masa kanë fushëveprim të përgjithshëm dhe kanë për synim ndryshimin e elementeve jothelbësore të kësaj Direktive, duke e plotësuar atë me elemente të reja jothelbësore, ato duhet të miratohen në pajtim me procedurën rregullative dhe kujdesin e përcaktuar në nenin 5a të Direktivës 1999/468/EC.

(66) Në pajtim me pikën 34 të marrëveshjes ndërinstitucionale për ligjvënien më të mirë¹¹, Shtetet Anëtare inkurajohen të hartojnë, secila për vete dhe në interes të Komunitetit, tabelat e tyre përkatëse në të cilat do të ilustrohen, për aq sa është e mundur, korrelacionin mes kësaj Direktive dhe masave të transpozimitit, dhe që të njëjtat t'i bëjë publike.

(67) Marrë parasysh fushëveprimin e amendamenteve të bëra Direktivës 2000/54/EC me këtë rast, është e dëshirueshme për qartësinë dhe racionalizimin e procesit, që dispozitat në fjalë të vëhen prapë për votim, për t'i vendosur të gjitha në një vend si një tekst i vetëm i kësaj Direktive të re.

(68) Kjo Direktivë respekton të drejtat fundamentale dhe u përmbahet parimeve të njohura në Kartën e të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian.

KANË MIRATUAR DIREKTIVËN NË VIJIM:

KAPITULLI I

SFERA E RREGULLUAR, FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Sfera e rregulluar dhe fushëveprimi

Kjo Direktivë përbën rregullat e përbashkëta për gjenerimin, transmisionin, distribucionin dhe furnizimin e energjisë elektrike, dhe ofron dispozita për mbrojtjen e konsumatorëve, me qëllim të përmirësimit dhe integritimit të tregjeve konkurruese të energjisë elektrike në Komunitet. Me të përcaktohen rregullat që kanë të bëjnë me funksionimin e sektorit të energjisë elektrike, qasjen e hapur në treg, kriteret dhe procedurat e zbatueshme për ftesa dhe tenderë, dhe për dhënien e autorizimeve për operim të

¹⁰ OJ L 184, 17.7.1999, p. 23.

¹¹ OJ C 321, 31.12.2003, p. 1.

sistemeve. Në të gjithashtu përcaktohen obligimet për shërbime universale dhe të drejtat e konsumatorëve të energjisë elektrike, si dhe qartësohen kushtet e konkurrencës.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Direktive do të zbatohen përkufizimet në vijim:

1. 'gjenerim' do të thotë prodhimi i energjisë elektrike;
2. 'prodhues' do të thotë personi fizik apo juridik që gjeneron energji elektrike;
3. 'transmision' do të thotë transporti i energjisë elektrike në sistemet e ndërlidhura të tensionit tejet të lartë dhe tensionit të lartë, me qëllim të bartjes së saj tek konsumatorët fundorë apo tek distributorët. I njëjti nuk përfshin furnizimin;
4. 'operator i sistemit të transmisionit' do të thotë personi fizik apo juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të transmisionit në një zonë të caktuar, përfshirë edhe interkoneksionet e mundshme me sistemet tjera; i njëjti është përgjegjës edhe për aftësinë afatgjatë të sistemit për ta plotësuar kërkesën për transmision të energjisë elektrike;
5. 'distribucion' do të thotë transporti i energjisë elektrike në sisteme të distribucionit të voltazhit të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim të bartjes së saj tek konsumatorët. I njëjti nuk përfshin furnizimin;
6. 'operator i sistemit të distribucionit' do të thotë personi fizik apo juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të distribucionit në një zonë të caktuar, përfshirë edhe interkoneksionet e mundshme me sistemet tjera; i njëjti është përgjegjës edhe për aftësinë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën për distribucion të energjisë elektrike;
7. 'konsumator' do të thotë konsumatori i energjisë elektrike me shumicë apo pakicë;
8. 'konsumator me shumicë' do të thotë personi fizik apo juridik që blen energji elektrike me qëllim të rishitjes së saj brenda apo sistemit në të cilin ai është i themeluar;
9. 'konsumator fundor' nënkupton konsumatorët që blejnë energji elektrike për shfrytëzim vetanak;
10. 'konsumator familjar' nënkupton konsumatorët që blejnë energji elektrike për shfrytëzim brenda ekonomisë së tyre familjare, dhe nuk përfshin veprimtarinë afariste apo profesionale;
11. 'konsumator jofamiljar' nënkupton personin fizik apo juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për ekonominë familjare të tij dhe përfshin prodhuesit dhe konsumatorët me shumicë;
12. 'konsumator i privilegjuar' është konsumatori i cili mund të blejë lirisht energjinë elektrike nga furnizuesi të cilin vet e përzgjedh, në pajtim me nenin 33;
13. 'interkonektor' do të thotë pajisja për të lidhur sistemet elektroenergjetike;

14. 'sistem i interkonektuar' do të thotë një numër sistemesh të transmisionit dhe distribucionit që lidhen së bashku përmes një apo më shumë interkonektorësh;
15. 'linjë direkte' do të thotë linja elektroenergjetike që lidh një lokacion të izoluar të gjenerimit me një konsumator të izoluar apo një linjë elektroenergjetike që lidh një prodhues të energjisë elektrike me një ndërmarrje furnizuese të energjisë elektrike, me qëllim të furnizimit të drejtpërdrejtë të stabilimenteve të tyre, vartësve të tyre dhe konsumatorëve të privilegjuar;
16. 'precedenca ekonomike' nënkupton rangimin e burimeve të furnizimit të energjisë elektrike, në pajtueshmëri me kriteret ekonomike;
17. 'shërbimet ndihmëse' nënkuptojnë shërbimet e domosdoshme për operimin e sistemeve të transmisionit dhe distribucionit;
18. 'shfrytëzues i sistemit' nënkupton personin fizik apo juridik që furnizon apo furnizohet nga sistemi i transmisionit apo distribucionit;
19. 'furnizim' do të thotë shitja, përfshirë rishitjen, e energjisë elektrike tek konsumatorët;
20. 'ndërmarrje e integruar elektroenergjetike' do të thotë ndërmarrja e integruar vertikalisht apo horizontalisht;
21. 'ndërmarrje e integruar vertikalisht' do të thotë ndërmarrja elektroenergjetike apo grupi i ndërmarrjeve elektroenergjetike në të cilat i njëri person apo grup personash ka autorizime për të ushtruar kontroll të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi ndërmarrjen apo grupin që ushtron funksionet e transmisionit apo distribucionit njëkohësisht me funksionet e gjenerimit apo furnizimit të energjisë elektrike;
22. 'ndërmarrje e ndërlidhur' do të thotë ndërmarrjet e afiluar, në pajtim me kuptimin e dhënë në nenin 41 të Direktivës të Shtatë 84/349/EEC të Këshillit, të datës 13 qershor 1983, në bazë të nenit 44 (2) (g) të Traktatit mbi llogaritë e konsoliduara, dhe ndërmarrjet e asocuara, në pajtim me kuptimin e dhënë në nenin 33 (1)¹² të asaj Direktive, dhe/ose ndërmarrjet që u përkasin të të njëjtëve aksionarë;
23. 'ndërmarrje e integruar horizontalisht' do të thotë ndërmarrja që kryen së paku një nga funksionet elektroenergjetike (gjenerimi, transmisioni, distribucioni apo furnizimi i energjisë elektrike) dhe një veprimtari tjetër joelektroenergjetike;
24. 'procedura e tenderimit' do të thotë procedura përmes të cilës kushtet shtesë të planifikimit dhe kapacitetet zëvendësuese mbulohen nga furnizimet nga kapacitetet e reja apo ekzistuese të gjenerimit;
25. 'planifikimi afatgjatë' nënkupton planifikimin e nevojave për të investuar në kapacitete të gjenerimit dhe transmisionit dhe distribucionit në aspekt afatgjatë, me qëllim të mbulimit të kërkesave të sistemit elektroenergjetike dhe të sigurimit të furnizimit për konsumatorë;

¹² OJ L 193, 18.7.1983, p. 1.

26. 'sistem i vogël i izoluar' do të thotë sistemi me konsum më të vogël se 3 000 GWh në vitin 1996, ku më pak se 5% e konsumit vjetor fitohet përmes interkoneksionit me sisteme të tjera;

27. 'mikrosisteme të izoluar' do të thotë çdo sistem me konsum më të vogël se 500 GWh në vitin 1996, ku nuk ka lidhje me sistemet tjera;

28. 'siguria' do të thotë siguria e furnizimit dhe sigurimi i energjisë elektrike dhe siguria teknike;

29. 'menaxhimi i efijencës energjetike/kërkesës' do të thotë qasja e integruar që ka për qëllim ndikimin në sasinë dhe kohën e konsumit të energjisë elektrike, me qëllim të zvogëlimit të konsumit primar të energjisë dhe konsumit në kohë të ngarkesës së pikut duke i dhënë precedencë investimeve në masat e efijencës së energjisë apo në masat tjera, siç janë kontratat e furnizimit apo investimet në shtimin e kapaciteteve gjeneruese, nëse të njëjtat paraqesin opsionin më efektiv dhe ekonomik, duke marrë parasysh ndikimin mjedisor të zvogëlimit të konsumit, sigurinë e furnizimit dhe koston e distribucionit të ndërldhur me të;

30. 'burimet e ripërtëritshme të energjisë' nënkuptojnë burimet e ripërtëritshme jofosilike të energjisë (energji nga era, solare, gjeotermale, e baticës, ujore, gazrave nga depozitë, gazrave nga stabilimentet e trajtimit të kanalizimit dhe nga biogazi);

31. 'gjenerimi i distribuuar' nënkupton centralet e gjenerimit të kyçura në sistemin e distribucionit;

32. 'kontrata e furnizimit me energji elektrike' do të thotë kontrata për furnizimin e energjisë elektrike, por nuk përfshin derivativat elektroenergjetike;

33. 'derivativat elektroenergjetike' nënkuptojnë instrumentet financiare të specifikuar në pikat 5, 6 apo 7 të pjesës C të Shtojcës I të Direktivës 2004/39/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 21 prill 2004, mbi tregjet e instrumenteve financiare¹³, në të gjitha rastet kur instrumenti në fjalë ka të bëjë me energji elektrike;

34. 'kontroll' nënkupton të drejtat, kontratat dhe mjetet tjera të cilat ndaras apo në kombinim dhe në bazë të ligjit i japin një entiteti mundësinë e ushtrimit të ndikimit mbi një ndërmarrje, në veçanti përmes:

(a) pronësisë apo të drejtës për të shfrytëzuar asetet e një ndërmarrjeje;

(b) të drejtave apo kontratave të cilat i japin ndikim mbi përmbajtjen, votimin apo vendimet e marra nga organet e një ndërmarrjeje;

35. 'ndërmarrje elektroenergjetike' do të thotë çdo person fizik apo juridik që kryen së paku një nga funksionet vijuese: gjenerimi, transmissioni, distribucioni, furnizimi apo blerja e energjisë elektrike, dhe që është përgjegjës për detyra komerciale, teknike dhe mirëmbajtëse në këto, por jo edhe konsumatorët fundorë.

¹³ OJ L 145, 30.4.2004, p. 1.

KAPITULLI II

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR ORGANIZIMIN E SEKTORIT

Neni 3

Obligimi i shërbimit publik dhe mbrojtja e konsumatorit

1. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë, bazuar në organizatat e tyre ndërinstitucionale dhe duke pasur konsideratë për parimin e subsidiaritetit, pa paragjykuar paragrafin 2, se ndërmarrjet elektroenergjetike do të funksionojnë në pajtim me parimet e kësaj Direktive me qëllim të formimit të një tregu elektroenergjetik konkurrues, të sigurt dhe të qëndrueshëm në kuptim mjedisor dhe se nuk do të ketë diskriminim tek këto ndërmarrje sa i përket të drejtave dhe obligimeve të tyre.

2. Duke marrë parasysh dispozitat relevante të Traktatit, në veçanti nenin 86, Shtetet Anëtare mund t'u shqiptojnë ndërmarrjeve që veprojnë në sektorin e elektroenergjetikës obligime për shërbime publike të cilat mund të ndërlidhen me sigurinë, përfshirë sigurinë e furnizimit, rregullsinë, cilësinë dhe çmimin e furnizimit dhe mbrojtjes mjedisore, përfshirë eficiencën energjetike, energjinë nga burimet e ripërtëritshme dhe mbrojtjen klimatike. Këto obligime duhet të definohen në mënyrë të qartë, transparente, jodiskriminuese, dhe të vërtetueshme, dhe do të garantojnë barazi në qasje për ndërmarrjet elektroenergjetike të Komunitetit tek konsumatorët. Në lidhje me sigurinë e furnizimit, eficiencën e energjisë, menaxhimin e kërkesës dhe arritjen e caqeve mjedisore dhe caqeve të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, të cilave u referohet në këtë paragraf, Shtetet Anëtare mund të iniciojnë implementimin e planifikimit afatgjatë, marrë parasysh mundësinë që palët e treta të kërkojnë qasje në sistem.

3. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se të gjithë konsumatorët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla (në rastet kur Shtetet Anëtare kanë vendosur asisoj), do të thotë ndërmarrjet që punësojnë më pak se 50 individë dhe bilanci vjetor i së cilëve nuk tejkalon shifrën prej 10 milion eurosh, do të gëzojnë shërbim universal, do të thotë të drejtën për tu furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar brenda territorit të tyre, edhe atë me çmime lehtë të krahasueshme dhe transparente dhe jodiskriminuese. Për të garantuar sigurimin e shërbimeve universale, Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë një blerës fundor. Shtetet anëtare do tu imponojnë kompanive të distribucionit obligimin për të kyçur konsumatorët në rrjetin e tyre nën kushte dhe tarifa të përcaktuara në pajtim me procedurën e paraqitur në nenin 37 (6). Asnjë dispozitë e kësaj Direktive nuk do të pengojë Shtetet Anëtare në fuqizimin e pozitës së konsumatorëve familjarë, të vegjël dhe të mesëm, përmes promovimit të mundësive të grumbullimit vullnetar dhe përfaqësimit të klasës përkatëse të konsumatorëve.

Nënparagrafi i parë do të implementohet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese dhe nuk do të pengojë hapjen e tregut, siç përcaktohet në nenin 33.

4. Shtetet anëtare do të sigurojnë se të gjithë konsumatorët do të kenë të drejtë për të përzgjedhur furnizuesin, në bazë të marrëveshjeve të furnizimit, pa marrë parasysh se në cilin shtet anëtar është i regjistruar furnizuesi, përderisa furnizuesi t'i përmbahet rregullave të tregtimit dhe balancimit. Në këtë

drejtim, Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar se procedurat administrative nuk diskriminojnë ndërmarrjet e furnizimit të regjistruara në shtetet tjera anëtare.

5. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se:

(a) në rastet kur konsumatori dëshiron ta ndërrojë furnizuesin, duke iu përmbajtur kushteve të kontratës, ndryshimi të realizohet nga operatori në fjalë brenda tri javësh; dhe

(b) që konsumatorët të kenë të drejtë të pranojnë të gjitha të dhënat relevante të konsumit.

Shtetet anëtare do të sigurohen se të drejtat të cilave u referohet në pikat (a) dhe (b) t'i mundësohen të gjithë konsumatorëve në mënyrë jodiskriminuese në kuptim të koston, mundit dhe kohës.

6. Në rastet kur garantohet kompensimi financiar, format tjera të kompensimit dhe të drejtat ekskluzive të shteteve anëtare me qëllim të përmbushjes së obligimeve të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3, kjo do të bëhet në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente.

7. Shtetet anëtare do të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët finalë dhe (në veçanti) do të sigurojnë ekzistimin e masave adekuate mbrojtëse për t'i mbrojtur konsumatorët e cenueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të definojë konceptin e konsumatorëve të cenueshëm, i cili mund t'i referohet varfërisë energjetike dhe, mes tjerash, ndalimit të shkyçjes së energjisë elektrike për konsumatorët e tillë në raste kritike. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë aplikimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërlidhura me konsumatorët e cenueshëm. Në veçanti, ato duhet të sigurojnë ndërmarrjen e masave për të mbrojtur konsumatorët fundorë në vise të largëta. Ato do të sigurojnë nivel të lartë mbrojtjeje të konsumatorëve, posaçërisht sa i përket transparencës së kushteve dhe konditave kontraktuale, informatave të përgjithshme dhe mekanizmave për zgjidhje të kontesteve. Shtetet anëtare do të sigurojnë se konsumatorët e privilegjuar do të kenë mundësi të kalimit të shpejtë tek furnizuesit tjerë. Sa i përket konsumatorëve familjarë, masat janë dhënë në Shtojcën I.

8. Shtetet anëtare do të ndërmarrin masa adekuate, siç janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energji, që sjellin përfitime në sistemin e sigurimit social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cenueshëm, apo ofrimin e përkrahjes për përmirësime të efijencës së energjisë, adresimin e varfërisë energjetike kudo që e njëjta identifikohet, përfshirë edhe kontekstin më të gjerë të varfërisë. Këto masa nuk do të pengojnë hapjen efektive të tregut, të përcaktuar në nenin 33 apo funksionimin e tregut. Të njëjtat do t'i parashtrihen Komisionit kurdo që kjo të jetë relevante, në pajtim me dispozitat e paragrafit 15 të këtij neni. Njoftimet e tilla mund të përfshijnë edhe masat e ndërmarra nga sistemi i përgjithshëm i sigurimeve sociale.

9. Shtetet anëtare do të sigurohen se furnizuesit e energjisë elektrike do të specifikojnë në fatura dhe materiale promovuese të cilat ia dërgojnë konsumatorëve finalë të dhënat në vijim:

(a) kontributin e secilit burim të energjisë në miksturën përfundimtare të karburanteve që furnizuesi i ka shfrytëzuar gjatë vitit paraprak në nivel kombëtar, në mënyrë të kuptueshme dhe të krahasueshme;

(b) së paku të ofrojë referenca ndaj burimeve referente, siç janë faqet e internetit, ku informatat mbi ndikimin mjedisor, së paku sa i përket emetimit të CO₂ dhe mbetjeve radioaktive që rezultojnë nga prodhimi i energjisë elektrike nga mikstura e karburanteve që është shfrytëzuar nga furnizuesi gjatë vitit paraprak;

(c) informata lidhur me të drejtat e tyre sa i përket mjeteve për zgjidhje të kontesteve që i kanë në dispozicion në rast të shfaqjes së ndonjë mosmarrëveshjeje.

Sa u përket pikave (a) dhe (b) të nënparagrafit të fundit dhe në lidhje me energjinë elektrike të nxjerrë përmes këmbimeve elektroenergjetike apo importit nga ndonjë ndërmarrje jashtë Komunitetit, mund të shfrytëzohen shifrat e përgjithshme të ofruara nga këmbimi apo ndërmarrja në fjalë për vitin paraprak.

Autoriteti rregullative apo autoritetet tjera kompetente kombëtare do të ndërmarrin hapat e domosdoshëm për të siguruar ofrimin e informatave për vitin paraprak nga furnizuesit për konsumatorët e tyre, në pajtim me këtë nen dhe në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme.

10. Shtetet anëtare do të implementojnë masa për arritjen e objektivave të kohezionit social dhe ekonomik dhe mbrojtjes mjedisore, të cilat përfshijnë masa të menaxhimit të eficiencës së energjisë/kërkesës dhe mjetet për të luftuar ndryshimet klimatike dhe sigurinë e furnizimit, sipas nevojës. Masa të tilla mund të jenë, në veçanti, sigurimi i masave adekuate të stimulimit ekonomik, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet kombëtare dhe të Komunitetit, për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e infrastrukturës së domosdoshme të rrjetit, përfshirë kapacitetet e interkoneksioneve.

11. Për të promovuar eficiencën e energjisë, Shtetet Anëtare apo autoritetet rregullative (kurdo që Shtetet Anëtare kanë përcaktuar këtë) do t'i rekomandojnë fuqishëm ndërmarrjeve elektroenergjetike optimizimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike, për shembull duke siguruar shërbime të menaxhimit energjetik, zhvilluar formula inovative të përcaktimit të çmimeve apo duke vënë sisteme të mençura të matjes apo rrjete të mençura.

12. Shtetet anëtare do të sigurojnë një pikë të vetme kontaktuese për tu ofruar konsumatorëve të gjitha informatat e domosdoshme lidhur me të drejtat e tyre, legjislacionin aktual dhe mjetet në dispozicion për zgjidhje të kontesteve. Këto pika kontaktuese mund të jenë pjesë e pikave të përgjithshme informative për konsumatorë.

13. Shtetet anëtare do të sigurojnë mekanizma të pavarur, siç janë ombudsmani energjetik apo organet e konsumatorëve, për të siguruar trajtim efikas të ankesave dhe zgjidhjen jogjyqësore të mosmarrëveshjeve.

14. Shtetet anëtare mund të vendosin të mos zbatojnë dispozitat e neneve 7, 8, 32 dhe/ose 34 në rast se zbatimi i tyre do të mund të pengonte kryerjen, ligjore apo faktike, të obligimeve të marra nga ndërmarrjet elektroenergjetike në interes të përgjithshëm ekonomik dhe në rast se zhvillimi i tregtisë nuk do të prekej në masë që do të ishte në kundërshtim me interesat e Komunitetit. Interesat e Komunitetit përfshijnë, mes tjerash, konkurrencën sa u përket konsumatorëve të privilegjuar, në pajtim me këtë Direktivë dhe me nenin 86 të Traktatit.

15. Pas implementimit të kësaj Direktive, Shtetet Anëtare do ta informojnë Komisionin për të gjitha masat e ndërmarra për të përmbushur obligimet universale dhe të shërbimeve publike, përfshirë mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbrojtjen mjedisore dhe ndikimin e tyre të mundshëm në konkurrencën vendore dhe ndërkombëtare, pa marrë parasysh nëse ato masa kërkojnë derogim nga kjo Direktivë. Ato më pas do ta informojnë Komisionin çdo dy vite për të gjitha ndryshimet e bëra në ndërlidhje me ato masa, pa marrë parasysh nëse ato kërkojnë derogim nga kjo Direktivë.

16. Komisioni do ta themelojë, pas konsultimeve me palët relevante me interes, përfshirë Shtetet Anëtare, autoritetet rregullative kombëtare, organizatat e konsumatorëve dhe ndërmarrjet elektroenergjetike, duke shfrytëzuar progresin e arritur deri tani me partnerët socialë, një listë kontrolluese koncize dhe të qartë për konsumatorë, në të cilën do të ofrohen informata praktike lidhur me të drejtat e konsumatorëve të energjisë. Shtetet anëtare do të sigurojnë se furnizuesit apo operatorët e sistemit të distribucionit do të ndërmarrin të gjithë hapat e domosdoshëm për tu ofruar konsumatorëve të tyre nga një kopje të listës kontrolluese për konsumatorë të energjisë dhe të sigurojnë se ajo listë do të jetë në dispozicion të publikut.

Neni 4

Monitorimi i sigurisë së furnizimit

Shtetet anëtare do të sigurojnë monitorim të çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e furnizimit. Në rastet kur Shtetet Anëtare e konsiderojnë të rrugës, ato mund t'ia delegojnë këtë detyrë autoriteteve rregullative të përmendura në Nenin 35. Ky monitorim do të mbulojë, në veçanti, balancën e furnizimit dhe kërkesës në tregjet kombëtare, nivelin e pritur të kërkesës në të ardhmen dhe kapacitetet e parapara shtesë që planifikohen apo janë në ndërtim e sipër dhe cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve dhe masave për të mbuluar kërkesën e pikut dhe për të adresuar mungesën e një apo më shumë furnizuesve. Autoritetet kompetente do të publikojnë çdo dy vite, jo më vonë se deri më 31 korrik, një raport në të cilin nënvizohen të gjeturat nga monitorimi i çështjeve të sipërpërmendura si dhe të gjitha masat e ndërmarra apo të parapara për t'i adresuar ato çështje. Këtë raport do t'ia dorëzojë edhe Komisionit.

Neni 5

Rregullat teknike

Autoritetet rregullative (në rastet kur Shtetet Anëtare kanë kërkuar asisoj) ose Shtetet Anëtare do të sigurojnë definimin e kriterëve të sigurisë teknike dhe sajimin dhe publikimin e rregullave teknike që përbëjnë dizajnin minimal teknik dhe kushtet operative për kyçje në sistem të instalimeve gjeneruese, sistemeve të distribucionit, pajisjeve të konsumatorëve të kyçur në mënyrë të drejtpërdrejtë, qarqeve të interkoneksionit dhe linjave direkte. Këto rregulla teknike do të sigurojnë ndërveprueshmëri të sistemeve dhe do të jenë objektive dhe jodiskriminuese. Sipas nevojës, Agjencia mund të japë rekomandime përkatëse për arritje të kompatibilitetit me rregullat në fjalë. Këto rregulla do t'i bëhen të ditura Komisionit në pajtim me nenin 8 të Direktivës 98/34/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të

datës 22 qershor 1998, ku përcaktohet procedura për sigurimin e informatave në fushën e standardeve teknike dhe rregulloreve dhe rregullave mbi shërbimet e shoqërive informative.¹⁴

Neni 6

Promovimi i bashkëpunimit rajonal

1. Shtetet anëtare dhe autoritetet rregullative do të bashkëpunojnë mes veti me qëllim të integritetit të tregjeve të tyre kombëtare në një apo më shumë nivele rajonale, si hap i parë drejt krimit të një tregu tërësisht të liberalizuar të brendshëm. Veçanërisht, autoritetet rregullative (në rastet kur Shtetet Anëtare kanë përcaktuar asisoj) dhe Shtetet Anëtare duhet të promovojnë dhe lehtësojnë bashkëpunimin mes operatorëve të sistemit të transmisionit në nivel rajonal, përfshirë çështjet ndërkuftare, me qëllim të krijimit të një tregu konkurrues të energjisë elektrike, sigurimit të pajtueshmërisë së tij me kornizën ligjore, rregullative dhe teknike dhe mundësitë të integritetit të sistemeve të izoluara të cilat vazhdojnë të mbesin ishuj energjetik në Komunitet. Zona gjeografike e mbuluar me bashkëpunim të tillë rajonal do të përfshijë bashkëpunimin në zonat gjeografike të definuara në pajtim me nenin 12 (3) të Rregullores (EC) No. 714/2009. Bashkëpunimi i tillë mund të mbulojë edhe zona tjera gjeografike.

2. Agjencia do të bashkëpunojë me autoritetet rregullative kombëtare dhe operatorët e sistemit të transmisionit për të siguruar pajtueshmërinë e kornizave rregullative mes rajoneve, me qëllim të krijimit të një tregu konkurrues të brendshëm të energjisë elektrike. Në rastet kur agjencia konsideron se nevojiten rregulla për bashkëpunime të tilla, ajo do t'i japë rekomandimet përkatëse.

3. Shtetet anëtare do të sigurojnë, përmes implementimit të kësaj Direktive, që operatorët e sistemit të transmisionit të kenë një apo më shumë sisteme të integruara në nivel rajonal që mbulojnë dy apo më shumë shtete anëtare, për të alokuar kapacitetet dhe për të kontrolluar sigurinë e rrjetit.

4. Në rastet kur operatorët e sistemeve të transmisionit të integruar vertikalisht marrin pjesë në një ndërmarrje të përbashkët të themeluar për implementimin e bashkëpunimit në fjalë, ndërmarrja e përbashkët do të krijojë dhe zbatojë programe të pajtueshmërisë me të cilët përcaktohen masat që do të merren për të mos lejuar sjellje diskriminuese dhe antikonkurruese. Ky program i pajtueshmërisë do të përcaktojë obligimet specifike të punonjësve me qëllim të përmbushjes së objektivit – të moslejimit të sjelljeve diskriminuese apo antikonkurruese. Ai duhet të miratohet nga Agjencia. Pajtueshmëria me këtë program do të monitorohet pavarësisht, nga zyrtarët e pajtueshmërisë së operatorit të sistemit të transmisionit të integruar vertikalisht.

¹⁴ OJ L 204, 21.7.1998, p. 37.

KAPITULLI III

GJENERIMI

Neni 7

Procedura e autorizimit të kapaciteteve të reja

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit, Shtetet Anëtare do të nxjerrin një procedurë të autorizimit e cila do të zhvillohet në pajtim me objektivin kryesor dhe me kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

2. Shtetet anëtare do të përcaktojnë kriteret për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të gjenerimit në territorin e tyre. Gjatë përcaktimit të kriterëve përkatëse, Shtetet Anëtare do të shtjellojnë:

(a) Sigurinë e sistemit elektroenergjetik, instalimeve dhe pajisjeve të ndërlidhura;

(b) Mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike;

(c) Mbrojtjen e mjedisit;

(d) Shfrytëzimin e tokave dhe lokacionet;

(e) Shfrytëzimin e hapësirave publike;

(f) Efiçencën e energjisë;

(g) Natyrën e burimeve primare;

(h) Karakteristikat e veçanta të parashtruesit të kërkesës, siç janë aftësitë e tij teknike, ekonomike dhe financiare;

(i) Pajtueshmërinë me masat e miratuara në pajtim me nenin 3;

(j) Kontributin e kapacitetit gjenerues për plotësimin e caktuar të përgjithshëm të Komunitetit për konsumimin e së paku 20% të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme deri në vitin 2020, të cilit i referohet në nenin 3 (1) të Direktivës 2009/28/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 23 prill 2009 mbi promovimin dhe shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme¹⁵; dhe

(k) Kontributin e kapaciteteve gjeneruese në reduktimin e emetimeve.

3. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë ekzistimin e procedurave specifike të autorizimit për kapacitete të vogla të gjenerimit të decentralizuar apo të distribuuar, të cilat marrin parasysh madhësinë e tyre të limituar dhe ndikimet potenciale.

¹⁵ OJ L 140, 5.6.2009, p. 16.

Shtetet anëtare mund të përcaktojnë udhëzimet për këtë procedurë specifike të autorizimit. Autoritete kombëtare rregullative dhe autoritetet tjera kompetente vendore, përfshirë autoritetet planifikuese, do të rishikojnë këto udhëzime dhe mund të rekomandojnë ndryshimin e tyre.

Në rastet kur Shtetet Anëtare kanë përcaktuar procedura të veçanta për lejimin e shfrytëzimit të tokave për projekte të mëdha infrastrukturore të kapaciteteve gjeneruese, Shtetet Anëtare do të përfshijnë ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit brenda fushëveprimit të këtyre procedurave dhe do t'i implementojnë ato në mënyrë jodiskriminuese dhe brenda afatit përkatës kohor.

4. Procedurat dhe kriteret e autorizimit do të bëhen publike. Parashtruesit e kërkesave do të informohen mbi arsyet e refuzimit të autorizimit. Ato arsye duhet të jenë objektive, jodiskriminuese, mirë të bazuara dhe të arsyetuara. Parashtruesi i kërkesës duhet të ketë të drejtë ankese.

Neni 8

Tenderimi i kapaciteteve të reja

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë shtimin e sigurisë së furnizimit, ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe masat të menaxhimit të efijencës së energjisë/kërkesës, përmes procedurave të tenderimit apo procedurave tjera ekuivalente në kuptim të transparencës dhe mosdiskriminimit, në bazë të kriterëve të publikuara paraprakisht. Megjithatë, këto procedura mund të lansohen vetëm kur, në pajtim me procedurat e autorizimit, kapacitetet që do ndërtohen apo masat për menaxhimin e efijencës së energjisë/kërkesës janë të pamjaftueshme për të ofruar furnizim të sigurt.

2. Shtetet anëtare mund të sigurojnë mundësinë e tenderimit të kapaciteteve të reja në bazë të kriterëve të publikuara dhe në interes të mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të teknologjive të reja. Tenderimet e tilla mund të ndërlidhen me kapacitete të reja apo me masa për menaxhimin e efijencës energjetike/kërkesës. Megjithatë, procedurat e tenderit mund të lansohen vetëm kur, në pajtim me procedurat e autorizimit, kapacitetet që do ndërtohen apo masat që do ndërmerren janë të pamjaftueshme për të arritur këto objektiva.

3. Detajet e procedurës tenderuese për mjetet e kapacitetit gjenerues dhe masat menaxhimit të efijencës së energjisë/kërkesës duhet të publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian së paku gjashtë muaj para datës së mbylljes së tenderëve. Specifikacionet e tenderëve duhet t'i ofrohen të gjitha ndërmarrjeve të interesuara të themeluara në territorin e shteteve anëtare, në mënyrë që të ofrohet kohë e mjaftueshme për të dorëzuar tenderët. Me qëllim të sigurimit të transparencës dhe mosdiskriminimit, specifikat e tenderit do të përmbajnë një përshkrim të detajuar të specifikave të kontratës dhe të procedurës që duhet ndjekur nga të gjithë tenderuesit, si dhe një listë të gjerë të kriterëve të përzgjedhjes së tenderuesve dhe dhënies së kontratës, përfshirë masat stimuluese si subvencionet, të cilat ofrohen sipas tenderit. Këto specifikacione mund të ndërlidhen edhe me fushat të cilave u referohet në nenin 7 (2).

4. Në ftesat e tenderit për prodhimin e kapaciteteve të gjenerimit, duhet të kihet parasysh edhe oferta për furnizimin e energjisë elektrike me garanci afatgjata nga njësitë ekzistuese të gjenerimit, me kusht që kësaj të plotësohen edhe kërkesat tjera.

5. Shtetet anëtare do të përcaktojnë një autoritet apo organ publik ose privat të pavarur nga aktivitetet e gjenerimit, transmisionit, distribucionit dhe furnizimit të energjisë elektrike. Ky autoritet mund të jetë autoritet rregullativ sipas nenit 35 (1), i cili mund të jetë përgjegjës për organizimin, monitorimin dhe kontrollimin e procedurave të tenderimit të cilave u referohet në paragrafët 1 deri në 4 të këtij neni. Në rastet kur operatori i sistemit të transmisionit është tërësisht i pavarur nga aktivitetet tjera që nuk ndërlidhen me sistemin e transmisionit në kuptim të pronësisë, operatori i sistemit të transmisionit mund të jetë organi i përcaktuar si përgjegjës për organizimin, monitorimin dhe kontrollimin e procedurave të tenderimit. Ky autoritet apo organ do t'i ndërmerr të gjitha hapat e domosdoshme për të siguruar konfidencialitetin e informatave që i përmbajnë tenderët.

KAPITULLI IV

OPERIMI I SISTEMIT TË TRANSMISIONIT

Neni 9

Shturja e sistemeve të transmisionit dhe operatorëve të sistemit të transmisionit

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë se nga data 3 mars 2012:

(a) të gjitha ndërmarrjet që posedojnë sisteme të transmisionit të veprojnë si operatorë të sistemit të transmisionit;

(b) personi apo personat nuk guxojnë që:

(i) të ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi ndërmarrjen që kryen funksionet e gjenerimit apo furnizimit dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ushtrojnë kontroll apo të drejta mbi operatorin e sistemit të transmisionit apo sistemin e transmisionit; apo

(ii) të ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi operatorin e sistemit të transmisionit apo mbi sistemin e transmisionit dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të ushtrojnë çfarëdo kontrolli apo të drejte mbi ndërmarrjet që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit;

(c) i njëjti person apo persona nuk kanë të drejtë të emërojnë anëtarë të bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo organeve që ligjërisht përfaqësojnë ndërmarrjen e një operatori të sistemit të transmisionit apo sistemi të transmisionit, dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të ushtrojnë kontroll apo çfarëdo të drejte mbi ndërmarrjen që kryen funksione të gjenerimit apo furnizimit; dhe

(d) i njëjti person nuk ka të drejtë të bëhet anëtar i bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo organeve që ligjërisht e përfaqësojnë ndërmarrje që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit dhe të operatorit të sistemit të transmisionit apo sistemit të transmisionit.

2. Të drejtat të cilave u referohet në pikat (b) dhe (c) të paragrafit 1 përfshijnë, në mënyrë të posaçme:

(a) autoritetin për të ushtruar të drejta të votimit;

(b) autoritetin për të emëruar anëtarë të bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo organeve që ligjërisht e përfaqësojnë ndërmarrjen; apo

(c) mbajtjen e shumicës së aksioneve.

3. Për qëllime të paragrafit 1 (b), nocioni 'ndërmarrje që kryen funksione të gjenerimit apo furnizimit' do të konsiderohet edhe 'ndërmarrja që kryen funksione të prodhimit dhe furnizimit' sipas kuptimit të dhënë në Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009 mbi rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të gazit natyral¹⁶, ndërsa termet 'operator i sistemit të transmisionit' dhe 'sistem i transmisionit' do të nënkuptohen sipas përkufizimeve përkatëse të asaj Direktive.

4. Shtetet anëtare mund të lejojnë derogime nga pikat (b) dhe (c) të paragrafit 1 deri më 3 mars 2013, me kusht që operatorët e sistemit të transmisionit të mos jenë pjesë e ndërmarrjeve vertikalisht të integruara.

5. Obligimi i përcaktuar në paragrafin 1(a) do konsiderohet se është plotësuar në rastet kur dy apo më shumë ndërmarrje sistemet e transmisionit të të cilave kanë krijuar ndërmarrje të përbashkëta që veprojnë si operator i sistemit të transmisionit në sistemet përkatëse të transmisionit të dy apo më shumë shteteve anëtare. Asnjë ndërmarrje tjetër nuk mund të jetë pjesë e ndërmarrjes së përbashkët, përveç nëse miratohet sipas nenit 13 si operator i pavarur i sistemit apo si operator i pavarur i sistemit të transmisionit, për qëllime të Kapitullit V.

6. Në kuptim të zbatimit të këtij neni, kur personi të cilit i referohet në pikat (b), (c) dhe (d) të paragrafit 1 është shtet anëtar apo një organ tjetër publik, dy organe të ndara publike që ushtrojnë kontroll mbi operatorin e sistemit të transmisionit apo mbi një sistem të transmisionit në një anë dhe mbi një ndërmarrje që kryen funksione të gjenerimit apo furnizimit në anën tjetër, nuk do të konsiderohen i njëjti person.

7. Shtetet anëtare do të sigurohen se as informatat e ndjeshme afariste, të cilave u referohet në nenin 16 e të cilat mbahen nga operatori i sistemit të transmisionit që është pjesë e ndërmarrjes vertikalisht të integruar, e as stafi i atij operatori të sistemit të transmisionit nuk do të barten tek ndërmarrja që kryen funksione të gjenerimit dhe furnizimit.

¹⁶ Shih faqen 94 të kësaj Gazete Zyrtare.

8. Në rastet kur më 3 shtator të vitit 2009, sistemi i transmisionit i përket një ndërmarrje vertikalisht të integruar, Shteti Anëtar mund të vendosë të mos zbatojë paragrafin 1.

Në raste të tilla, Shtetet Anëtare në fjalë:

(a) nuk do të përcaktojnë një operator të pavarur të sistemit, në pajtim me nenin 13; dhe

(b) nuk do t'i përmbahen dispozitave të Kapitullit V.

9. Në rastet kur më 3 shtator të vitit 2009, sistemi i transmisionit i përket një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht dhe ekzistojnë aranzhime për të garantuar pavarësi më efektive të operatorit të sistemit të transmisionit se sa që garantohet me dispozitat e Kapitullit V, Shteti Anëtar mund të vendosë të mos zbatojë paragrafin 1.

10. Para se një ndërmarrje të miratohet dhe të përcaktohet si operator i sistemit të transmisionit sipas paragrafit 9 të këtij neni, ajo duhet të certifikohet në pajtime procedurat e përcaktuara në nenin 10 (4), (5) dhe (6) të kësaj Direktive dhe me nenin 3 të Rregullores (EC) Nr 714/2009, sipas së cilave Komisioni duhet të verifikojë aranzhimet e zbatueshme, për të garantuar pavarësi më efektive të operatorit të sistemit të transmisionit se sa ajo që garantohet me dispozitat e Kapitullit V.

11. Ndërmarrjet e integruara vertikalisht të cilat posedojnë sisteme të transmisionit në asnjë mënyrë nuk mund të ndalohen nga ndërmarrja e hapave për të qenë në pajtueshmëri me paragrafin 1.

12. Ndërmarrjet që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit nuk do të jenë në gjendje në asnjë mënyrë që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthortë të ushtrojnë çfarëdo të drejte mbi operatorët e sistemit të transmisionit në Shtetet Anëtare të cilat zbatojnë paragrafin 1.

Neni 10

Përcaktimi dhe certifikimi i operatorëve të sistemit të transmisionit

1. Para se një ndërmarrje të miratohet dhe përcaktohet si operator i sistemit të transmisionit, ajo duhet të certifikohet në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafët 4, 5 dhe 6 të këtij neni dhe nenit 3 të Rregullores (EC) Nr 714/2009.

2. Ndërmarrjet të cilat posedojnë sisteme të transmisionit dhe të cilat janë certifikuar nga autoritetet rregullative vendore si ndërmerrje në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 9 dhe sipas procedurës së certifikimit të përshkruar më poshtë, do të miratohen dhe përcaktohen si operatorë të sistemit të transmisionit nga Shtetet Anëtare. Informatat mbi përcaktimin e operatorëve të sistemit të transmisionit do t'i dërgohen Komisionit dhe të publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

3. Operatorët e sistemit të transmisionit do ta njoftojnë autoritetin rregullative për të gjitha transaksionet e planifikuara të cilat mund të kërkojnë rivlerësim të pajtueshmërisë së tyre me kushtet e nenit 9.

4. Autoritetet rregullative do të monitorojnë pajtueshmërinë e vazhdueshme të operatorit të sistemit të transmisionit me kërkesat e nenit 9. Ato do të hapin procedurën e certifikimit për të siguruar pajtueshmërinë:

(a) pas njoftimit nga operatori i sistemit të transmisionit, në pajtim me paragrafin 3;

(b) me iniciativë të tyre në rastet kur ka njohuri se ndryshimi i planifikuar i të drejtave apo ndikimit të pronarëve të sistemit të transmisionit apo operatorëve të sistemit të transmisionit do të shpie tek shkelja e nenit 9 apo në rastet kur ata kanë arsye të besojnë se një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur; ose

(c) pas kërkesës së arsyeshme nga Komisioni.

5. Autoritetet rregullative do të nxjerrin vendim mbi certifikimin e operatorit të sistemit të transmisionit, brenda një periudhe prej katër muajsh nga data e njoftimit nga operatori i sistemit të transmisionit apo nga data e parashtrimit të kërkesës nga Komisioni. Pas skadimit të kësaj periudhe, certifikimi do të konsiderohet i lejuar. Vendimi i shprehur apo i nënkuptuar nga autoriteti rregullative do të bëhet efektiv vetëm pas përfundimit të procedurave të përcaktuara në paragrafin 6.

6. Vendimi shprehimor apo i nënkuptuar i certifikimit të operatorëve të sistemit të transmisionit duhet t'i njoftohen pa vonesa Komisionit nga autoriteti rregullative, së bashku me të gjitha informatat relevante në lidhje me vendimin. Komisioni do të veprojë në pajtueshmëri me procedurën e përcaktuara në nenin 3 të Rregullores (EC) Nr. 714/2009.

7. Autoritetet rregullative dhe Komisioni mund të kërkojnë nga operatori i sistemit të transmisionit dhe ndërmarrjet që kryejnë funksione të gjenerimit apo të furnizimit çfarëdo informata relevante për kryerjen e detyrave sipas këtij neni.

8. Autoritetet rregullative dhe Komisioni duhet të ruajnë konfidencialitetin e informatave të ndjeshme afariste.

Neni 11

Certifikimi në lidhje me shtetet e treta

1. Në rastet kur certifikimi kërkohet nga pronari i sistemit të transmisionit apo operatori i sistemit të transmisionit që kontrollohet nga personi apo personat nga një shtet i tretë apo nga shtete të treta, autoriteti rregullative do ta njoftojë Komisionin.

Autoriteti rregullative poashtu do ta njoftojë Komisionin pa vonesë në rast se rrethanat të cilat do të rezultonin me fitimin e kontrollit nga një person apo persona nga shteti i tretë apo shtetet e treta mbi sistemin e transmisionit apo operatorin e sistemit të transmisionit.

2. Operatori i sistemit të transmisionit do ta njoftojë autoritetin rregullative nëse paraqiten rrethana të cilat mund të rezultojnë me fitimin e kontrollit mbi sistemin e transmisionit apo operatorin e sistemit të transmisionit nga personi apo personat nga shteti i tretë apo shtetet e treta.

3. Autoriteti rregullative do ta miratojë projektvendimin për certifikimin e operatorit të sistemit të transmisionit brenda katër muajsh nga data e njoftimit nga operatori i sistemit të transmisionit. E njëjta do të refuzojë certifikimin në rast se nuk është dëshmuar se:

(a) entiteti në fjalë është në pajtueshmëri me nenin 9; dhe

(b) para autoritetit rregullativ apo autoritetit tjetër kompetent të përcaktuar nga Shteti Anëtar se certifikimi nuk do të rrezikojë furnizimin e energjisë të shtetit anëtar dhe të Komunitetit. Gjatë shtjellimit të kësaj pyetjeje, autoriteti rregullative apo autoriteti tjetër kompetent i përcaktuar do të merr parasysh:

(i) të drejtat dhe obligimet e Komunitetit ndaj shtetit të tretë sipas të drejtës ndërkombëtare, përfshirë këtu marrëveshjet e arritura me një apo më shumë shtete të treta në të cilat Komuniteti është palë dhe të cilat adresojnë çështjet e sigurisë së furnizimit me energji;

(ii) të drejtat dhe obligimet e shtetit anëtar ndaj shtetit të palës së tretë sipas marrëveshjeve të lidhura, me kusht që ato të jenë në pajtueshmëri me të drejtën e Komunitetit; dhe

(iii) faktet dhe rrethanat tjera specifike të rastit dhe shtetin e tretë në fjalë.

4. Autoriteti rregullative do t'ia përcjellë pa vonesë Komisionit vendimin e marrë, së bashku me të gjitha informatat relevante sa i përket atij.

5. Shtetet anëtare do t'i ofrojnë autoritetit rregullativ apo autoritetit tjetër të përcaktuar sipas paragrafit 3 (b), marrjen e qëndrimit të Komisionit mbi pikat në vijim, para se autoriteti rregullativ të marrë vendim mbi certifikimin:

(a) nëse subjekti në fjalë është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 9; dhe

(b) nëse certifikimi do të vë në rrezik sigurinë e furnizimit të energjisë për Komunitetin.

6. Komisioni do të shtjellojë kërkesat të cilave u referohet në paragrafin 5 menjëherë pas pranimit. Brenda një periudhe prej dy muajsh pas pranimit të kërkesës, ai do ta japë qëndrimin e vet për autoritetin rregullativ vendor apo autoritetit tjetër të përcaktuar, nëse kërkesa ka ardhur nga një autoritet i tillë.

Gjatë përgatitjes së opinionit, Komisioni mund të kërkojë qëndrimet e Agjencisë, shtetit anëtar në fjalë dhe palëve të interesuara. Në rast se Komisioni paraqet një kërkesë të tillë, periudha dymujore do të shtyhet edhe për ty muaj tjerë.

Në mungesë të një opinionit nga Komisioni brenda periudhave të parapara në paragrafin e parë dhe të dytë, Komisioni do vlerësohet se nuk ka vërejtje ndaj vendimit të autoritetit rregullativ.

7. Gjatë vlerësimit nëse kontrolli nga personi apo personat e shtetit të tretë apo shteteve të treta do të rrezikonin sigurinë e furnizimit brenda Komunitetit, Komisioni do të merr parasysh:

(a) faktet specifike të rastit dhe të shtetit të tretë apo shteteve të treta në fjalë; dhe

(b) të drejtat dhe obligimet e Komunitetit sa i përket atij shteti të tretë apo shteteve të treta, sipas të drejtës ndërkombëtare, përfshirë marrëveshjen e arritur me një apo më shumë shtete të treta palë e së cilës është Komuniteti dhe e cila adreson çështjet e sigurisë së furnizimit.

8. Autoriteti rregullativ kombëtar, brenda një periudhe prej dy javësh pas skadimit të periudhës së përmendur në paragrafin 6, do të miratojë vendimin e vet të fundit mbi certifikimin. Gjatë nxjerrjes së vendimit përfundimtar, autoriteti rregullativ do të merr parasysh opinionin e Komisionit. Në çdo rast, Shtetet Anëtare do të kenë të drejtë të refuzojnë certifikimin kur certifikimi i tillë vë në rrezik sigurinë e furnizimit të shtetit anëtar apo sigurinë e furnizimit të një shteti tjetër anëtar. Në rastet kur Shteti Anëtar ka përcaktuar një autoritet tjetër kompetent për të vlerësuar paragrafin 3 (b), i njëjti mund të kërkojë nga autoriteti rregullativ kombëtar që të miratojë vendimin e vet përfundimtar në pajtim me vlerësimin e bërë nga autoriteti kompetent. Vendimi përfundimtar i autoritetit rregullativ dhe opinionin i Komisionit do të publikohen së bashku. Në rastet kur vendimi përfundimtar dallon nga opinionin i Komisionit, Shteti Anëtar në fjalë duhet të ofrojë dhe publikojë, përkrah vendimit, arsyet për vendimin e marrë.

9. Asnjë pjesë e këtij neni nuk do të ndikojë mbi të drejtat e shtetit anëtar për të ushtruar, në pajtim me të drejtën e Komunitetit, kontrollin ligjor në vend për të mbrojtur interesat legjitim të sigurisë publike.

10. Komisioni mund të nxjerrë Udhëzime për të përcaktuar detajet e procedurës që duhet të ndiqet për aplikim të këtij neni. Këto masa, të parapara për ndryshimin e elementeve jothelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, do të nxirren në pajtim me procedurën rregullatore dhe duke ushtruar kujdesin të cilit i referohet në nenin 46 (2).

11. Ky nen, me përjashtim të paragrafit 3 (a), do të zbatohet edhe tek Shtetet Anëtare të cilat kanë shfrytëzuar të drejtën e derogimit sipas nenit 44.

Neni 12

Detyrat e operatorëve të sistemit të transmisionit

Çdo operator i sistemit të transmisionit do të jetë përgjegjës për:

(a) të siguroar aftësinë afatgjatë të sistemit për të mbuluar kërkesën e arsyeshme për transmision të energjisë elektrike, për operim, mirëmbajtje dhe zhvillim të një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, dhe efikas të transmisionit, që merr parasysh ndikimet mjedisore;

(b) sigurimin e mjeteve adekuate për të ofruar shërbimet;

(c) kontribuimin për sigurinë e furnizimit përmes kapaciteteve adekuate të transmisionit dhe për qëndrueshmërinë e sistemit;

(d) menaxhimin e rrjedhës së energjisë elektrike në sistem, duke marrë parasysh këmbimet me sisteme tjera të ndërlidhura. Në këtë drejtim, operatori i sistemit të transmisionit do të jetë përgjegjës për sigurimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas elektroenergjetik dhe, në këtë kontekst, për

sigurimin e disponueshmëria së të gjitha shërbimeve ndihmëse, përfshirë ato të ofruara si reagim ndaj kërkesës, me kusht që disponueshmëria në fjalë të jetë e pavarur nga çfarëdo sistemi tjetër me të cilin sistemi është i ndërlidhur;

(e) sigurimin e informatave të mjaftueshme për operatorët e sistemit tjetër me të cilin sistemi është i ndërlidhur, për të siguruar funksionim të sigurt dhe efikas, zhvillim të koordinuar dhe ndërfunksionim të sistemit të ndërlidhur;

(f) sigurimin e mosdiskriminimit mes shfrytëzuesve të sistemit apo klasave të shfrytëzuesve të sistemit, veçanërisht në favor të ndërmarrjeve relevante;

(g) ofrimin e informatave të nevojshme për qasje efikase në sistem të shfrytëzuesve të sistemit; dhe

(h) grumbullimin e pagesave për kongestion dhe pagesave sipas mekanizmit për kompensimin e operatorit të sistemit të transmisionit, në pajtueshmëri me nenin 13 të Rregullores (EC) No. 714/2009, duke u lejuar qasje palëve të treta dhe duke menaxhuar atë dhe duke u ofruar sqarime përkatëse në rast të mohimit të qasjes së tillë, gjë që duhet monitoruar nga autoritetet rregullative kombëtare; në kryerjen e detyrave sipas këtij neni, operatorët e sistemit të transmisionit parimisht duhet të ndihmojnë integrimin e tregut.

Neni 13

Operatori i pavarur i sistemit

1. Në rastet kur sistemi i transmisionit i përket një ndërmarrjeje vertikalisht të integruar më 3 shtator 2009, Shtetet Anëtare mund të vendosin që të mos zbatojnë nenin 9 (1) dhe të përcaktojnë një operator të sistemit që propozohet nga pronari i sistemit të transmisionit. Ky përcaktim duhet të miratohet nga Komisioni.

2. Shteti anëtar mund të miratojë dhe përcaktojë një operator të pavarur të sistemit vetëm në rastet kur:

(a) operatori kandidat ka demonstruar se është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 9 (1) (b), (c) dhe (d);

(b) operatori kandidat ka demonstruar se ka në dispozicion resurset e duhura financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat sipas nenit 12;

(c) operatori kandidat është përpjekur të jetë në pajtueshmëri me planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, që monitorohet nga autoriteti i rregullativ;

(d) pronari i sistemit të transmisionit ka demonstruar aftësi për të qenë në pajtueshmëri me obligimet e tij sipas paragrafit 5. Në këtë drejtim, ai duhet të sigurojë të gjitha projekt-aranzhimet kontraktuale me ndërmarrjen kandidatë dhe me subjektet tjera relevante; dhe

(e) operatori kandidat ka demonstruar aftësi për të qenë në pajtueshmëri me obligimet e veta sipas Rregullores (EC) No 713/2009, përfshirë bashkëpunimin e operatorëve të sistemeve të transmisionit në nivel regjional dhe evropian.

3. Ndërmarrja që është certifikuar nga autoriteti rregullativ si ndërmarrje në pajtim me kërkesat e nenit 11 dhe paragrafit 2 të këtij neni do të miratohet dhe përcaktohet si operator i pavarur i sistemit nga Shteti Anëtar. Procedura e certifikimit do t'i përmbahet nenit 10 të kësaj Direktive dhe nenit 3 të Rregullores (EC) No 714/2009 apo nenit 11 të kësaj Direktive.

4. Çdo operator i pavarur i sistemit do të jetë përgjegjës për lejimin dhe menaxhimin e qasjes së palëve të treta, përfshirë grumbullimin e pagesave, pagesave të kongjestionit dhe pagesave tjera sipas mekanizmit për kompensimin e operatorëve të sistemit të transmisionit, në pajtim me nenin 14 të Rregullores (EC) No. 714/2009, si dhe për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmisionit dhe për sigurimin e mbulimit të kërkesës së arsyeshme përmes planeve të investimit. Gjatë zhvillimit të sistemit të transmisionit, operatori i pavarur i sistemit do të jetë përgjegjës për planifikim (përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtim dhe komisionim të infrastrukturës së re. Për këtë qëllim, operatori i pavarur i sistemit do të veprojë si operator i sistemit të transmisionit, në pajtim me këtë Kapitull. Pronari i sistemit të transmisionit nuk do të jetë përgjegjës për lejimin dhe menaxhimin e qasjes së palëve të treta apo për planifikim të investimeve.

5. Në rastet kur është caktuar operatori i pavarur i sistemit, pronari i sistemit të transmisionit:

(a) do të sigurojë bashkëpunim relevant dhe do të përkrah operatorin e pavarur të sistemit në kryerjen e detyrave, përfshirë posaçërisht grumbullimin e informatave relevante;

(b) do të financojë investimet e vendosura nga operatori i pavarur i sistemit dhe të miratuara nga autoriteti rregullativ, ose të japë pëlqimin e tij për financim nga palët e interesuara, përfshirë operatorin e pavarur të sistemit. Aranzhimet relevante të financimit do të varen nga miratimi nga autoriteti rregullativ. Para miratimit të tillë, autoriteti rregullativ do të konsultohet me pronarin e sistemit të transmisionit dhe palët tjera të interesuara;

(c) do të mbulojë përgjegjësinë lidhur me asetet e rrjetit, përjashtuar përgjegjësinë për detyrat e operatorit të pavarur të sistemit; dhe

(d) do të ofrojë garanci për mundësimin e financimit për zgjerimet e rrjetit, me përjashtim të atyre investimeve kur, në pajtim me pikën (b), e ka dhënë pëlqimin për financim nga palët e interesuara, përfshirë edhe operatorin e pavarur të sistemit.

6. Në bashkëpunim me autoritetin rregullativ, autoriteti relevant shtetëror i konkurrencës do të ketë autorizime të plota për të monitoruar pajtueshmërinë e pronarit të sistemit të transmisionit me obligimet sipas paragrafit 5.

Neni 14

Sthurja e pronarëve të sistemit të transmisionit

1. Pronari i sistemit të transmisionit duhet të jetë i pavarur së paku sa i përket formës ligjore, organizimit dhe vendimmarrjes nga të gjitha veprimtaritë tjera që nuk kanë të bëjnë me transmisionin, në rastet kur është emëruar një operator i pavarur i sistemit.

2. Për të siguruar pavarësinë e pronarit të sistemit të transmisionit sipas paragrafit 1, së paku duhet të gjejnë zbatim kriteret minimale në vijim:

(a) personat përgjegjës për menaxhimin e pronarit të sistemit të transmisionit nuk do të marrin pjesë në strukturat e kompanisë së ndërmarrjes së integruar elektroenergjetike e cila është përgjegjëse, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për operimin ditor të gjenerimit, distribucionit dhe furnizimit të energjisë elektrike;

(b) masa përkatëse duhet të ndërmerren për të siguruar se interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e pronarit të sistemit të transmisionit janë marrë parasysh në formë që siguron se ata janë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur; dhe

(c) pronari i sistemit të transmisionit do të krijojë një program të pajtueshmërisë që i përcakton masat e ndërmarra për të shmangur veprimet diskriminuese dhe për të siguruar monitorim adekuat të kësaj. Programi i pajtueshmërisë do të përcaktojë obligimet specifike të punonjësve për të përmbushur këto objektiva. Programi i pajtueshmërisë, i cili përcakton masat e ndërmarra, do të dorëzohet nga personi apo organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë pranë autoritetit rregullativ dhe do të publikohet.

3. Komisioni mund të nxjerrë Udhëzime për të siguruar pajtueshmëri të plotë dhe efektive të pronarit të sistemit të transmisionit me paragrafin 2 të këtij neni. Këto masa, të dizajnuara për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj Direktive dhe për ta plotësuar atë, do të miratohen në pajtim me procedurën rregullative dhe kujdesin të cilit i bëhet referencë në nenin 46 (2).

Neni 15

Dispeçingu dhe balancimi

1. Pa paragjykuar furnizimin e energjisë elektrike në bazë të obligimeve kontraktuale, përfshirë ato që rrjedhin nga specifikacionet e tenderit, operatori i sistemit të transmisionit do të jetë përgjegjës për dispeçingun e instalimeve gjeneruese në zonën që mbulon dhe për caktimin e shfrytëzimit të interkoneksioneve me sisteme tjera.

2. Dispeçimi i instalimeve gjeneruese dhe shfrytëzimi i interkonektorëve do të përcaktohet në bazë të kriterëve të cilat janë miratuar nga autoritetet rregullative kombëtare dhe të cilat duhet të jenë objektive, të publikuara dhe të zbatuara në mënyrë jodiskriminuese, duke siguruar kështu funksionim adekuat të tregut të brendshëm të energjisë elektrike. Kriteret duhet të marrin parasysh precedencën

ekonomike të energjisë elektrike nga instalimet gjeneruese në dispozicion apo nga transferet e interkonektorëve me kufizimet teknike të sistemit.

3. Shteti anëtar do të kërkojë nga operatorët e sistemit të transmisionit të veprojnë në pajtim me nenin 16 të Direktivës 2009/28/EC gjatë dispeçimit të instalimeve gjeneruese që shfrytëzojnë burime të ripërtëritshme të energjisë. Ato gjithashtu mund të kërkojnë nga operatori i sistemit që t'i jep prioritet dispeçimit të instalimeve gjeneruese që prodhojnë ngrohje dhe energji elektrike njëkohësisht.

4. Shteti anëtar mund të japë udhëzime që prioritet t'i jepet dispeçimit të instalimeve gjeneruese të cilat shfrytëzojnë burimet primare të energjisë në vend, për shkak të sigurisë së furnizimit, deri në masë që nuk tejkalon në asnjë vit kalendarik 15% të energjisë primare të gjithmbarshme të domosdoshme për të prodhuar energjinë elektrike që konsumohet në shtetin anëtar.

5. Autoritetet rregullative (kurdo që kjo është vendosur kësisoj nga Shtetet Anëtare) ose Shtetet Anëtare do të kërkojnë nga operatorët e sistemit të transmisionit t'u përmbahen standardeve minimale të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit të transmisionit, përfshirë kapacitetet e interkoneksionit.

6. Operatorët e sistemit të transmisionit do të prokurojnë energjinë që shfrytëzojnë për të mbuluar humbjet e energjisë dhe kapacitetet rezervë të sistemit të tyre në bazë të procedurave transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg, kurdo që ata kanë këtë funksion.

7. Rregullat e miratuara nga operatorët e sistemit të transmisionit për balancim të sistemit elektroenergetik duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, përfshirë edhe rregullat për ngarkesat për shfrytëzuesit e sistemit të rrjetit të tyre për mosbalanc të energjisë. Kushtet dhe afatet, përfshirë rregullat dhe tarifat e ofrimit të shërbimeve të tilla nga operatorët e sistemit të transmisionit do të përcaktohen në bazë të metodologjisë së sajuar në pajtim me nenin 37 (6), në mënyrë jodiskriminuese dhe që reflekton kostot, dhe të publikuar.

Neni 16

Konfidencialiteti për operatorët e sistemit të transmisionit dhe pronarët e sistemit të transmisionit

1. Pa paragjykuar nenin 30 apo obligimet tjera ligjore për të zbuluar informatat, çdo operator i sistemit të transmisionit dhe çdo pronar i sistemit të transmisionit do të ruajë konfidencialitetin e informatave të ndjeshme afariste të kuptuara gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, dhe do të parandalojë zbulimin e informatave mbi veprimtarinë e tij të cilat mund t'i sjellin përparësi palëve të tjera në rast se zbulohen në mënyrë diskriminuese. Në veçanti, ai nuk do t'ia zbulojë informatat e ndjeshme afariste pjesëve të tjera të ndërmarrjes, përveç nëse kjo është e domosdoshme për realizimin e transaksioneve afariste. Për të siguruar respektim të plotë të rregullave mbi shthurjen e informatave, Shtetet Anëtare do të sigurojnë se pronari i sistemit të transmisionit dhe pjesa tjetër e ndërmarrjes të mos shfrytëzojnë të njëjtat shërbime, siç janë shërbimet juridike, përveç shërbimeve që janë tërësisht administrative apo funksioneve të teknologjisë informative.

2. Operatorët e sistemit të transmisionit nuk do të keqpërdorin informatat e ndjeshme afariste të palëve të treta në kontekst të ofrimit apo negocimit të qasjes së tyre në sistem, për qëllime të shitjes apo blerjes së energjisë elektrike nga ndërmarrjet në fjalë.

3. Informatat e domosdoshme për konkurrim efektiv dhe funksionim efikas të tregut do të bëhen publike. Ky obligim nuk paragjykon ruajtjen e konfidencialitetit të informatave të ndjeshme komerciale.

KAPITULLI V

OPERATORI I PAVARUR I TRANSMISIONIT

Neni 17

Asetet, pajisjet, personeli dhe identiteti

1. Operatorët e sistemit të transmisionit do të pajisen me të gjitha burimet teknike, fizike dhe financiare që janë të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të tyre nga kjo Direktivë dhe për kryerjen e veprimtarisë së tyre të transmisionit të energjisë elektrike, në veçanti me:

(a) asetet që janë të nevojshme për veprimtarinë e transmisionit të energjisë elektrike, përfshirë sistemin e transmisionit, janë në pronësi të operatorit të sistemit të transmisionit;

(b) personel të nevojshëm për veprimtarive e transmisionit të energjisë elektrike, përfshirë kryerjen e të gjitha detyrave korporative, punësohet nga operatori i sistemit të transmisionit;

(c) ofrimi i personelit me pagesë dhe shërbimeve për dhe nga çdo pjesë tjetër e ndërmarrjes së integruar vertikalisht është e ndaluar. Mirëpo, operatori i sistemit të transmisionit mund t'i përshkruaj shërbime ndërmarrjes së integruar vertikalisht me kusht që:

(i) ofrimi i atyre shërbimeve të mos jetë diskriminues për përdoruesit e sistemit, të jetë në dispozicion për të gjithë përdoruesit e sistemit me të njëjtat kushte dhe afate dhe të mos e kufizon, pengon apo parandalon konkurrencën në gjenerim apo furnizim; dhe

(ii) Kushtet dhe afatet e ofrimit të atyre shërbimeve të miratohen nga autoriteti rregullator;

(d) Pa paragjykim për vendimet e Organit Mbikëqyrës nga neni 20, burime të duhura financiare për projektet e ardhshme të investimeve dhe/apo zëvendësimi i aseteve ekzistuese do të vihen në dispozicion të operatorit të sistemit të transmisionit me kohë nga ndërmarrja e integruar vertikalisht pas një kërkesë të duhur nga operatori i sistemit të transmisionit.

2. Veprimtaria e transmisionit të energjisë elektrike përveç detyrave të numëruara në nenin 12 përfshinë së paku edhe detyrat në vijim:

(a) përfaqësimi i operatorit të sistemit të transmisionit dhe kontaktet me palët e treta dhe autoritetet rregullatore;

(b) përfaqësimi i operatorit të sistemit të transmisionit brenda Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO për energji elektrike);

(c) sigurimi dhe menaxhimi i qasjes së palëve të treta në bazë të parimit të mos-diskriminimit ndërmjet përdoruesve të sistemit apo klasave të përdoruesve të sistemit;

(d) mbledhja e të gjitha tarifave që ndërlidhen me sistemin e transmisionit, balancimin e tarifave për shërbimet ndihmëse siç është blerja e shërbimeve (balancimi i kostos, energjia për humbjet);

(e) operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i një sistemi efikas dhe ekonomik i transmisionit;

(f) planifikimi i investimeve që siguron aftësi afatgjatë të sistemit për ta plotësuar kërkesën e arsyeshme dhe garantimin e sigurisë së furnizimit;

(g) krijimi i kompanive të përbashkëta që përfshijnë një apo më shumë operatorë të sistemit të transmisionit, shkëmbime të energjisë, dhe akterë tjerë relevant që i ndjekin objektivat për zhvillimin dhe krijimin e tregjeve rajonale apo për të lehtësuar procesin e liberalizimit; dhe

(h) të gjitha shërbimet korporative, përfshirë shërbimet ligjore, kontabilitetin dhe shërbimet e TI-së.

3. Operatorët e sistemit të transmisionit organizohen në formë ligjore siç është referuar në nenin 1 të Direktivës së Këshillit 68/151/EEC ¹⁷.

4. Operatori i sistemit të transmisionit në identitetin e tij korporativ, komunikimin, markën dhe ndërtesën, nuk krijon huti përkitazi me identitetin e ndarë të ndërmarrjes së integruar vertikalisht apo të ndonjë pjese të saj.

5. Operatori i sistemit të transmisionit nuk i ndanë sistemet apo pajisjet e TI-së, ndërtesat fizike dhe sistemet e qasjes në siguri me ndonjë pjesë të ndërmarrjes së integruar vertikalisht e as nuk i përdor të njëjtit konsulent apo kontraktor të jashtëm për sistemet dhe pajisjet e TI-së dhe sistemet e qasjes në siguri.

6. Llogaritë e operatorëve të sistemit të transmisionit auditohen nga një auditor i ndryshëm nga ai që e bënë auditimin e ndërmarrjes së integruar vertikalisht apo ndonjë pjese të saj.

Neni 18

Pavarësia e operatorit të sistemit të transmisionit

1. Pa i paragjykuar vendimet e Organit Mbikëqyrës nga neni 20, operatori i sistemit të transmisionit do të ketë:

¹⁷ Direktiva e parë e Këshillit 68/151/EEC e datës 9 mars 1968 për koordinimin e garancive që kërkohen për mbrojtjen e interesave të shteteve anëtare dhe tjerëve, nga Shtetet Anëtare apo kompanitë në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 58 të traktatit, me qëllim që ato garanci t'i bëjë ekuivalente në tërë Komunitetin (OJ L 65, 14.3.1968, p.8).

(a) të drejta efektive për vendimmarrje, të pavarura nga ndërmarrja e integruar vertikalisht, përkitazi me asetet e nevojshme për të aktivitetet e tij, për mirëmbajtjen apo zhvillimin e sistemit të transmisionit dhe

(b) kompetencë për të marr para nga tregu i kapitalit në veçanti përmes huave dhe rritjes së kapitalit.

2. Operatori i sistemit të transmisionit në të gjithë kohën vepron në atë mënyrë që të sigurohet që i ka burimet që i nevojiten për të kryer veprimtarinë e transmisionit si duhet dhe në mënyrë efikase dhe të zhvillojë dhe mirëmbajë një sistem efikas, të sigurt dhe ekonomik të transmisionit.

3. Njësitë vartëse të ndërmarrjes së integruar vertikalisht që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit nuk kanë hise të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në operatorin e sistemit të transmisionit. As operatori i sistemit të transmisionit nuk ka hise të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në njësitë vartëse apo në ndërmarrjen vertikalisht të integruar që kryejnë funksione të gjenerimit apo furnizimit, e as nuk do të pranojnë dividenda apo çfarëdo përfitimi tjetër financiar nga ajo njësi vartëse.

4. Struktura e përgjithshme e menaxhimit dhe ligjet korporative të operatorit të sistemit të transmisionit sigurojnë pavarësi efektive të operatorit të sistemit të transmisionit në pajtim me këtë kapitull. Ndërmarrja e integruar vertikalisht nuk e përcakton qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sjelljen konkurruese të operatorit të sistemit të transmisionit lidhur me aktivitetin ditor të operatorit të sistemit të transmisionit dhe menaxhimit të rrjetit, apo në lidhje me aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e planit dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit në bazë të nenit 22.

5. Në përmbushjen e detyrave të tyre sipas nenit 12 dhe nenit 17(2) të kësaj Direktive, dhe në pajtim me nenit 14, 15 dhe 16 të Rregullores (EC) Nr. 714/2009, operatorët e sistemit të transmisionit nuk i diskriminojnë personat fizik apo juridik dhe nuk e kufizojnë, pengojnë apo parandalojnë konkurrencën në fushën e gjenerimit apo furnizimit.

6. Çdo marrëdhënie ekonomike dhe financiare ndërmjet ndërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të transmisionit, përfshirë huatë nga operatori i sistemit të transmisionit për ndërmarrjen e integruar vertikalisht, bëhet në përputhje me kushtet e tregut. Operatori i sistemit të transmisionit mbanë të dhëna të detajuara të atyre marrëdhënieve ekonomike dhe financiare dhe i vë ato në dispozicion të autoritetit rregullator sipas kërkesës.

7. Operatori i sistemit të transmisionit ia dorëzon autoritetit rregullator për miratim të gjitha marrëveshjet ekonomike dhe financiare me ndërmarrjen e integruar vertikalisht.

8. Operatori i sistemit të transmisionit e informon autoritetin rregullator lidhur me burimet financiare, të referuara në nenin 17(1)(d), që janë në dispozicion për projektet e ardhshme të investimeve dhe/apo për zëvendësim të aseteve ekzistuese.

9. Ndërmarrja e integruar vertikalisht përmbahet nga çdo veprim që e pengon apo paragjykon operatorin e sistemit të transmisionit nga respektimi nga ana e tij i obligimeve nga ky kapitull dhe nuk kërkon nga operatori i sistemit të transmisionit që të merr leje nga ndërmarrja e integruar vertikalisht për të përmbushur ato obligime.

10. Një ndërmarrje që është certifikuar nga autoriteti rregullator dhe është në pajtim me kërkesat e këtij kapitulli miratohet dhe caktohet si operator i sistemit të transmisionit nga Shteti Anëtar në fjalë. Procedura e certifikimit qoftë nga nenin 10 i kësaj Direktive dhe neni 3 i Rregullores (EC) Nr. 714/2009 apo nga neni 11 i kësaj Direktive do të vlejë për këtë qëllim.

Neni 19

Pavarësia e personelit dhe e operatorit të sistemit të transmisionit

1. Vendimet lidhur me emërimin dhe riemërimin, kushtet e punës përfshirë pagesën dhe ndërprerjen e mandatit të personave përgjegjës për menaxhimin dhe anëtarët e organeve administrative të operatorit të sistemit të transmisionit do të merren nga Organi mbikëqyrës i operatorit të sistemit të transmisionit i emëruar në pajtim me nenin 20.

2. Identiteti dhe kushtet për mandatin, kohëzgjatjen dhe ndërprerjen e mandatit të personave të nominuar nga Organi Mbikëqyrës për emërim apo riemërim si persona përgjegjës për menaxhim ekzekutiv dhe si anëtar të organeve administrative të operatorit të sistemit të transmisionit, dhe arsytet për çfarëdo vendimi të propozuar për ndërprerje të mandatit të tillë, i bëhet e ditur autoritetit rregullator. Ato kushte dhe vendime të referuara në paragrafin 1 bëhen të detyrueshme vetëm nëse autoriteti rregullator nuk ka bërë asnjë kundërshtim brenda tri javëve pasi që u janë bërë të ditura ato.

Autoriteti rregullator mund t'i kundërshtojë vendimet e referuara në paragrafin 1 kur:

(a) ngritën dyshime për pavarësinë profesionale të personit të nominuar që do të jetë përgjegjës për menaxhim dhe apo një anëtar të organeve administrative; apo

(b) në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit, ekzistojnë dyshime për arsyetimin e asaj ndërprerjeje të parakohshme.

3. Nuk ushtrohet kurrfarë pozite apo përgjegjësie profesionale, interes apo marrëdhënie afariste, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me ndërmarrjen e integruar vertikalisht apo me ndonjë pjesë të saj apo të aksionarëve të saj kontrollues përveç me operatorin e sistemit të transmisionit për një periudhë trevjeçare para emërimit të personave përgjegjës për menaxhimin dhe apo anëtarëve të organeve administrative të operatorit të sistemit të transmisionit të cilët bien në fushëveprimin e këtij paragrafi.

4. Personat përgjegjës për menaxhim dhe anëtarët e organeve administrative, dhe punonjësit e operatorit të sistemit të transmisionit nuk kanë pozita tjera profesionale apo përgjegjësi, interes apo marrëdhënie afariste, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ndonjë pjesë tjetër të ndërmarrjes së integruar vertikalisht apo me aksionarët e saj kontrollues.

5. Personat përgjegjës për menaxhim dhe anëtarët e organeve administrative, dhe punonjësit e operatorit të sistemit të transmisionit nuk mbajnë ndonjë interes apo pranojnë përfitime financiare, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga asnjë pjesë e tjetër të ndërmarrjes së integruar vertikalisht përveç me operatorin e sistemit të transmisionit. PAGESA E TYRE NUK DO TË VARET NGA

aktivitetet apo rezultatet e ndërmarrjes së integruar vertikalisht përveç atyre të operatorit të sistemit të transmisionit.

6. Të drejtat efektive të apelimit në autoritetin rregullator garantojnë për çdo ankesë nga personat përgjegjës për menaxhimin dhe apo anëtarët e organeve administrative të operatorit të sistemit të transmisionit kundër ndërprerjeve të parakohshme të mandatit të tyre.

7. Pas ndërprerjes së mandatit të tyre në operatorin e sistemit të transmisionit, personat përgjegjës për menaxhim dhe/apo anëtarët e organeve administrative nuk mbajnë asnjë pozitë profesionale apo përgjegjësi, interes apo marrëdhënie afariste me asnjë pjesë të ndërmarrjes së integruar vertikalisht tjetër nga operatori i sistemit të transmisionit, apo me aksionarët kontrollues për një periudhë prej jo më të shkurtër se katër vite.

8. Paragrafi 3 vlen për shumicën e personave përgjegjës për menaxhim dhe/apo anëtarëve të organeve administrative të operatorit të sistemit të transmisionit.

personat përgjegjës për menaxhim dhe/apo anëtarët e organeve administrative të operatorit sistemit të transmisionit të cilën nuk bien në fushëveprimin e paragrafit 3, nuk duhet të kenë ushtruar kurrfarë aktiviteti të menaxhimit apo aktivitet tjetër relevant në ndërmarrjen e integruar vertikalisht për një periudhë prej së paku gjashtë muajve para emërimit të tyre.

Nënparagrafi i parë i këtij paragrafi dhe paragrafët 4 deri 7 vlejnjë për të gjithë personat që i përkasin menaxhmentit ekzekutiv dhe ata që i raportojnë drejtpërsëdrejti atij për çështjet që ndërlidhen me funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit.

Meni 20

Organi mbikëqyrës

1. Operatori i sistemit të transmisionit e ka një organ mbikëqyrës i cili është i ngarkuar me marrjen e vendimeve që mund të kenë ndikim të dukshëm në vlerën e asetëve të aksionarëve brenda operatorit të sistemit të transmisionit, në veçanti vendimet lidhur me miratimin e planeve financiare vjetore dhe më të gjata, nivelin e borxhit të operatorit të sistemit të transmisionit dhe shumën e dividendës që i shpërndahet aksionarëve. Vendimet që bien në fushëveprimin e Organit mbikëqyrës i përjashtojnë ato që janë të ndërlidhura me aktivitetet ditore të operatorit të sistemit të transmisionit dhe menaxhmentit të rrjetit, dhe ato për aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të zhvilluar në pajtim me nenin 22.

2. Organi mbikëqyrës do të përbëhet nga anëtarë që përfaqësojnë ndërmarrjen e integruar vertikalisht, anëtarët që përfaqësojnë aksionarët e palëve të treta dhe, në rastet ku lejohet nga legjislacioni relevant i shteteve anëtare e parasheh një gjë të tillë, anëtarët që përfaqësojnë palët tjera të interesuara si punonjësit e operatorit të sistemit të transmisionit.

3. Paragrafi i parë i nenit 19(2) dhe nenit 19(3) deri (7) vlejnjë për së paku gjysmën e anëtarëve të Organit Mbikëqyrës minus njërit.

Neni 21

Programi i pajtueshmërisë dhe zyrtari i pajtueshmërisë

1. Shtetet anëtare sigurojnë që operatorët e sistemit të transmisionit të krijojnë dhe zbatojnë programin e pajtueshmërisë i cili vendosë masat e ndërmarra me qëllim që të sigurohet që sjellja diskriminuese është përjashtuar, dhe të sigurojë që pajtueshmëria me atë program të monitorohet në mënyrë adekuate. Programi i pajtueshmërisë i vendosë obligimet specifike të punonjësve për arritjen e atyre synimeve. Ai i nënshtrohet miratimit nga autoriteti rregullator. Pa paragjykim për kompetencat e rregullatorit nacional, pajtueshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga zyrtari i pajtueshmërisë.

2. Zyrtari i pajtueshmërisë emërohet nga organi mbikëqyrës, dhe miratohet nga autoriteti rregullator. Autoriteti rregullator mund ta refuzojë miratimin e zyrtarit të pajtueshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapacitetit profesional. Zyrtari i pajtueshmërisë mund të jetë si person fizik ashtu edhe person juridik. Neni 19 (2) deri (8) vlejnë për zyrtarin e pajtueshmërisë.

3. Zyrtari i pajtueshmërisë është përgjegjës për:

(a) monitorimin e zbatimit të programit të pajtueshmërisë

(b) shtjellimin a raportit vjetor, duke i vendosur masat e ndërmarra me qëllim të zbatimit të programit të pajtueshmërisë dhe dorëzimit të tyre në autoritetin rregullator;

(c) raportimin tek Organi Mbikëqyrës dhe lëshimin e rekomandimeve përkitazi me programin e pajtueshmërisë dhe zbatimin e tij;

(d) njoftimin e autoritetit rregullator për çfarëdo shkelje substanciale përkitazi me zbatimin e programit të pajtueshmërisë; dhe

(e) raportimin tek autoriteti rregullator i çfarëdo marrëdhënie ekonomike dhe financiare ndërmjet ndërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të transmisionit.

4. Zyrtari i pajtueshmërisë ia dorëzon autoritetit rregullator vendimet e propozuara për planin e investimeve apo për investimet individuale në rrjet. Kjo ndodh më së voni në kohën kur menaxhmenti dhe/apo organi kompetent administrativ i operatorit të sistemit të transmisionit i dorëzon ato tek Organi Mbikëqyrës.

5. Në rastet kur ndërmarrja e integruar vertikalisht, në kuvendin e përgjithshëm apo përmes votës së anëtarëve të Organit Mbikëqyrës e ka emëruar, parandaluar miratimin e vendimit me efekt të parandalimit apo vonimit të investimeve, të cilat sipas planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit është dashur të zbatohen në tri vitet e ardhshme, zyrtari i pajtueshmërisë e raporton këtë tek autoriteti rregullator, i cili pastaj vepron në pajtim me nenin 22.

6. Kushtet që qeverisin mandatin apo kushtet e punësimit të zyrtarit të pajtueshmërisë përfshirë kohëzgjatjen e mandatit të tij, i nënshtrohen miratimit të autoritetit rregullator. Këto kushte sigurojnë

pavarësi të zyrtarit të pajtueshmërisë, përfshirë duke i ofruar atij të gjitha burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij. Gjatë mandatit të tij, zyrtari i pajtueshmërisë nuk , mban asnjë pozitë tjetër profesionale, përgjegjësi apo interes, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthortë, në ndërmarrje të integruar vertikalisht apo në çfarëdo pjesë të saj apo tek aksionarët e saj kontrollues.

7. Zyrtari i pajtueshmërisë raporton rregullisht, qoftë gojarisht apo me shkrim, tek autoriteti rregullator dhe ka të drejtë që të raportojë rregullisht, qoftë gojarisht apo me shkrim tek Organi Mbikëqyrës i operatorit të sistemit të transmisionit.

8. Zyrtari i pajtueshmërisë mund të merr pjesë në të gjitha takimet e menaxhmentit apo organeve administrative të operatorit të sistemit të transmisionit, dhe ato të Organit Mbikëqyrës dhe kuvendit të përgjithshëm. Zyrtari i pajtueshmërisë merr pjesë në të gjitha takimet që adresojnë çështjet në vijim:

(a) kushtet për qasje në rrjet, siç është përkufizuar nga Rregullorja (EC) Nr. 714/2009, në veçanti përkitazi me tarifën, shërbimet e qasjes së palëve të treta, ndarjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

(b) projektet e ndërmarra me qëllim të funksionimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit të transmisionit, përfshirë investimet në interkoneksion dhe koneksion;

(c) blerjet e energjisë apo shitjet e nevojshme për funksionimin e sistemit të transmisionit.

9. Zyrtari i pajtueshmërisë monitoron pajtueshmërinë e operatorit të sistemit të transmisionit me nenin 16.

10. Zyrtari i pajtueshmërisë ka qasje në të gjitha të dhënat relevante dhe në zyrat e operatorit të sistemit të transmisionit dhe në të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e detyrave të tij.

11. Pas miratimit paraprak nga autoriteti rregullator, Organi Mbikëqyrës mund ta shkarkojë zyrtarin e pajtueshmërisë. Zyrtarin e pajtueshmërisë e shkarkon për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapacitetit profesional pas kërkesës së autoritetit rregullator.

12. Zyrtari i pajtueshmërisë ka qasje në zyrat e operatorit të sistemit të transmisionit pa njoftim paraprak.

Neni 22

Zhvillimi i rrjetit dhe kompetencat për të marr vendime për investimet

1. Çdo vit, operatorët e sistemit të transmisionit i dorëzojnë autoritetit rregullator planin dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit në bazë të kërkesës dhe furnizimit aktual dhe të parashikuar pas konsultimit më të gjithë hisedarët relevant. Ai plan i zhvillimit të rrjetit përmban masa efikase në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit.

2. Plani dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit në veçanti:

(a) ua tregon pjesëmarrësve kryesor të tregut infrastrukturën që nevojitet të ndërtohet apo të përmirësohet gjatë dhjetë viteve të ardhshme.

(b) përmban të gjitha investimet që tashmë janë vendosur dhe identifikon investimet e reja që do të ekzekutohen gjatë tri viteve të ardhshme; dhe

(c) ofron një kornizë kohore për të gjitha projektet e investimeve .

3. Gjatë shtjellimit të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, operatori i sistemit të transmisionit bënë supozime të arsyeshme për evoluimin e gjenerimit, furnizimit, konsumit dhe shkëmbimeve me vendet tjera, duke i marr para sysh planet e investimit për rrjetet rajonale dhe të mbarë Komunitetit.

4. Autoriteti rregullator konsultohet me të gjithë përdoruesit aktual dhe potencial të sistemit lidhur me planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit në mënyrë të hapur dhe transparente. Personat apo ndërmarrjet që pretendojnë se janë përdorues potencial të sistemit mund të kërkohen që t'i arsyetojnë ato pretendime. Autoriteti rregullator i publikon rezultatet e procesit të konsultimit, e në veçanti nevojat e mundshme për investime.

5. Autoriteti rregullator shikon nëse plani dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit i mbulon të gjitha nevojat për investime të identifikuar gjatë procesit të konsultimeve dhe nëse ai është në pajtim me planin jodetyrues dhjetëvjeçar të mbarë Komunitetit për zhvillimin e rrjetit (Plani dhjetëvjeçar i mbarë Komunitetit për zhvillimin e rrjetit) të referuar në nenin 8(3)(b) të Rregullores (EC) Nr. 714/2009. Nëse ngritët ndonjë dyshim përkitazi me konsistencën me Planin e mbarë Komunitetit për zhvillimin e rrjetit, autoriteti rregullator konsultohet me agjencinë. Autoriteti rregullator mund të kërkojë nga operatori i sistemit të transmisionit që ta ndryshojë dhe plotësojë planin e vet dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit.

6. Autoriteti rregullator e monitoron dhe vlerëson implementimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

7. Në rrethana kur operatori i sistemit të transmisionit, për arsye tjera nga ato që janë jashtë kontrollit të saj, nuk e ekzekuton një investim, i cili, sipas planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit është dashur të ekzekutohet në tri vitet e ardhshme, Shtetet Anëtare sigurojnë që autoriteti rregullator të kërkohet të merr së paku një nga masat në vijim për të siguruar që investimi në fjalë është bërë nëse ai investim është ende relevant në bazë të planit të mëvonshëm dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit:

(a) të kërkojë që operatori i sistemit të transmisionit të ekzekutojë investimet në fjalë;

(b) të organizojë një procedurë të tenderimit të hapur për çdo investitor për investimet në fjalë; apo

(c) ta obligojë operatorin e sistemit të transmisionit që ta pranojë një rritje të kapitalit për ta financuar investimin e nevojshëm dhe për t'i lejuar investitorët e pavarur që të marrin pjesë në kapital.

Në rastet kur autoriteti rregullator i ka përdorur kompetencat e tij sipas pikës (b) të nënparagrafit të parë, ai mund ta obligojë operatorin e sistemit të transmisionit që të pajtohet për një të një apo më shumë nga këto në vijim:

- (a) financimin nga pala e tretë
- (b) ndërtimin nga pala e tretë;
- (c) ndërtimin e aseteve të reja në fjalë vetë;
- (d) operimin e aseteve të reja vetë.

operatori i sistemit të transmisionit iu siguron investitorëve të gjitha informatat e nevojshme për realizimin e investimit, i lidhë asetet e reja me rrjetin e transmisionit dhe në përgjithësi i bënë përpjekjet më të mira për ta lehtësuar zbatimin e projektit të investimit.

Aranzimet relevante financiare i nënshtrohen miratimit të autoritetit rregullator.

8. Në rastet kur autoriteti rregullator i ka përdorur kompetencat e veta sipas nënparagrafit të parë të paragrafit 7, rregullimet relevante të tarifave e mbulojnë koston e investimeve në fjalë.

Neni 23

Kompetencat vendimmarrëse përkitazi me lidhjen e centralit të ri të energjetik në sistemin e transmisionit

1. Operatori i sistemit të transmisionit krijon dhe publikon procedura transparente dhe efikase përkitazi me lidhjen jodiskriminuese të centraleve të reja në sistemin e transmisionit. Ato procedura i nënshtrohen miratimit nga autoritetet rregullatore nacionale.
2. Operatori i sistemit të transmisionit nuk ka të drejtë që ta refuzojë lidhjen e centralit të ri në bazë të kufizimeve të mundshme në të ardhmen të kapaciteteve të rrjetit në dispozicion, siç është kongjestioni në pjesët e largëta të sistemit të transmisionit. Operatori i sistemit të transmisionit i paraqet të gjitha informatat e nevojshme.
3. Operatori i sistemit të transmisionit nuk ka të drejtë të refuzojë një pikë të re të lidhjes, në bazë të asaj që ajo lidhje do të shpie në shpenzime shtesë që ndërlidhen me rritjen e kapacitetit të nevojshëm të elementeve të sistemit në afërsi të pikës së lidhjes.

Kapitulli VI

Funksionimi i Sistemit të Distribucionit

Neni 24

Caktimi i operatorëve të sistemit të distribucionit

Shtetet anëtare e caktojnë apo kërkojnë nga ndërmarrjet që i kanë në pronësi apo që janë përgjegjëse për sistemet e distribucionit që të caktojnë, për një periudhë kohore që përcaktohet nga Shtetet Anëtare duke i pas para sysh konsideratat e efikasitetit dhe balancit ekonomik, një apo më shumë operatorë të sistemit të distribucionit. Shtetet anëtare sigurojnë që operatorët e sistemit të distribucionit të veprojnë në pajtim me nenin 25, 26 dhe 27.

Neni 25

Detyra e operatorëve të sistemit të distribucionit

1. Operatori i sistemit të distribucionit është përgjegjës për të siguruar që aftësia afatgjatë e sistemit t'i plotësojë kërkesat e arsyeshme për shpërndarje të energjisë elektrike, për funksionim, mirëmbajtje dhe zhvillim sipas kushteve ekonomike të një sistemi të distribucionit të energjisë elektrike që është i besueshëm dhe efikas në zonën e vet duke i kushtuar kujdes të duhur mjedisit dhe efikasitetit të energjisë.
2. Në asnjë rrethanë nuk duhet të diskriminojë ndërmjet përdoruesve të sistemit apo klasave të përdoruesve të sistemit, në veçanti në favor të ndërmarrjeve që ndërlidhen me të.
3. Operatori i sistemit të distribucionit iu siguron përdoruesve të sistemit informata që iu nevojiten atyre për të pasur qasje efikase, përfshi përdorimin e sistemit.
4. Një shtet anëtar mund të kërkojë nga operatori i sistemit të distribucionit që kur të heq nga përdorimi instalimet gjeneruese, t'i jep prioritet instalimeve gjeneruese që përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë apo mbeturinave apo që prodhojnë në kombinim nxehtësi dhe energji.
5. Secili operator i sistemit të distribucionit e blenë energjinë që e përdor për të mbuluar humbjet e energjisë dhe rezervon kapacitete në sistemin e vet sipas procedurave transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuara në treg, kurdo që e ka një funksion të tillë. Ajo kërkesë do të jetë pa paragjykim ndaj përdorimit të energjisë elektrike të fituar sipas kontratave të lidhura para 1 janarit 2002.
6. Në rastet kur operatori i sistemit të distribucionit është përgjegjës për balancimin e sistemit të distribucionit, rregullat e miratuara nga ai për atë qëllim janë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, përfshirë rregullat për ndërrimin e përdoruesve të sistemit të rrjeteve të tyre për çekuilibrim të energjisë elektrike. Kushtet dhe afatet përfshirë rregullat dhe tarifrat, për ofrimin e shërbimeve të tilla nga operatorët e sistemit të distribucionit vendosen në pajtim me nenin 37 (6) në mënyrë jodiskriminuese dhe që e reflekton koston e cila publikohet.

7. Gjatë planifikimit të zhvillimit të rrjetit të distribucionit, efikasiteti i energjisë/masat për menaxhimin e anës së kërkesës apo gjenerimi i shpërndarë që mund ta zëvendësoj nevojën për përmirësim apo zëvendësim të kapaciteteve të energjisë elektrike, merren para sysh nga operatori i sistemit të distribucionit.

Neni 26

Sthurja e operatorëve të sistemit të distribucionit

1. Kur operatori i sistemit të distribucionit është pjesë e ndërmarrjes së integruar vertikalisht, ai do të jetë i pavarur së paku sa i përket formës së tij ligjore, organizimit dhe vendimmarrjes nga aktivitetet që nuk ndërlidhen me shpërndarjen. Ato rregulla nuk krijojnë obligim për të ndarë pronësinë e aseteve të operatorit të sistemit të distribucionit nga ndërmarrja vertikalisht e integruar.

2. Përveç kërkesave nga paragrafi 1, kur operatori i sistemit të distribucionit është pjesë e ndërmarrjes së integruar vertikalisht, ai do të jetë i pavarur sa i përket organizimit dhe vendimmarrjes së tij nga aktivitetet tjera që nuk ndërlidhen me shpërndarjen. Për ta arritur këtë, vlejné kriteret minimale si më poshtë:

(a) ata persona që janë përgjegjës për menaxhimin e operatorit të sistemit të distribucionit nuk duhet të marrin pjesë në strukturat e kompanisë së integruar elektro-energjetike që janë përgjegjëse në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për funksionimin ditor të gjenerimit, transmisionit apo furnizimit me energji elektrike;

(b) duhet të merren masa të duhura në mënyrë që interesat profesional të personave përgjegjës për menaxhim të operatorit të sistemit të distribucionit të mbahen përgjegjës në atë mënyrë që siguron që ata janë të aftë të veprojnë në mënyrë të pavarur;

(c) operatori i sistemit të distribucionit duhet të ketë të drejta efektive të vendimmarrjes të pavarura nga ndërmarrja e integruar e energjisë elektrike, për sa i përket aseteve të nevojshme për funksionim, mirëmbajtje apo zhvillim të rrjetit. Për t'i përmbushur këto detyra, operatori i sistemit të distribucionit i ka në dispozicion burimet e nevojshme përfshirë ato njerëzore, teknike, fizike dhe financiare. Kjo nuk duhet ta parandalojë ekzistimin e mekanizmave të duhur të koordinimit për të siguruar mbrojtjen e të drejtat ekonomike dhe ato të mbikëqyrjes së menaxhmentit të kompanisë amë lidhur me kthimin e aseteve, që rregullohen në mënyrë të tërthortë në pajtim me nenin 37 (6), në njësinë vartëse. Kjo në veçanti ia mundëson kompanisë amë që ta miratojë planin vjetor financiar, apo ndonjë instrument ekuivalent të operatorit të sistemit të distribucionit dhe të vendosë kufizime globale në nivelet e borxhit të njësisë së vet vartëse. Ajo nuk do ta lejojë kompaninë amë që t'i jep instruksione lidhur me operacionet e përditshme, e as sa i përket vendimit individual përkitazi me vendimet individuale lidhur me ndërtimin apo përmirësimin e linjave të distribucionit, që nuk i tejkalojné kushtet dhe afatet e planit të miratuar financiar, apo të ndonjë instrumenti tjetër të barasvlershëm; dhe

(d) operatori i sistemit të distribucionit duhet ta krijojë një program të pajtueshmërisë, i cili vendosë masat e ndërmarrja për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese, dhe për të siguruar monitorim

adekuat të zbatimit të tij. Programi i pajtueshmërisë vendos obligime specifike të punonjësve për arritjen e atij synimi. Një raport vjetor, i cili i paraqet masat kryesore që janë ndërmarrë dorëzohet nga personi apo organi që është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë, zyrtari i pajtueshmërisë i operatorit të sistemit të distribucionit tek autoriteti rregullator i referuar në nenin 35(1) dhe publikohet. Zyrtari i pajtueshmërisë i operatorit të sistemit të distribucionit është plotësisht i pavarur dhe ka qasje në të gjitha informatat e nevojshme të operatorit të sistemit të distribucionit dhe të çdo ndërmarrje të bashkuar për përmbushjen e detyrave të tij.

3. Kur operatori i sistemit të distribucionit është pjesë e ndërmarrjes së integruar vertikalisht, Shtetet Anëtare sigurojnë që aktivitetet e operatorit të sistemit të distribucionit të monitorohen nga autoritetet rregullatore apo organet tjera kompetente në mënyrë që të mos mund ta shfrytëzojë integrimin e vet vertikal për ta penguar konkurrencën. Në veçanti, operatorët e sistemit të distribucionit të integruar vertikalisht në komunikimin dhe markat e tyre nuk krijojnë huti lidhur me identitetin e ndarë nga dega e furnizimit të ndërmarrjes së integruar vertikalisht.

4. Shtetet anëtare mund të vendosin që të mos i aplikojnë paragrafët 1, 2 dhe 3 për ndërmarrjet e integruara të energjisë elektrike të cilat iu shërbejnë më pak se 100 000 konsumatorëve të lidhur, apo që iu shërbejnë sistemeve të vogla dhe të izoluara.

Neni 27

Obligimi i konfidencialitetit të operatorëve të sistemit të distribucionit

Pa paragjykim ndaj nenit 30 apo ndaj ndonjë detyre ligjore për të zbuluar informata, operatori i sistemit të distribucionit duhet ta ruajë konfidencialitetin e informatave të ndjeshme afariste që i ka pranuar gjatë afarizmit të saj, dhe e ndalon zbulimin e informatave për veprimtarinë e vet që mund të ofrojnë përparësi afariste në mënyrë diskriminuese.

Neni 28

Sistemet e mbyllura të distribucionit

1. Shtetet anëtare mund t'i mundësojnë autoriteteve rregullatore nacionale apo organeve tjera kompetente që ta klasifikojnë sistemin i cili e shpërndan energjinë elektrike brenda një vendi të kufizuar gjeografik që ofron shërbime industriale apo ekonomike dhe që, pa paragjykim ndaj paragrafit 4, nuk furnizon konsumatorë të ekonomive familjare, si sistem i mbyllur i shpërndarjes nëse:

(a) për arsye specifike teknike apo të sigurisë, funksionimi apo procesi i prodhimit i përdoruesve të atij sistemi janë të integruar; apo

(b) ai sistem shpërndan energji elektrike për pronarin apo operatorin e sistemit apo ndërmarrjet e tyre përkatëse.

2. Shtetet anëtare mund t'i ofrojnë autoriteteve nacionale rregullatorë që ta përjashtojnë operatorin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes nga:

(a) kërkesat e nenit 25(5) për të blerë energjinë që e përdor për të mbuluar humbjet e energjisë elektrike dhe kapacitetin rezerve në sistemin e vet në bazë të procedurave transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg;

(b) kërkesat e nenit 32 (1) që tarifën, apo metodologjitë që përdoren për llogaritjet e tyre, të miratohen para hyrjes së tyre në fuqi në pajtim me nenin 37.

3. Në rastet kur lejohet përjashtimi sipas paragrafit 2, tarifën e aplikueshme, apo metodologjitë që përdoren për llogaritjen e tyre, rishikohen dhe miratohen në pajtim me nenin 37 me kërkesë të përdoruesit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes.

4. Përdorimi i rastësishëm i nga një numër i vogël i ekonomive familjare dhe asociacioneve të punësimit apo të ngjashme së bashku me pronarin e sistemit të shpërndarjes që gjendet në një zonë që shërbehet nga sistemi i mbyllur i shpërndarjes nuk e pengon miratimin e përjashtimit sipas paragrafit 2.

Neni 29

Operatori i Kombinuar

Neni 26 (1) nuk e parandalon punën e operatorit të kombinuar të transmisionit dhe distribucionit me kusht që ai operator të jetë në pajtim me nenet 9(1) apo 13 dhe 14, të Kapitullit V apo nëse bie në fushëveprim të nenit 44(2).

Kapitulli VII

SHTHURJA DHE TRANSPARENCA E LLOGARIVE

Neni 30

E drejta për qasje në llogari

1. Shtetet anëtare apo çfarëdo autoriteti kompetent që e caktojnë ato, përfshirë edhe autoritetet rregullatore të referuara në nenin 35, për aq sa është e nevojshme që të kryejnë funksionet e tyre, kanë të drejtë të qasjes në llogaritë e ndërmarrjeve të energjisë elektrike siç është paraparë në nenin 31.

2. Shtetet anëtare dhe cilido autoritet i caktuar përfshirë autoritetet rregullatorë, e ruajnë konfidencialitetin e informatave të ndjeshme afariste. Shtetet anëtare mund të mundësojnë zbulimin e informatave të tilla kur një gjë e tillë është e nevojshme në mënyrë që autoritetet kompetente t'i kryejnë funksionet e tyre.

Neni 31

Shturja e llogarive

1. Shtetet anëtare marrin masa të nevojshme për të siguruar që llogaritë e energjisë elektrike të mbahen sipas paragrafëve 2 dhe 3.

2. Ndërmarrjet e energjisë elektrike, pavarësisht se çfarë sistemi të pronësisë apo forme ligjore e kanë, hartojnë, dorëzojnë për qëllim të auditimit dhe publikimit. Llogaritë e tyre vjetore në pajtim me rregullat e së drejtës së tyre nacionale për llogaritë vjetore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar të miratuara në pajtim me Direktivën e Katërt të Këshillit 78/660/EEC të 25 korrikut 1978 në bazë të nenit 44 (2)(g) (*) të Traktatit për llogaritë vjetore të disa llojeve të caktuara të kompanive¹

Ndërmarrjet që nuk janë të obliguara me ligj që t'i publikojnë llogaritë e tyre vjetore e mbajnë nga një kopje të tyre në dispozicion të publikut në zyrën e tyre kryesore.

3. Ndërmarrjet e energjisë elektrike në llogaritë e tyre të brendshme, mbajnë llogari të ndara për secilin nga aktivitetet e tyre të shpërndarjes ashtu siç do të kishin qenë të obliguar të bënin në rast se aktivitetet e tyre në fjalë do të kryheshin nga ndërmarrje të ndara, me qëllim të shmangies së diskriminimit, tej-subvencionimit dhe pengimin e konkurrencës. Ato gjithashtu mbajnë llogari, që mund të konsolidohen, për aktivitete tjera të energjisë elektrike që nuk ndërlidhen me transmisionin apo shpërndarjen. Deri më 1 korrik 2007, ata mbajnë llogari të ndara për aktivitetet e furnizimit për konsumatorët e përshtatshëm dhe aktivitetet e furnizimit për konsumatorë të papërshtatshëm. Të hyrat nga pronësia e sistemit të transmisionit apo distribucionit specifikohen në llogari. Aty ku është e përshtatshme, ata mbajnë llogari të konsoliduara për aktivitetet tjera që nuk ndërlidhen me energjinë elektrike. Llogaritë e brendshme përfshijnë një tabelë të bilancit dhe llogaritë e përfitimit dhe humbjes për secilin aktivitet.

4. Auditimi i referuar në paragrafin 2 në veçanti vërteton që obligimi për ta shmangur diskriminimin dhe tej-subvencionimin të referuar në paragrafin 3 është duke u respektuar.

Kapitulli VII

ORGANIZIMI I QASJES NË SISTEM

Neni 32

Qasja nga palët e treta

1. Shtetet anëtare sigurojnë implementimin e sistemit të qasjes së palëve të treta në sistemet e transmisionit dhe distribucionit në bazë të tarifave të publikuara, që vlejnë për të gjithë konsumatorët dhe aplikohen në mënyrë objektive dhe pa kurrfarë diskriminimi ndërmjet përdoruesve të sistemit. Shtetet anëtare sigurojnë që ato tarifa, apo metodologjitë për llogaritjen e tyre, të miratohen para hyrjes së tyre në fuqi në pajtim me nenin në pajtim me nenin 37 dhe se ato tarifa, dhe metodologji – në rastet ku janë miratuar vetëm metodologjitë – publikohen para hyrjes së tyre në fuqi.

* Titulli i Direktivës 78/660/EEC është rregulluar për të marrë në konsideratë rinumërimin e neneve të Traktatit për Themelimin e Komunitetit Evropian në pajtim me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca e parë ishte për nenin 54(3)(g).

¹ OJ L 222, 14.8.1978, f. 11

2. Operatori i sistemit të transmisionit apo distribucionit mund ta refuzojë qasjen kur i mungon cilësia e nevojshme. Duhet të jepen arsytet e duhura për një refuzim të tillë, në veçanti kur e kemi para sysh nenin 3, dhe në bazë të kriterëve të arsyetuara objektive dhe teknike dhe ekonomike. Autoritetet rregullatore kur Shtetet Anëtare e kanë paraparë një gjë të tillë apo Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ato kriteret të aplikohen në mënyrë konsistente dhe që përdoruesi i sistemit të cilit iu është refuzuar qasja mund të përdorë procedurën për zgjidhjen e kontesteve. Autoritetet rregullatore gjithashtu sigurojnë, aty ku një gjë e tillë është e përshtatshme dhe kur kemi raste të refuzimit të qasjes, që operatori i sistemit të transmisionit dhe distribucionit ofrojnë informata relevante përkitazi me masat që do të jenë të nevojshme për ta përforcuar rrjetin. Palët që kërkojnë informata të tilla mund të ngarkohen me tarifë të arsyeshme që e reflekton koston e ofrimit të informatave të tilla.

Neni 33

Hapja e tregut dhe reciprociteti

1 Shtetet anëtare sigurojnë që konsumatorë të privilegjuar janë:

- (a) deri më 1 korrik 2004, konsumatorë të privilegjuar siç janë specifikuar në nenin 19(1) deri (3) të Direktivës 96/92/EC. Shtetet anëtare publikojnë deri më 31 janar të secilit vit kriteret për përkufizimin e atyre konsumatorëve të privilegjuar;
- (b) nga 1 korriku 2004, të gjithë konsumatorët e ekonomive familjare;
- (c) nga 1 korriku 2007, të gjithë konsumatorët.

2. Për të shmangur çekuilibrin në hapjen e tregjeve të energjisë elektrike:

(a) kontratat për furnizimin me energji elektrike me një konsumator të privilegjuar në sistem të një shteti tjetër anëtar nuk janë të ndaluara nëse konsumatori konsiderohet si i privilegjuar në dy sistemet e përfshira; dhe

Kur transaksionet siç është përshkruar në pikën (a) refuzohen për shkak se konsumatori është i privilegjuar në vetëm njërin nga dy sistemet, Komisioni mundet, duke e pasur para sysh situatën në treg dhe interesin e përbashkët, e obligojnë palën refuzuese që të ekzekutoj furnizimin e kërkuar me kërkesë të shtetit anëtar ku gjendet konsumatori i privilegjuar.

Neni 34

Linjat direkte

1. Shtetet Anëtare marrin masa të nevojshme për të siguruar:

(a) që të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike dhe ndërmarrjet e furnizimit të themeluara brenda territorit të tyre të furnizojnë ndërtesat e tyre, njësitë vartëse dhe konsumatorët e privilegjuar përmes linjës direkte; dhe

(b) të gjithë konsumatorët e privilegjuar brenda territorit të tyre të furnizohen përmes linjës direkte nga prodhuesi dhe ndërmarrjet e furnizimit.

2. Shtetet anëtare i vendosin kriteret për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e linjave direkte në territorin e tyre. Ato kriteret janë objektive dhe jodiskriminuese.

3. Mundësia e furnizimit me energji elektrike përmes linjës direkte të referuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk ndikon në mundësinë e kontraktimit të energjisë elektrike në pajtim me nenin 32.

4. Shtetet anëtare mund të lëshojnë autorizime për ndërtimin e linjës direkte për shkak qoftë të refuzimit të qasjes në sistem në bazë të, nëse është e përshtatshme, nenit 32 apo të hapin procedura për zgjidhjen e kontestit sipas nenit 37.

5. Shtetet anëtare mund të refuzojnë që ta autorizojnë linjën direkte nëse lëshimi i atij autorizimi do të ishte pengesë për dispozitat e nenit 3. Për refuzimin e tillë jepen arsyet e duhura.

Kapitulli IX

AUTORITETET NACIONALE RREGULLATORE

Neni 35

Caktimi dhe pavarësia e autoriteteve rregullatore

1. Secili shtet anëtar e cakton një autoritet të vetëm nacional rregullator në nivel nacional.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk e paragjykon caktimin e autoriteteve tjera rregullatorë në nivel rajonal brenda shteteve anëtare, me kusht që të ketë një përfaqësues të lartë për qëllime të përfaqësimit dhe kontaktimit në nivel të Komunitetit në Bordin e Rregullatorëve të Agjencisë në pajtim me nenin 14 (1) të Rregullores (EC) Nr. 713/2009.

3. Përmes derogimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Shteti Anëtar mund të caktojë autoritete rregullatorë për sisteme të vogla më ndonjë rajon të ndarë gjeografik konsumi i së cilit, në vitin 2008, ka përbërë më pak se 3 % të konsumit të përgjithshëm të shtetit anëtar të cilit i përket. Kjo shmangie është pa paragjykim të caktimit të një përfaqësuesi të lartë për përfaqësim dhe kontaktim në nivel të Komunitetit në Bordin e Rregullatorëve të Agjencisë në pajtim me nenin 14 (1) të Rregullores (EC) Nr. 713/2009.

Shtetet anëtare garantojnë pavarësinë e autoritetit rregullator dhe sigurojnë që ai të ushtrojë kompetencat e veta në mënyrë të paanshme dhe transparente. Për këtë qëllim, Shteti Anëtar siguron që, gjatë kryerjes së detyrave të rregullatorit të cilat iu janë akorduar atij nga kjo Direktivë dhe legjislacioni përkatës, autoriteti rregullator:

(a) është me ligj i dallueshëm dhe i pavarur në funksion nga çdo person tjetër fizik apo juridik;

(b) siguron që personeli i tij dhe personat përgjegjës për menaxhimin e tij:

(i) veprojnë në mënyrë të pavarur nga interesat e tregut; dhe

(ii) nuk kërkojnë apo marrin instruksione të drejtpërdrejta nga asnjë qeveri apo person fizik apo juridik gjatë kryerjes së detyrës së rregullatorit. Kjo kërkesë nuk e paragjykon bashkëpunimin e ngushtë, sipas nevojës, me autoritetet tjera relevante nacionale apo ndaj udhëzimeve të përgjithshme për politikën të lëshuara nga qeveria të cilat nuk ndërlidhen me detyrat dhe kompetencat e rregullatorit nga neni 37.

5. Për ta mbrojtur pavarësinë e autoritetit rregullator, Shtetet Anëtare në veçanti sigurojnë që:

(a) autoriteti rregullator mund të marrë vendime autonome, në mënyrë të pavarur nga çdo organ politik, dhe ka buxhet të ndarë vjetor, me autonomi në implementimin e buxhetit të ndarë, dhe burime adekuate njerëzore dhe financiare për t'i kryer detyrat e tij; dhe

(b) Anëtarët e bordit të autoritetit rregullator apo, në mungesë të bordit, menaxhmenti më i lartë i autoritetit rregullator emërohen për mandat të caktuar prej pesë deri shtatë viteve, me mundësi të vazhdimit edhe për një mandat.

Sa i përket pikës (b) të nënparagrafit të parë, Shtetet Anëtare sigurojnë skemë të duhur të rrotacionit të bordit apo menaxhmentit të lartë. Anëtarët e bordit apo, në mungesë të bordit menaxhmentit të lartë mund të shkarkohen nga pozita gjatë mandatit të tyre vetëm nëse ata nuk i përmbushin më kushtet e parapara në këtë nen apo janë shpallur fajtor për sjellje të pahijshme

sipas ligjit nacional.

Neni 36

Synimet e përgjithshme të autoritetit rregullator

Gjatë kryerjes së detyrave rregullatore të specifikuar në këtë Direktivë, autoriteti rregullator i ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme për të ndjekur synimet në vijim brenda kornizës së detyrave dhe kompetencave të veta të parapara në nenin 37, në konsultim të afërt me autoritetet tjera relevante nacionale përfshirë autoritetet e konkurrencës, dhe pa i paragjykuar kompetencat e tyre:

(a) promovimi në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë, autoritetet rregullatore të shteteve tjera anëtare dhe Komisionit, i një tregu të brendshëm të energjisë elektrike konkurrues, të sigurt dhe të qëndrueshëm në aspektin mjedisor brenda Komunitetit, dhe hapje efektive të tregut për të gjithë konsumatorët dhe furnizuesit në Komunitet dhe sigurimi i kushteve të duhura për funksionim efektiv dhe të besueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, duke i marr para sysh objektivat afatgjata;

(b) zhvillimi i tregjeve rajonale konkurruese dhe me funksionim të duhur brenda Komunitetit për t'i arritur synimet e referuara në pikën (a);

(c) eliminimi i kufizimeve në tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet shteteve anëtare përfshirë zhvillimin e kapaciteteve të duhura tej-kufitare të transmisionit për ta plotësuar kërkesën dhe për rritjen e integritit të tregjeve nacionale gjë që mund ta lehtësojë rrjedhën e energjisë elektrike në mbarë Komunitetin;

(d) ndihma për të arritur, në mënyrën më kosto-efektive, zhvillimin e sistemeve të sigurta, të besueshme, efektive dhe jodiskriminuese që janë të orientuara kah konsumatori, dhe që promovojnë sisteme adekuate, dhe janë në pajtim me synimet e përgjithshme të politikave të energjisë, efikasitetit të energjisë si dhe integrimin e gjenerimit në shkallë të madhe dhe atë në shkallë të vogël të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe distribuimit të gjenerimit si në transmision ashtu edhe në rrjetet e distribuicionit;

(e) lehtësimi i qasjes në rrjet për kapacitetet e reja të gjenerimit, në veçanti heqja e barrierave që do të mund ta parandalonin qasjen prurjeve të reja në treg dhe të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë;

(f) garantimi që operatorëve të sistemit dhe përdoruesve të sistemit t'u jepen stimulimet e duhura, si në periudhë afatshkurtër ashtu edhe afatgjatë, për të rritur efikasitetin në performancën e sistemit dhe për të nxitur integrimin e tregut;

(g) garantimi që konsumatorët të përfitojnë përmes funksionimit efikas të tregjeve të tyre nacionale, promovimi i konkurrencës efektive dhe ofrimi i ndihmës për të siguruar mbrojtje të konsumatorit;

(h) ofrimi i ndihmës për të arritur standarde të larta të shërbimit universal dhe publik në furnizimin me energji elektrike, kontribuimi në mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm dhe kontribuimi në kompatibilitetin e proceseve të shkëmbimeve të nevojshme të të dhënave për ndërrimin e konsumatorëve.

Neni 37

Detyrimet dhe kompetencat e autoritetit rregullator

1. Autoriteti rregullator i ka detyrimet e mëposhtme:

- . (a) rregullimin apo miratimin e tarifave të transmisionit apo shpërndarjes ose metodologjitë e tyre, sipas kritereve të transparencës;
- . (b) sigurimin e pajtueshmërisë së operatorëve të sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes dhe, aty ku është relevante, pronarëve të sistemeve, si dhe të çfarëdo veprimtarie të energjisë elektrike, sipas detyrimeve nga kjo Direktivë dhe legjislacionit tjetër relevant të Komunitetit, përfshirë çështjet ndërkufitare;
- . (c) bashkëpunimi në çështje ndërkufitare me autoritetin apo autoritetet rregullatorë të shteteve anëtare përkatëse dhe me Agjencinë;
- . (d) pajtueshmëria dhe zbatimi i të gjitha vendimeve detyruese të Agjencisë dhe të Komisionit;

- (e) raportimi vjetor tek Shtetet Anëtare, Agjencia dhe Komisioni mbi aktivitetin e tij dhe përmbushjen e detyrimeve. Raportet e tilla mbulojnë hapat e ndërmarrë dhe rezultatet e arritura në lidhje me secilin nga detyrimet e përcaktuara në këtë nen;
 - (f) sigurimi që nuk ka subvencione që ndeshen në mes të transmisioneve, shpërndarjes dhe aktiviteteve të furnizimit;
 - (g) monitorimi i planeve të investimit të operatorëve të sistemit të transmisionit, dhe paraqitja e vlerësimit të planeve të investimit të operatorëve të sistemit të transmisionit në raportin vjetor lidhur me pajtueshmërinë e tyre me planin zhvillimor të rrjetit që përfshinë tërë Komunitetin, i cili ceket në nenin 8(3)(b) të Rregullores (EC) Nr 714/2009; vlerësimi i tillë mund të përfshijë rekomandime për të ndryshuar planet e tilla të investimit;
 - (h) monitorimi i pajtueshmërisë dhe shqyrtimi e performancës së sigurisë së rrjetit dhe rregullave të besueshmërisë, si dhe përcaktimi apo miratimi i standardeve dhe kërkesave për cilësinë e shërbimeve dhe të furnizimit apo dhënia e kontributit për këtë së bashku me organet tjera kompetente;
 - (i) monitorimi i nivelit të transparencës, përfshirë çmimet e shitjeve me shumicë, dhe sigurimi i pajtueshmërisë së veprimtarive të ndërmarra lidhur me energjinë elektrike me detyrimet e transparencës;
 - (j) monitorimi i nivelit dhe efektshmërisë së tregut dhe konkurrencës në nivele të shitjeve me shumicë dhe me pakicë, përfshirë shkëmbimet e energjisë elektrike, çmimet për konsumatorët e ekonomive shtëpiake përfshirë sistemet e parapagimit, çmimet e ndërrimeve, çmimet e shkyçjes, tarifrat dhe ekzekutimi i shërbimeve të mirëmbajtjes, dhe ankesat e parashtruara nga konsumatorët e ekonomive shtëpiake, si dhe çfarëdo çrregullimi apo kufizimi i konkurrencës, përfshirë ofrimin e të dhënave relevante apo paraqitjen e rasteve relevante pranë organeve kompetente të konkurrencës;
- (k) monitorimi i dukurive të praktikave kufizuese kontraktuale, përfshirë ekskluzivitetin e dispozitave që mund të pengojnë konsumatorët afarist nga kontraktimi i njëkohshëm me më shumë se një furnizues apo që mund të kufizojnë zgjedhjen e tyre për të bërë një gjë të tillë dhe, aty ku është e nevojshme, të informojë autoritetet vendore të konkurrencës për praktikatat e tilla;
- (l) respektimi i lirisë së kontraktimit lidhur me kontratat për furnizim dhe kontratat afatgjate, me kusht që të jenë kompatible me ligjin e Komunitetit dhe në pajtim me politikat e Komunitetit.
- (m) monitorimi i kohës që marrin operatorët e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes për të bërë kyçjet dhe riparimet;
- (n) në bashkëveprim me organet tjera kompetente, të ndihmojë për të siguruar që masat për mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë ato të përcaktuara në Aneksin I, të jenë efektive dhe të zbatueshme;
- (o) së paku një herë në vit, publikimi i rekomandimeve në lidhje me pajtueshmërinë e çmimeve të furnizimit me nenin 3, dhe paraqitja e këtyre rekomandimeve te organet kompetente, kur një gjë e tillë është e duhur;

(p) sigurimi i qasjes në të dhënat e konsumit të konsumatorëve, sigurimi për shfrytëzim alternativ i një formati të harmonizuar në nivel kombëtar që është lehtë i kuptueshëm për të dhëna të konsumit, dhe qasja e shpejtë për të gjithë konsumatorët në të dhënat e tilla sipas pikës (h) të Aneksit I;

(q) monitorimi i zbatimit të rregullave që kanë të bëjnë me rolet dhe përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmisionit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, furnizuesve dhe konsumatorëve dhe palëve tjera në treg në pajtim me Rregulloren (EC) Nr. 714/2009;

(r) monitorimi i investimeve në kapacitetet prodhuese lidhur me sigurinë e furnizimit;

(s) monitorimi i bashkëpunimit teknik në mes të Komunitetit dhe operatorëve të sistemeve të transmisionit të shteteve të treta;

(t) monitorimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse të cekura në nenin 42; dhe

(u) dhënia e kontributit në pajtueshmërinë e proceseve të këmbimit të të dhënave për proceset më të rëndësishme të tregjeve në nivel rajonal.

2. Kur një gjë e tillë përcaktohet nga Shtetet Anëtare, detyrimet e monitorimit të përcaktuara në paragrafin 1 mund të zbatohen edhe nga organe tjera përveç autoritetit rregullator. Në rast të tillë, informatat që rezultojnë nga monitorimi i tillë duhet t'i vihen në dispozicion autoritetit rregullator sa më parë që të jetë e mundur.

Duke ruajtur pavarësinë e tyre, pa paragjykim për kompetencat e veta specifike dhe në pajtim me parimet e rregullimit më të mirë, autoriteti rregullator, kur është e përshtatshme, këshillon operatorët e sistemeve të transmisionit dhe, kur është e përshtatshme, bashkëpunon ngushtë me organet tjera vendore përkatëse gjatë zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 1.

Miratimet e dhëna nga autoriteti rregullator apo Agjencia sipas kësaj Direktive janë pa paragjykim për çfarëdo përdorimi të arsyetuar të kompetencave të tij në të ardhmen nga autoriteti rregullator sipas këtij neni apo për çfarëdo dënimi të shqiptuar nga organet tjera kompetente apo nga Komisioni.

3. Përveç detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, kur një operator i pavarur i sistemit caktohet sipas nenit 13, autoriteti rregullator:

- . (a) monitoron pajtueshmërinë e pronarit të sistemit të transmisionit dhe operatorit të pavarur të sistemit me detyrimet e tyre nga ky nen, dhe shqipton dënime për mospajtueshmëri në pajtim me paragrafin 4(d);
- . (b) monitoron raportet dhe komunikimin në mes të operatorit të pavarur të sistemit dhe pronarit të sistemit të transmisionit për të siguruar pajtueshmërinë e operatorit të pavarur të sistemit me detyrimet e tij, dhe në veçanti të aprovojë kontratat dhe të veprojë si autoritet për zgjedhjen e kontesteve në mes të operatorit të pavarur të sistemit dhe pronarit të sistemit të transmisionit lidhur me ankesat e paraqitura nga cilado palë në pajtim me paragrafin 11;

- . (c) pa paragjykim për procedurën nga neni 13(2)(c), për planin e parë dhjetëvjeçar zhvillimor të rrjetit miraton planifikimin e investimeve dhe planin shumëvjeçar zhvillimor të rrjetit të paraqitur në baza vjetore nga operatori i pavarur i sistemit;
- . (d) siguron që tarifat e qasjes në rrjet të mbledhura nga operatori i pavarur i sistemit të përfshijnë pagesën për pronarin e rrjetit apo pronarët e rrjetit, gjë që siguron kompensim adekuat për pasuritë e rrjetit dhe të gjitha investimet e bëra, me kusht që të jenë të shkaktuara në mënyrë ekonomike dhe efikase;
- . (e) ka kompetencë për të zbatuar inspektime, përfshirë inspektime të paparalajmëruara në objektet e pronarit të sistemit të transmisionit dhe operatorit të pavarur të sistemit; dhe
- . (f) monitoroni përdorimin e tarifave të grumbulluara nga operatori i pavarur i sistemit në pajtim me nenin 16(6) të Rregullores (EC) No 714/2009.

4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoriteteve rregullatore t'u jepen kompetencat e nevojshme për t'iu mundësuar zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafët 1, 3 dhe 6 në një mënyrë efikase dhe të shpejtë. Për këtë qëllim, autoriteti rregullator do të ketë së paku kompetencat në vijim:

- . (a) nxjerrjen e vendimeve detyruese për çështjet e energjisë elektrike;
- . (b) zbatimin e hetimeve mbi funksionimin e tregut të energjisë elektrike, dhe të vendos apo të shqiptojë çfarëdo masash të nevojshme dhe proporcionale për të promovuar konkurrencën efektive dhe për të siguruar funksionimin e mirëfilltë të tregut. Kur është e nevojshme, autoriteti rregullator poashtu ka kompetencë për të bashkëpunuar me autoritetit kombëtar të konkurrencës dhe rregullatorët e tregut financiar apo Komisionin në zbatimin e hetimit lidhur me ligjin e konkurrencës;
- (c) të kërkojë çfarëdo informacioni lidhur me energjinë elektrike që është i rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve të tij, përfshirë arsyetimin për çfarëdo refuzimi të lejimit të qasjes nga pala e tretë, dhe çfarëdo informacioni mbi masat e nevojshme për të përforcuar rrjetin;
- . (d) të shqiptojë dënime efektive, proporcionale dhe parandaluese lidhur me veprimet në fushën e energjisë elektrike që nuk janë në pajtim me detyrimet sipas kësaj Direktive apo çfarëdo vendimi ligjor detyrues të autoritetit rregullator apo të Agjencisë, ose për të propozuar që gjykata kompetente të shqiptojë dënime të tilla. Kjo përfshin kompetencën për t'i shqiptuar apo propozuar shqiptimin e dënimeve operatorit të sistemit të transmisionit deri në 10 % të qarkullimit vjetor të operatorit të sistemit të transmisionit, ose ndërmarrjes vertikalisht të integruar deri në 10 % të qarkullimit vjetor të ndërmarrjes vertikalisht të integruar, varësisht nga rasti, për mosrespektim të detyrimeve të tyre përkatëse në pajtim me këtë Direktivë; dhe
- . (e) të drejtat përkatëse për hetim dhe kompetencat përkatëse të instruksioneve për zgjedhjen e kontesteve nga paragrafët 11 dhe 12.

5. Përveç detyrimeve dhe kompetencave të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 4 të këtij neni, kur operatori i sistemit të transmisionit caktohet në pajtim me Kapitullin V, autoritetit rregullator i jepen së paku këto detyrime dhe kompetenca:

(a) shqiptimi i dënimeve në përputhje me paragrafin 4(d) për sjellje diskriminuese në favor të ndërmarrjes vertikalisht të integruar;

(b) monitorimi i komunikimeve ndërmjet operatorëve të sistemit të transmisionit dhe ndërmarrjes vertikalisht të integruar për të siguruar që operatori i sistemit të transmisionit të përmbush detyrimet e tij;

(c) të veprojë si autoritet për zgjedhjen e kontesteve në mes të ndërmarrjes vertikalisht të integruar dhe operatorit të sistemit të transmisionit lidhur me çfarëdo ankese të paraqitur në pajtim me paragrafin 11;

(d) të monitorojë marrëdhëniet komerciale dhe financiare, përfshirë huatë në mes të ndërmarrjes vertikalisht të integruar dhe operatorit të sistemit të transmisionit;

(e) të miratojë të gjitha marrëveshjet komerciale dhe financiare në mes të ndërmarrjeve vertikalisht të integruar dhe operatorit të sistemit të transmisionit, me kusht që të jenë në pajtim me kushtet e tregut;

(f) të kërkojë arsyetim nga ndërmarrja vertikalisht e integruar kur njoftohet nga zyrtari në pajtim me nenin 21(4). Arsyetimi i tillë duhet posaçërisht të përfshijë prova se nuk ka pasur sjellje diskriminuese në favor të ndërmarrjes vertikalisht të integruar;

(g) të zbatojë inspektime, përfshirë inspektime të paparalajmëruara në objektet e ndërmarrjes vertikalisht të integruar dhe operatorit të sistemit të transmisionit; dhe

(h) t'ia caktojë operatorit të pavarur të sistemit, të emëruar në pajtim me nenin 13, të gjitha detyrimet apo disa detyrime të caktuara të operatorit të sistemit të transmisionit në rast të shkeljeve të vazhdueshme nga operatori i sistemit të transmisionit të detyrimeve nga kjo Direktivë, posaçërisht në rast të sjelljes së përsëritur diskriminuese në dobi të ndërmarrjes vertikalisht të integruar.

6. Autoritetet rregullatore janë përgjegjëse për rregullimin apo miratimin e brenda një kohe të mjaftueshme para hyrjes së tyre në fuqi të metodologjive të përdorura për llogaritjen apo përcaktimin e kushteve për:

- . (a) lidhjen apo qasjen në rrjete vendore, përfshirë tarifat e transmisionit dhe shpërndarjes apo metodologjitë e tyre. Këto tarifa apo metodologji lejojnë që të zbatohen investime të nevojshme në rrjete në një mënyrë që lejon këto investime të sigurojnë qëndrueshmërinë e rrjeteve;
- . (b) sigurimin e shërbimeve të balancimit, të cilat kryhen në mënyrën më ekonomike të mundshme dhe të ofrojnë stimulime përkatëse për shfrytëzuesit e rrjetit për të balancuar hyrjet dhe daljet. Shërbimet e balancimit sigurohen në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese dhe bazohen në kritere objektive; dhe
- . (c) qasja në infrastrukturat ndërkufitare, përfshirë procedurat për ndarjen dhe menaxhimin e kapaciteteve dhe kongjestionit.

7. Metodologjitë apo kushtet e përcaktuara në paragrafin 6 publikohen.

8. Në rregullimin apo miratimin e tarifave apo metodologjive dhe shërbimeve të balancimit, autoritetet

rregullatore sigurojnë që operatorëve të sistemeve të transmissioinit dhe shpërndarjes t'u lejohen stimulimet përkatëse, si në aspektin afatshkurtër ashtu edhe atë afatgjatë, për të rritur efikasitetin, për të nxitur integrimin e tregut dhe sigurimin e furnizimit dhe mbështetjen e aktiviteteve të ndërlidhura të hulumtimit.

9. Autoritetet rregullatore monitorojnë menaxhimin e kongjestionit të sistemeve kombëtare të energjisë elektrike, përfshirë interkonektorët dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit të kongjestionit. Lidhur me këtë, operatorët e sistemit të transmissioinit ose operatorët e tregut duhet të paraqesin rregullat e tyre të menaxhimit të kongjestionit, përfshirë ndarjen e kapaciteteve tek autoritetet rregullatore shtetërore. Autoritetet rregullatore shtetërore mund të kërkojnë ndryshimin e rregullave të tilla.

10. Autoritetet rregullatore, kur është e nevojshme, kanë autorizim për të kërkuar nga operatorët e sistemit të transmissioinit dhe shpërndarjes që të ndryshojnë kushtet, përfshirë tarifaf apo metodologjitë e përcaktuara në këtë nen, për të siguruar që të jenë proporcionale dhe të zbatueshme në mënyrë jodiskriminuese. Në rast të vonesës në rregullimin e tarifave të transmissioinit dhe shpërndarjes, autoritetet rregullatore kanë kompetencë për të rregulluar apo miratuar tarifa apo metodologji të përkohshme të transmissioinit dhe shpërndarjes, dhe për të vendosur për masat e duhura të kompensimit nëse tarifaf apo metodologjitë përfundimtare të transmissioinit apo shpërndarjes ndryshojnë nga tarifaf apo metodologjitë e përkohshme.

11. Cilado palë që ka ankesë kundër operatorit të sistemit të transmissioinit apo shpërndarjes lidhur me detyrimet e atij operatori nga kjo Direktivë, mund t'i drejtojë ankesën autoritetit rregullator, i cili duke vepruar si autoritet për zgjedhjen e kontesteve nxjerr vendim brenda dy muajsh nga pranimi i ankesës. Ky afat mund të vazhdohet edhe për dy muaj tjerë në rastet kur kërkohet informacion shtesë nga autoriteti rregullator. Afati i vazhduar mund të vazhdohet prapë me pajtimin e ankuesit. Vendimi i autoritetit rregullator ka efekt detyrues përveç nëse shfuqizohet në apel.

12. Cilado palë e prekur dhe e cila ka të drejtë të ankohet lidhur me vendimin mbi metodologjitë e ndërmarra në pajtim me këtë nen, apo kur autoriteti rregullator është i detyruar ta konsultojë lidhur me tarifaf apo metodologjitë e propozuara, më së voni brenda dy muajsh pas publikimit të vendimit apo propozimit për vendim, apo brenda një afati më të shkurtë siç përcaktohet nga Shtetet Anëtare, mund të paraqesë ankesë për shqyrtim. Ankesa e tillë nuk ka efekt pezullues.

13. Shtetet Anëtare krijojnë mekanizma përkatës dhe efektiv për rregullimin, kontrollin dhe transparencën, për të shmangur çfarëdo keqpërdorimi të pozitës dominuese, posaçërisht në dëm të konsumatorëve, dhe çfarëdo sjellje grabitqare. Ata mekanizma duhet të kenë parasysh dispozitat e Traktatit, dhe në veçanti nenin 82 të tij.

14. Shtetet Anëtare sigurojnë ndërmarrjen e masave përkatëse, përfshirë kontest administrativ apo procedurë penale në pajtim me ligjin vendor, kundër personave fizik dhe juridik që janë përgjegjës kur nuk respektohen rregullat e konfidencialitetit të përcaktuara me këtë Direktivë.

15. Ankesat e përcaktuara në paragrafët 11 dhe 12 nuk paragjykojnë të drejtën e ushtrimit të ankesës

sipas ligjit të Komunitetit apo ligjit shtetëror.

16. Vendimet e marra nga autoritetet rregullatore janë plotësisht të arsyetuara dhe të justifikuara për të lejuar shqyrtimin gjyqësor. Vendimet duhet të jenë të qasshme për publikun, mirëpo gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin e informacioneve ekonomikisht të ndjeshme.

17. Shtetet Anëtare sigurojnë ekzistimin e mekanizmave të përshtatshëm në nivel shtetëror, në bazë të të cilëve pala e prekur nga vendimi i autoritetit rregullator ka të drejtë ankese te një trup i pavarur prej palëve të përfshira dhe qeverisë.

Neni 38

Autoritetet rregullatore për çështje ndërkuftare

1. Autoritetet rregullatore konsultojnë dhe bashkëpunojnë ngushtë me njëra tjetrën, dhe i sigurojnë Agjencisë dhe njëra tjetrës çfarëdo informate të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tyre nga kjo Direktivë. Në lidhje me informacionet e këmbjere, autoriteti pranues siguron të njëjtin nivel të konfidencialitetit sikurse që kërkohet nga autoriteti nga i cili vjen informacioni.

2. Autoritetet rregullatore duhet të bashkëpunojnë së paku në nivel rajonal për të:

- . (a) nxitur krijimin e aranzhimeve operative, në mënyrë që të mundësojë menaxhimin optimal të rrjetit, të promovojë shkëmbimet e përbashkëta të energjisë elektrike dhe ndarjen e kapaciteteve ndërkuftare, përfshirë përmes interkonektorëve të ri, brenda rajonit dhe brenda rajoneve për të mundësuar zhvillimin e konkurrencës efektive dhe përmirësimin e shërbimeve të furnizimit, pa diskriminuar në mes të ndërmarrjeve furnizuese në Shtete Anëtare të ndryshme;
- . (b) koordinuar zhvillimin e të gjitha kodeve të rrjeteve për operatorët e sistemit të transmisionit dhe akterët tjerë në treg; dhe
- . (c) koordinuar zhvillimin e rregullave të cilat rregullojnë menaxhimin e kongestionit.

3. Autoritetet rregullatore kombëtare kanë të drejtë të hyjnë në aranzhime të bashkëpunimit me njëra tjetrën për të nxitur bashkëpunimin e rregullatorëve.

4. Veprimet e cekura në paragrafin 2 zbatohen, sipas nevojës, në konsultim të ngushtë me organet tjera relevante kombëtare dhe pa paragjykim për kompetencat e tyre të caktuara.

5. Komisioni mund të adoptojë Udhëzime lidhur me nivelin e detyrimeve të autoriteteve rregullatore për të bashkëpunuar me njëri tjetrin dhe me Agjencinë. Këto masa, të hartuara me qëllim të ndryshimit të elementeve jothelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhet të adoptohen me kujdes në pajtim me procedurën rregullatore të përcaktuar në nenin 46(2).

Pajtueshmëria me Udhëzimet

1. Çdo autoritet rregullator dhe Komisioni mund të kërkojë opinionin e Agjencisë mbi pajtueshmërinë e vendimit të nxjerrë nga autoriteti rregullator me Udhëzimet e përcaktuara në këtë Direktivë apo në Rregulloren (EC) Nr 714/2009.
2. Agjencia i jep opinionin e vet autoritetit rregullator që ka kërkuar një gjë të tillë ose Komisionit, dhe autoritetit rregullator që ka marrë vendimin në fjalë brenda tre muajsh nga data e pranimit të kërkesës.
3. Kur autoriteti rregullator i cili ka nxjerr vendimin nuk vepron në pajtim me opinionin e Agjencisë brenda katër muajve nga dita e pranimit të atij opinionit, Agjencia njofton Komisionin për këtë.
4. Çdo autoritet rregullator mund të njoftojë Komisionin kur e konsideron se vendimi përkatës për tregti ndërkufitare i nxjerr nga autoriteti tjetër rregullator nuk është në pajtim me Udhëzimet e cekura në këtë Direktivë apo në Rregulloren (EC) Nr 714/2009 brenda dy muajve nga dita e nxjerrjes së vendimit të tillë.
5. Kur Komisioni, brenda dy muajve pasi të jetë informuar nga Agjencia në përputhje me paragrafin 3, ose nga autoriteti rregullator në përputhje me paragrafin 4, apo me vetiniciativë, brenda tre muajve nga data e vendimit, gjen se vendimi i autoritetit rregullator ngrit dyshime serioze për pajtueshmërinë me udhëzimet e cekura në këtë Direktivë apo me Rregulloren (EC) No 714/2009, Komisioni mund të vendos që të shqyrtojë rastin më tej. Në rast të tillë, duhet të ftojë autoritetin rregullator dhe palët në procedurën para autoritetit rregullator për të paraqitur vërejtjet e tyre.
6. Kur Komisioni merr vendim për të shqyrtuar rastin më tej, brenda katër muaj nga dita e vendimit të tillë, ai nxjerr vendim përfundimtar:
 - (a) për të mos ngritur kundërshtime kundër vendimit të autoritetit rregullator; ose
 - (b) kërkon nga autoriteti rregullator në fjalë që të tërheq vendimin e tij mbi bazën që nuk është në pajtim me Udhëzimet.
7. Kur Komisioni nuk merr vendim për të shqyrtuar rastin më tej apo kur nuk merr vendim përfundimtar brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafët 5 dhe 6, konsiderohet se nuk ka kundërshtime në vendimin e autoritetit rregullator.
8. Autoriteti rregullator vepron në pajtim me vendimin e Komisionit dhe tërheq vendimin e vet brenda dy muajve dhe e njofton Komisionin për këtë.
9. Komisioni mund të miratojë Udhëzimet të cilat përcaktojnë në detaje procedurën që duhet ndjekur për zbatimin e këtij neni. Këto masa, të hartuara me qëllim të ndryshimit të elementeve jothelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhet të adoptohen në pajtim me procedurën rregullatore të përcaktuar me kujdes në nenin 46(2).

Neni 40

Ruajtja e të dhënave

1. Shtetet Anëtare kërkojnë nga ndërmarrjet furnizuese që për përmbushjen e detyrimeve të tyre, së paku për pesë vjet të mbajnë në dispozicion të autoriteteve vendore, përfshirë autoritetin vendor rregullator, autoritetet vendore të konkurrencës dhe Komisionin, të dhënat përkatëse lidhur me të gjitha transaksionet kontraktuale për furnizim me energji elektrike dhe derivate të energjisë elektrike me konsumatorë me shumicë dhe operatorë të sistemit të transmisionit.
2. Të dhënat përmbajnë hollësi mbi karakteristikat e transaksioneve përkatëse, siç është kohëzgjatja, rregullat e dorëzimit, sasia, datat dhe kohët e ekzekutimit dhe çmimet e transaksioneve dhe mjetet për identifikimin e konsumatorit me shumicë në fjalë, si dhe hollësitë mbi kontratat e papërmbushura të furnizimit me energji elektrike apo me derivate të energjisë elektrike.
3. Autoriteti rregullator mund të vendos të vë në dispozicion të pjesëmarrësve në treg elemente të caktuara të atij informacioni, me kusht që informatat ekonomike të ndjeshme të pjesëmarrësve individual në treg apo transaksionet individuale të mos lëshohen. Ky paragraf nuk zbatohet për informacionet lidhur me instrumentet financiare të cilat janë në kuadër të fushëveprimit të Direktivës 2004/39/EC.
4. Për të siguruar zbatimin njësoj të këtij neni, Komisioni mund të miratojë Udhëzime të cilat përcaktojnë metodat dhe aranzhimet e ruajtjes së të dhënave, si dhe formën dhe përmbajtjen e të dhënave që duhet të ruhen. Këto masa, të hartuara për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhet të miratohen në pajtim me procedurën rregullatore të përcaktuar me kujdes në nenin 46(2).
5. Për sa i përket transaksioneve me derivate të energjisë elektrike të ndërmarrjeve të furnizimit me konsumatorë me shumicë dhe operatorë të sistemit të transmisionit, ky nen zbatohet vetëm pasi që Komisioni të ketë adoptuar Udhëzimet e përcaktuara në paragrafin 4.
6. Dispozitat e këtij neni nuk krijojnë detyrime shtesë për autoritetet e përcaktuara në paragrafin 1 për subjektet që janë në kuadër të fushëveprimit të Direktivës 2004/39/EC.
7. Në rast se autoritetet e përcaktuara në paragrafin 1 kanë nevojë të kenë qasje në të dhënat që ruhen nga subjektet që janë në kuadër të fushëveprimit të Direktivës 2004/39/EC, autoritetet përgjegjëse sipas asaj Direktive duhet t'u sigurojnë të dhënat e kërkuara.

KAPITULLI X

TREGJET ME PAKICË

Neni 41

Tregjet me pakicë

Për të lehtësuar ndërtimin e tregjeve funksionale dhe transparente me pakicë në Komunitet, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që rolet dhe përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmisionit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, ndërmarrjeve të furnizimit, konsumatorëve dhe kur është e nevojshme pjesëmarrësve tjerë në treg të jenë të definuara për sa i përket aranzhimeve kontraktuale, përkushtimit ndaj konsumatorit, shkëmbimit të të dhënave dhe rregullave të marrëveshjes, pronësisë së të dhënave dhe përgjegjësisë për matje.

Këto rregulla bëhen publike, hartohen me qëllim të lehtësimit të qasjes së konsumatorëve dhe furnizuesve në rrjete, dhe i nënshtrohen shqyrtimit nga autoritetet rregullatore dhe autoritetet tjera përkatëse vendore.

Konsumatorët e mëdhenj afarist kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me disa furnizues në të njëjtën kohë.

KAPITULLI XI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 42

Masat mbrojtëse

Në rast të ndonjë krize të papritur në tregun e energjisë dhe ku siguria fizike e personave, aparaturës apo instalimeve apo integritetit të sistemit është e kërcënuar, Shtetet Anëtare përkohësisht mund të marrin masa të nevojshme mbrojtëse.

Masat e tilla duhet të shkaktojnë çrregullimin më të vogël të mundshëm në funksionimin e tregut të brendshëm dhe nuk duhet të jenë më të gjëra në fushëveprim se që është rreptësisht e nevojshme për të rregulluar vështirësitë e papritura të cilat janë paraqitur.

Shteti Anëtar në fjalë duhet që, pa vonesë, të njoftojë Shtetet tjera Anëtare dhe Komisionin për ato masa, i cili mund të vendos se Shteti Anëtar në fjalë duhet të ndryshojë apo të heq dorë nga masat e tilla, për aq sa çrregullojnë konkurrencën dhe ndikojnë negativisht në tregti në një mënyrë e cila është në mospërputhje me interesin e përgjithshëm.

Neni 43

Fushëveprimi i barabartë

1. Direktiva për të siguruar një fushëveprim të barabartë është në pajtim me Traktatin, më saktësisht nenin 30 të tij, dhe me ligjin e Komunitetit.
2. Masat e përcaktuara në paragrafin 1 janë proporcionale, jodiskriminuese dhe transparente. Këto masa mund të vihen në fuqi vetëm pas njoftimit dhe miratimit nga Komisioni.
3. Komisioni duhet të veprojë mbi njoftimin e përcaktuar në paragrafin 2 brenda dy muajve nga pranimi i njoftimit. Ky afat fillon në ditën e pranimit të informacionit të plotë. Në rast se Komisioni nuk vepron brenda këtij afati dymujor, konsiderohet se nuk ka kundërshtime për masat me të cilat është njoftuar.

Neni 44

Përjashtimet

1. Shtetet Anëtare të cilat pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive arrijnë të demonstrojnë se ka probleme thelbësore për operimin e sistemeve të tyre të vogla e të izoluara, mund të aplikojnë për përjashtimin e dispozitave përkatëse të Kapitujve IV, VI, VII dhe VIII, si dhe Kapitullit III, në rast të mikrosistemeve të izoluara, sa i përket rinovimit, përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve ekzistuese, Komisioni njofton Shtetet Anëtare për këto aplikacione para marrjes së vendimit, duke respektuar konfidencialitetin. Vendimi i tillë publikohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian .
2. Neni 9 nuk vlen për Qipron, Luksemburgun dhe/ose Maltën. Përveç kësaj, nenet 26, 32 dhe 33 nuk vlejnë për Maltën.

Për qëllime të nenit 9(1)(b), nocioni 'ndërmarrja e kryerjes së cilitdo nga funksionet e prodhimit ose furnizimeve' nuk përfshin konsumatorët e fundit të cilët kryejnë cilindo nga funksionet e prodhimit dhe/ose furnizimeve me energji elektrike, qoftë në mënyrë direkte apo përmes ndërmarrjeve mbi të cilat ushtrojnë kontroll, qoftë individualisht apo bashkërisht, me kusht që konsumatorët e fundit, duke përfshirë aksionet e tyre në energjinë elektrike të prodhuar në ndërmarrje të kontrolluara, në mesatare vjetore janë neto konsumatorë të energjisë elektrike dhe me kusht që vlera ekonomike e energjisë elektrike që ua shesin palëve të treta të jetë jodomethënëse në proporcion me veprimet e tjera afariste.

Neni 45

Procedura e rishikimit

Në rastet kur në raportin e përcaktuar në nenin 47(6) Komisioni arrin në përfundim se duke pasur parasysh mënyrën efektive me të cilën qasja në rrjet është zbatuar në një Shtet Anëtar – gjë që forcon qasjen plotësisht efektive, jodiskriminuese dhe të papenguar në rrejt – detyrime të caktuara të imponuara me këtë Direktivë mbi ndërmarrjet (përfshirë ato që respektojnë shturjet ligjore për

operatorët e sistemit të shpërndarjes) nuk janë në proporcion me qëllimin e paraparë, atëherë Shtetet Anëtare mund të paraqesin kërkesë para Komisionit për përjashtim nga detyrimet në fjalë.

Shteti Anëtar ia kumton kërkesën e tillë pa vonesë Komisionit, së bashku me të gjitha informacionet relevante të nevojshme për të treguar se përfundimi i arritur në raportin për qasjen efektive në rrjet do të vazhdohet.

Brenda tre muajsh nga pranimi i njoftimit, Komisioni miraton një opinion lidhur me kërkesën nga Shteti Anëtar në fjalë, dhe ku mundet, paraqet propozime në Parlamentin Evropian dhe në Këshill për të ndryshuar dispozitat përkatëse të kësaj Direktive. Në propozim, Komisioni mund të propozojë të ndryshojë këtë Direktivë, të përjashtojë Shtetin Anëtar në fjalë prej detyrimeve të caktuara, me kusht që Shteti Anëtar të implementojë masa po aq efektive siç kërkohet.

Neni 46

Komiteti

1. Komisioni ndihmohet nga komiteti.

2. Kur referohet ky paragraf, neni 5a(1) deri (4) dhe neni 7 i Vendimit 1999/468/EC zbatohet përkitazi me dispozitat e nenit 8.

Neni 47

Raportimi

1. Komisioni monitoron dhe rishikon zbatimin e kësaj Direktive dhe dërgon një raport të progresit të përgjithshëm në Parlamentin Evropian dhe në Këshill për herë të parë deri më 4 Gusht 2004, dhe më pas dërgon raport për çdo vjet. Raporti i progresit së paku përfshin:

(a) përvojën e fituar dhe progresin e bërë në krijimin e një tregu të brendshëm, të plotë dhe tërësisht funksional të energjisë elektrike, si dhe pengesat që mbeten në këtë drejtim, përfshirë aspektet e dominimit të tregut, kahjet e tregut, sjelljet grabitqare apo anti-konkurruese dhe efekti në çrregullimin e kushteve të tregut;

(b) shkallën deri në të cilën shthurja dhe detyrimet tarifore që përmban kjo Direktivë kanë qenë të suksesshme në sigurimin e qasjes së drejtë dhe jodiskriminuese në sistemin e energjisë elektrike të Komunitetit dhe nivelet e barabarta të konkurrencës, si dhe pasojat ekonomike, mjedisore dhe shoqërore të hapjes së tregut të energjisë elektrike për konsumatorë;

(c) shqyrtimi i problemeve që kanë të bëjnë me nivelet e kapaciteteve të sistemit dhe sigurimi i furnizimit me energji elektrike në Komunitet, e në veçanti balancimi ekzistues dhe i projektuar në mes të kërkesës dhe furnizimit, duke marrë parasysh kapacitetin fizik për shkëmbimet në mes të zonave;

(d) vëmendje e veçantë i jepet masave të marra nga Shtetet Anëtare për të mbuluar kërkesën e pikut dhe ballafaqimin me mangësitë e një apo më shumë furnizuesve;

(e) zbatimin e përjashtimit të përcaktuar me nenin 26(4) me qëllim të rishikimit të mundshëm të pragut;

(f) një vlerësim të përgjithshëm të progresit të arritur në lidhje me marrëdhëniet bilaterale me vende të treta të cilat prodhojnë dhe eksportojnë apo transportojnë energji elektrike, përfshirë progresin e arritur në integrimin e tregut, pasojat shoqërore dhe mjedisore të tregtisë së energjisë elektrike dhe qasjes në rrjetet e këtyre vendeve të treta;

(g) nevoja për harmonizimin e mundshëm të kërkesave që nuk janë të ndërlidhura me dispozitat e kësaj Direktive; dhe

(h) mënyra në të cilën Shtetet Anëtare kanë zbatuar në praktikë kërkesat lidhur me etiketimin e energjisë sipas nenit 3(9), dhe mënyra se si janë marrë parasysht rekomandimet e Komisionit mbi atë çështje.

Ku është e përshtatshme, raporti i progresit mund të përfshijë rekomandime në lidhje me shtrirjen dhe modalitetet e dispozitave të etiketimit në veçanti, duke përfshirë mënyrën në të cilën referimi është bërë në burime ekzistuese dhe përmbajtja e këtyre burimeve, dhe veçanërisht informacioni lidhur me ndikimin mjedisor, të paktën në lidhje me emetimin e CO₂ dhe mbetjeve radioaktive, që rezultojnë prej prodhimit të energjisë elektrike nga burime të ndryshme të energjisë e që mund të mundësohet në një mënyrë transparente, të qasshme dhe të krahasueshme kudo në Komunitet, se si masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare për të kontrolluar saktësinë e informacionit të ofruar nga furnizuesit mund të strukturohen, dhe cilat masa mund të kundërvënë efektet negative të dominimit dhe përqendrimit të tregut.

2. Çdo dy vite, raporti i progresit i cekur në paragrafin 1 përfshin një analizë të masave të ndryshme të ndërmarra në Shtetet Anëtare për të përmbushur detyrimet e shërbimeve publike, së bashku me një shqyrtim të efektivitetit të këtyre masave dhe në veçanti, efektet e tyre në konkurrencën e tregut të energjisë elektrike. Ku është e përshtatshme, raporti mund të përfshijë rekomandime për masat që mund të merren në nivel shtetëror për të arritur standarde të larta të shërbimeve publike, ose masa që kanë për qëllim parandalimin e falimentimit të tregut.

3. Komisioni deri më 3 Mars 2013, si pjesë e rishikimit të përgjithshëm do të dërgojë në Parlamentin Evropian dhe në Këshill një raport të detajuar ku përcaktohet shkalla deri në të cilën kërkesat e shturura nga Kapitulli V kanë qenë të suksesshme në sigurimin e pavarësisë së plotë dhe efektive të operatorëve të sistemit të transmisionit, duke përdorur shturjen efektive dhe efikase si pikë referimi.

4. Me qëllim të zbatimit të vlerësimit nga paragrafi 3, Komisioni në veçanti merr parasysht kushtet vijuese: qasjen e drejtë dhe jodiskriminuese në rrjet, rregullim efektiv, zhvillimin e rrjetit për t'i përmbushur nevojat e tregut, stimulimin e pashtrembëruar të investimeve, zhvillimin e infrastrukturës ndërlidhëse, konkurrencën efektive në tregjet e energjisë së Komunitetit dhe sigurimin e furnizimit në Komunitet.

5. Ku është e përshtatshme, dhe veçanërisht në rastin kur raporti i detajuar i cekur në paragrafin 3 përcakton se kushtet e caktuara në paragrafin 4 nuk janë garantuar në praktikë, Komisioni deri më 3 mars 2014 dërgon propozime në Parlamentin Evropian dhe në Këshill për të siguruar pavarësi të plotë dhe efektive të operatorëve të sistemit të transmisionit.

6. Komisioni deri më 1 Janar 2006 drejton në Parlamentin Evropian dhe në Këshill një raport të detajuar që përshkruan progresin e bërë në krijimin e një tregu të brendshëm të energjisë elektrike. Ky raport në veçanti do të shqyrtojë:

— ekzistimin e qasjes jodiskriminuese në rrjet,

— rregullimin efektiv,

— zhvillimin e një ndërlidhjeje infrastrukturore dhe sigurimin e furnizimit në Komunitet,

— shkallën deri në të cilën përfitimet e hapjes së tregjeve janë rritur për ndërmarrje të vogla dhe konsumatorët shtëpiakë, duke i respektuar shërbimet publike dhe standardet universale të shërbimit,

— shkallën deri në të cilën tregjet janë praktikisht të hapura ndaj konkurrencës efektive, përfshirë aspektet e dominimit të tregut, përqendrimit në treg dhe sjelljeve grabitqare apo anti-konkurruese,

— shkallën deri në të cilën konsumatorët ndërrojnë furnizuesit dhe rinegociojnë tarifat,

— kahjen e çmimeve, përfshirë çmimet e furnizimit, në lidhje me shkallën e hapjes së tregjeve, dhe

— përvoja e fituar në zbatimin e kësaj Direktive sa i përket pavarësisë efektive të operatorëve të sistemit në ndërmarrje vertikalisht të integruara dhe nëse masat shtesë për pavarësinë funksionale dhe ndarjen e llogarive janë zhvilluar duke pasur efekte të njëjta me shturjet ligjore.

Ku është e përshtatshme, Komisioni dërgon propozime në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, veçanërisht për garantimin e standardeve të larta të shërbimit publik.

Ku është e përshtatshme, Komisioni dërgon propozime në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, veçanërisht për të siguruar pavarësi efektive dhe të plotë të operatorëve të sistemit të shpërndarjes para datës 1 korrik 2007. Në rast nevoje, këto propozime, në pajtim me ligjet e konkurrencës, poashtu kanë të bëjnë me masa për të adresuar çështjet e dominimit në treg, përqendrimit të tregut dhe sjelljet grabitqare apo anti-konkurruese.

Neni 48

Shfuqizimi

Direktiva 2003/54/EC shfuqizohet nga 3 marsi 2011 pa paragjykim për detyrimet e shteteve anëtare përsa i përket afateve për zhvendosje dhe zbatim të kësaj Direktive. Referimi në Direktivën e shfuqizuar interpretohet si referim në këtë Direktivë dhe lexohet në pajtim me tabelën e korrelacionit në Aneksin II.

Neni 49

Inkorporimi (transpozimi)

1. Shtetet anëtare sjellin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për pajtueshmërinë me këtë direktivë deri më 3 marsi 2011. Për këtë, ato menjëherë e njoftojnë Komisionin.

Ato i zbatojnë këto masa nga 3 marsi 2011, me përjashtim të nenit 11, të cilin e zbatojnë nga 3 marsi 2013.

Kur Shtetet Anëtare i miratojnë këto masa, ato i referohen kësaj Direktive ose pasohen me një referencë me rastin e publikimit zyrtar të tyre. Metodatat e krijimit të referencës së tillë përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjeve shtetërore të cilat i miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

Neni 50

Hyrja në fuqi

Kjo Direktivë hyn në fuqi në ditën e 20-të pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 51

Të adresuarit

Kjo Direktivë iu adresohet shteteve anëtare.

Realizuar në Bruksel, 13 korrik 2009.

Për Parlamentin Evropian,

Presidenti H. G. PÖTTERING

Për Këshillin:

Presidenti E. ERLANDSSON

SHTOJCA I

MASAT PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Pa paragjykim ndaj rregullave të Komunitetit për mbrojtjen e konsumatorit, në veçanti Direktivës 97/7/EC të Parlamentin Evropian dhe të Këshillit të 20 majit 1997 për mbrojtjen e konsumatorëve lidhur me kontratat në largësi (1) dhe Direktivat e Këshillit 93/13/EEC të 5 prillit 1993 për kushte të padrejta në kontrata të konsumatorëve (2), masat e përcaktuara në nenin 3 janë për të siguruar se konsumatorët:

(a) kanë të drejtë për të hyrë në kontratë me ofruesin e shërbimit të energjisë elektrike që përcakton:

- identitetin dhe adresën e furnizuesit,
- shërbimet e ofruara, nivelin e shërbimeve të ofruara si dhe kohën për lidhjen e fillestare,
- llojet e ofruara të shërbimeve të mirëmbajtjes,
- mjetet me të cilat mund të merret informacioni i përditësuar në të gjitha tarifat e aplikueshme dhe tarifat e mirëmbajtjes,
- kohëzgjatja e kontratës, kushtet për përtëritjen dhe përfundimin e shërbimeve dhe kontratës, dhe nëse lejohet tërheqja nga kontrata pa tarifë,
- çdo kompensim dhe marrëveshje për rikthim të parave që mund të zbatohet nëse niveli i shërbimit të kontraktuar nuk është përmbushur, përfshirë faturimin e pasaktë dhe të vonuar,
- metoda për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontesteve në pajtim më pikën (f),
- informacioni në lidhje me të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë trajtimin e ankesave dhe të gjithë informacionit tjetër të përcaktuar në këtë pikë, të komunikuar me qartësi përmes faturimit ose faqes së internetit të ndërmarrjes së energjisë elektrike.

Kushtet janë të drejta dhe të ditura paraprakisht. Në çdo rast, ky informacion mundësohet para çdo përfundimi apo konfirmimi të kontratës. Në rastet kur kontratat janë të arritura nëpërmjet ndërmjetësuesve, informacioni në lidhje me çështjet e shtruara në këtë pikë po ashtu mundësohet para përfundimit të kontratës;

(b) janë dhënë njoftimet adekuate për çdo qëllim të ndryshimit të kushteve kontraktuese dhe janë njoftuar për të drejtën e tërheqjes kur është dhënë njoftimi. Ofruesit e shërbimeve njoftojnë abonentët e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, transparente dhe të kuptueshme për çfarëdo ndryshimi në faturim, në një kohë të përshtatshme jo më vonë se një periudhë normale e faturimit pas hyrjes në fuqi të ngritjes së çmimit. Shtetet Anëtare sigurojnë që konsumatorët të jenë të lirë për t'u tërhequr nga kontratat nëse nuk i pranojnë kushtet e reja të për të cilat janë njoftuar nga ofruesi i shërbimeve të energjisë elektrike;

(c) pranimi i informacionit transparent për çmimet dhe tarifat e aplikueshme dhe për kushtet standarde, lidhur me kyçjen dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;

(d) ofrohen një larmi zgjedhjesh për metodën e pagesës, të cilat nuk diskriminojnë padrejtësisht konsumatorët. Sistemet e parapagimit janë të drejta dhe në mënyrë adekuate reflektojnë konsumin. Çdo dallim në kushte reflekton çmimet e ofruesit të sistemeve të ndryshme të pagesës. Kushtet e përgjithshme janë të drejta dhe transparente. Ato jepen në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme dhe nuk përfshijnë pengesa jokontraktuese për ushtrimin e të drejtave të konsumatorëve, për shembull dokumentacioni i tepërt kontraktues. Konsumatorët mbrohen kundër metodave të padrejta dhe çorientuese të shitjes;

(e) nuk faturohen për ndërrimin e ofruesit të shërbimit;

(f) përfitojnë nga procedurat transparente, të thjeshta dhe jo të kushtueshme për zgjedhjen e ankesave të tyre. Në veçanti, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë për shërbime të standardit të lartë dhe trajtimin e ankesave të tyre nga ofruesi i shërbimit të energjisë elektrike. Procedurat e tilla për zgjedhje të kontesteve jashtë gjykatës do të mundësojnë që kontestet të zgjedhen në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, mundësisht brenda tre muajsh, në një sistem që garanton rimbursimin dhe/ose kompensimin kur një gjë e tillë është e duhur. Kurdo që të jetë e mundur, ata duhet të jenë në pajtim me parimet e caktuara në Rekomandimet e Komisionit 98/257/EC të 30 marsit 1998 mbi parimet e zbatueshme për trupat përgjegjëse për zgjedhje jashtëgjyqësore të kontesteve të konsumatorëve (1);

(g) kur kanë qasje në shërbime universale nën dispozitat e miratuara nga Shtetet Anëtare sipas nenit 3(3), njoftohen për të drejtat e tyre përsa u përket shërbimeve universale;

(h) disponimi me të dhënat e konsumit dhe mundësia sipas marrëveshjes së prerë dhe pa pagesë për të dhënë qasje në të dhënat matëse të tyre të gjitha ndërmarrjeve të regjistruara për furnizim. Pala përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave është e detyruar për t'ia dhënë ato të dhëna ndërmarrësit. Shtetet Anëtare përcaktojnë një format për të dhënat dhe procedurën për qasjen në ato të dhëna nga ofruesit dhe konsumatorët. Nuk do të ketë shpenzime shtesë për konsumatorin për këtë shërbim;

(i) njoftimi përkatës për konsumin aktual të energjisë elektrike dhe çmimet për të mundësuar rregullimin e konsumit të tyre të energjisë elektrike. Ai informacion jepet përmes përdorimit të një afati kohor të mjaftueshëm, që merr parasysh mundësitë e mjeteve matëse të konsumatorit dhe të produktit në fjalë të energjisë elektrike. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet efikasitetit të çmimeve për matje të tilla. Nuk ka shpenzime shtesë ndaj konsumatorit për shërbimin e tillë;

(j) pranimi i një përmbylljeje përfundimtarë të llogarisë pas çdo ndryshimi të ofruesit të energjisë elektrike jo më vonë se gjashtë javë pas ndryshimit të ofruesit.

Shtetet Anëtare sigurojnë zbatimin e sistemeve inteligjente të matjes të cilat ndihmojnë pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e furnizimit me energji elektrike. Zbatimi i këtyre sistemeve të matjes mund t'i nënshtrohet një vlerësimi ekonomik për shpenzimet afatgjate dhe përfitimet për tregun dhe konsumatorin individual ose cilado formë e matjes inteligjente që është ekonomikisht më e arsyeshme dhe me kosto më të ulët, si dhe cili afat kohor është i realizueshëm për shpërndarjen e tyre.

Vlerësimi i tillë realizohet deri më 3 shtator 2012.

Varësisht nga ky vlerësim, Shtetet Anëtare ose autoriteti kompetent që ato e caktojnë për gatit një orar që synon zbatimin e sistemeve inteligjente të matjes deri në 10 vite.

Kur prezantimi i matësve inteligjent vlerësohet pozitivisht, të paktën 80% e konsumatorëve pajisen me sisteme inteligjente të matjes deri më 2020.

Shtetet Anëtare, ose autoriteti kompetent që ato e caktojnë, siguron ndërveprimin me këto sisteme të matjes që do të zbatohen brenda territoreve të tyre dhe i kushton rëndësi përdorimit të standardeve përkatëse dhe praktikave më të mira, si dhe rëndësisë së zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike.

SHTOJCA II

TABELA E KORELACIONIT

Direktiva 2003/54/EC	Kjo Direktivë
Neni 1	Neni 1
Neni 2	Neni 2
Neni 3	Neni 3
Neni 4	Neni 4
Neni 5	Neni 5
—	Neni 6
Neni 6	Neni 7
Neni 7	Neni 8
Neni 10	Neni 9
Neni 8	Neni 10
—	Neni 11
Neni 9	Neni 12
—	Neni 13
—	Neni 14
Neni 11	Neni 15
Neni 12	Neni 16
—	Neni 17
—	Neni 18
—	Neni 19
—	Neni 20
—	Neni 21
—	Neni 22
—	Neni 23
Neni 13	Neni 24
Neni 14	Neni 25
Neni 15	Neni 26
Neni 16	Neni 27
Neni 17	Neni 29
Neni 18	Neni 30
Neni 19	Neni 31
Neni 20	Neni 32
Neni 21	Neni 33
Neni 22	Neni 34
Neni 23(1) (fjalja e parë dhe e dytë)	Neni 35
—	Neni 36
Neni 23 (pjesa tjetër)	Neni 37
—	Neni 38
—	Neni 39
—	Neni 40
—	Neni 41
Neni 24	Neni 42